



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 166 Akti

Nr. 359 Vendimi
Tiranë, më 23.3.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko	Kryesuese
Firdes Shuli	Relatore
Xhensila Pine	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Orianda Liçi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në datat 2.3.2021, ora 13:00, 19.3.2021, ora 09:30 dhe 23.3.2021, ora 09:50, në Pallatin e Koncerteve, (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Arens Çela, prokuror në Prokurorinë e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë**, me detyrë aktuale shef sektori në Sektorin e Monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Firdes Shuli, mori në shqyrtim çdo provë dhe dokument të vënë në dispozicion nga organet kompetente ligjore, shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Arens Çela, i cili në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Arens Çela është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).
2. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, është zhvilluar shorti në datën 17.9.2018, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit, z. Arens Çela, do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Alma Faskaj dhe Firdes Shuli. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli.
3. Për këtë subjekt rivlerësimi u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.
4. Me shkresën nr. *** prot., datë 10.1.2018, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 3.9.2018, ILDKPKI-ja ka vënë në dispozicion aktin përfundimtar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Arens Çela.
5. Me shkresën nr. *** prot., datë 4.4.2019, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 5.4.2019, DSIK-ja vuri në dispozicion raportin mbi kontrollin e figurës nr. *** , datë 2.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, z. Arens Çela, i deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. *** , datë 2.4.2019, të KDZH-së.
6. Me shkresën nr. *** prot., datë 25.7.2019, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 30.7.2019, KLP-ja ka vënë në dispozicion raportin e analizimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Arens Çela.
7. Me vendimin nr. 1, datë 17.9.2018, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, z. Arens Çela, duke u bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuesen e trupit gjykues, komisioneren Pamela Qirko. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.
8. Në datën 3.10.2018 subjektit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije edhe e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti nuk është shprehur mbi gjendjen e konfliktit të interesit me ndonjë nga anëtarët e trupit gjykues.
9. Në datën 23.10.2019 komisionerja Alma Faskaj paraqiti kërkesë për dorëheqje nga procesi i rivlerësimit të subjektit Arens Çela, për shkak të konfliktit të interesit në dukje.
10. Me vendimin e datës 28.10.2019, pas shqyrtimit të dorëheqjes së anëtares, komisioneres Alma Faskaj, trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i zgjedhur me short me vendimin nr. *** , datë 23.10.2019, vendosi pranimin e kërkesës së saj për dorëheqjen nga shqyrtimi i mëtejshëm i dosjes së subjektit të rivlerësimit, z. Arens Çela.
11. Në datën 28.2.2020 subjektit iu komunikua në rrugë elektronike dorëheqja e komisioneres Alma Faskaj dhe vazhdimi i shqyrtimit të çështjes nga komisionerja zëvendësuese Xhensila

Pine, duke i kërkuar të shprehet në lidhje me gjendjen e konfliktit të interesit. Subjekti ka deklaruar në rrugë elektronike që nuk ka konflikt interesi me komisioneren Xhensila Pine.

12. Me vendimin nr. 2, datë 18.12.2020, trupi gjykues vendosi mbylljen e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit, z. Arens Çela, dhe vendimmarrja në përfundim të procesit të rivlerësimit të bazohet në tria kriteret: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin profesional, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

13. Në datën 18.12.2020, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën jo më vonë se data 12.1.2021; si dhe (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative.

14. Në datën 5.1.2021 subjekti i rivlerësimit dërgoi me anë të postës elektronike parashtrimet e tij në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ kryesisht.

15. Në datën 8.1.2021 Komisioni administroi një denoncim nga publiku, në të cilin ngriheshin pretendime për kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit dhe përfshirje të tij në veprime korruptive.

16. Me vendimin nr. 3, datë 8.1.2020, trupi gjykues vendosi riçeljen e hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e disa veprimeve hetimore në lidhje me denoncimin e paraqitur.

17. Në përfundim të këtij hetimi, me vendimin nr. 4, datë 16.2.2021, trupi gjykues vendosi: (i) të përfundojë hetimin për subjektin e rivlerësimit, z. Arens Çela; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit; si dhe (iii) të informojë subjektin për t'u njohur me provat e administruara, të drejtat për të kërkuar marrjen e provave të reja etj., dhe dorëzimin e prapësimeve deri në datën 24.2.2021.

18. Në datën 24.2.2021 subjekti dërgoi në rrugë elektronike parashtrimet e tij mbi rezultatet e hetimit administrativ shtesë.

19. Pas shqyrtimit të parashtrimeve të paraqitura nga subjekti, me vendimin nr. 5, datë 26.2.2021, trupi gjykues vendosi kalimin në seancë dëgjimore, duke e njoftuar subjektin me anë të postës elektronike se seanca do të zhvillohej në datën 2.3.2021, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

20. Në datën 2.3.2021 u zhvillua seanca dëgjimore, në të cilën subjekti kërkoi konfirmimin në detyrë.

21. Në datat 1.3.2021 dhe 2.3.2021 Komisioni administroi në rrugë elektronike 4 denoncime nga publiku, në lidhje me subjektin e rivlerësimit, z. Arens Çela.

22. Pas verifikimit të njërës prej denoncimeve, me vendimin nr. 6, datë 9.3.2021, trupi gjykues vendosi: (i) shtyrjen e seancës për shpalljen e vendimit të subjektit të rivlerësimit deri në një njoftim të dytë; si dhe (ii) njoftimin e rezultateve të hetimit administrativ shtesë dhe paraqitjen e parashtrimeve brenda datës 12.3.2021.

23. Në datën 12.3.2021 subjekti dërgoi në rrugë elektronike parashtrimet e tij mbi rezultatet e hetimit administrativ shtesë.

24. Me vendimin nr. 7, datë 16.3.2020, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore në datën 19.3.2021, ora 09:30.

25. Në datën 19.3.2021 u zhvillua seanca dëgjimore, në të cilën subjekti rikërkoi konfirmimin në detyrë.

II. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

Në zbatim të nenit 31/1 të ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Arens Çela, ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratën e pasurisë në datën 26.1.2017 (duke përfshirë personin e lidhur), pra, në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Gjithashtu, në referencë të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, vërehet se subjekti i rivlerësimit, z. Arens Çela, është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2006, me nr. indeksi ***, dhe ka dorëzuar rregullisht deklaratat e interesave private në vijim.

ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për subjektin Arens Çela, ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjekteve të rivlerësimit, referuar vendimit nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizoi një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi të kriterit pasuror për subjektin e rivlerësimit, z. Arens Çela, i cili nuk është bazuar dhe as është detyruar nga përfundimet e paraqitura nga ILDKPKI-ja.

Në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese, sipas pikës 1, të nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka hetuar të gjitha faktet dhe ka vlerësuar të gjitha rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, në zbatim të nenit 179/b të Kushtetutës, duke kryer një proces të plotë hetimi administrativ për pasurinë e subjektit të rivlerësimit, z. Arens Çela, si dhe të personave të lidhur me të, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, bazuar në: (i) deklarinimet e subjektit në ILDKPKI; (ii) provat shkresore të administruara nga ky institucion dhe raportin e dorëzuar në Komision; (iii) çdo dokument ligjor që përbën mjet prove ligjore të kërkuar nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit, sipas nenit 49 të ligjit nr. 84/2016; si dhe (iv) komunikimet me subjektin, sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016 dhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative.

Hetimi administrativ në lidhje me rivlerësimin e pasurisë, konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarinimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklarinimeve të rreme; si dhe (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim verifikimin e deklarinimeve të pamjaftueshme në lidhje me kriterin pasuror, sipas parashikimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

Pasuri të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting*

1. Apartament me sip. 76 m² (67 m² sipërfaqe banimi + 9 m² sipërfaqe në bashkëpronësi), me adresë: kompleksi “****”, godina ***, shk. ***, k. i 3-të, ndërtesa nr. ***, Njësia Administrative nr. 7, rr. “N. M.”, Tiranë”, me vlerë 60,800 euro, në pjesë takuese 50 %. Blerë sipas kontratës së porosisë nr. *** prot., datë 9.9.2008. Dorëzimi i apartamentit në vitin 2010. Aktualisht apartamenti nuk është i regjistruar në regjistrat publikë të administruar nga ZVRPP-ja Tiranë.

1.1. Burimi i deklaruar i krijimit:

- a. të ardhura nga paga si prokuror dhe si magjistrat dhe të ardhura nga paga e bashkëshortes si gjyqtare, magjistrate dhe juriste në Bashkinë Tiranë;
- b. kontratë huamarrjeje (verbale) prej 10,000 euro me vjehrrën, znj. N. T.;
- c. kontratë huamarrjeje (verbale) prej 5,000 euro me babanë, z. I. Ç.;
- ç. kontratë kredie bankare me “Alpha Bank” sh.a., në vlerën 3,000,000 lekë.

Hetimi i Komisionit

- ZVRPP-ja Tiranë nuk e konfirmoi të regjistruar¹ këtë pasuri dhe për këtë shkak është pyetur subjekti, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka vënë në dispozicion vërtetimin nga dokumenti hipotekor, datë 8.11.2017, sipas të cilit pasuria është regjistruar në ZVRPP-në Tiranë, me nr. ***, pas plotësimit të deklaratës *Vetting*.
- OSHEE-ja² konfirmoi kontratën nr ***, me kod klienti ***, që i përket abonentit Arens Çela, e cila është hapur në datën 27.3.2010.

1.2. Lidhur me mënyrën e krijimit të pasurisë dhe likuidimin e çmimit të blerjes, nga aktet në dosje në rend kronologjik, rezultoi se:

1.2.1. Me anë të kontratës së porosisë me vërtetim nënshkrimi nr. *** prot., datë 9.9.2008³, shtetasit A. A. dhe Arens Çela kanë porositur në shoqërinë “****” sh.p.k. apartament me sip. 76 m², k. ***, shk. ***, godina ***, rr. “B. R.” Tiranë, sipas së cilës çmimi i shitjes së sendit të ardhshëm do të jetë 60,800 euro dhe do të paguhet në këtë mënyrë: (i) blerësi ka paguar këstin e parë në vlerën 18,000 euro me nënshkrimin e kontratës; (ii) blerësi do të paguajë këstin e dytë në vlerën 19,000 euro brenda datës 15.12.2008; (iii) blerësi do të paguajë këstin e tretë në vlerën 20,000 euro brenda datës 5.3.2009; (iv) blerësi do të paguajë këstin e katërt dhe të fundit në vlerën 3,800 euro me marrjen në dorëzim të apartamentit dhe nënshkrimin e autorizimit të dorëzimit të çelësave brenda datës 30.6.2009; si dhe (v) pagesat që do të kryhen nga blerësi do të vërtetohen me faturat e transfertave bankare.

Subjekti, pasi është pyetur nga Komisioni, në përgjigje të pyetësorit nr. 2 ka deklaruar në mënyrë të detajuar në lidhje me pagesat e kësteve përkatëse dhe mënyrën e likuidimit dhe çmimit të shitjes në favor të palës shitëse, konfirmuar edhe nga të dhënat bankare, si vijojnë:

- Me njoftimin e kreditimit, datë 9.9.2008, të Bankës Amerikane të Shqipërisë, konfirmohet se shtetasit Arens Çela dhe A. A. i kanë kryer parapagimin për blerje banese shoqërisë “****” sh.p.k., në shumën 18,000 euro.
- Me njoftimin e kreditimit, datë 12.12.2008, të Bankës Amerikane të Shqipërisë, konfirmohet se shtetasit Arens Çela dhe A. A. i kanë kryer pagesën e këstit të dytë për blerje banese shoqërisë “****” sh.p.k., në shumën 19,000 euro.

¹ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 19.10.2018, si dhe përgjigjet dhe dokumentet bashkëlidhur në pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit.

² Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 15.3.2019, dhe shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 10.6.2019, të OSHEE-së, në dosjen e Komisionit.

³ Shihni aktin në aneksin nr. ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

- Me transfertën e datës 10.3.2009, nga z. Arens Çela te shoqëria “****” sh.p.k. ka kaluar shuma 20,000 euro për blerje apartamenti. Në datën 10.3.2009 subjekti ka tërhequr nga llogaria e tij e kredisë në “Alpha Bank”⁴ shumën 2,550,000 lekë. Në të njëjtën datë ka derdhur në llogarinë e tij në euro shumën 20,030 euro, nga e cila 20,000 euro i kanë kaluar shoqërisë.

- Me mandatarëkimin nr. ***, datë 24.4.2010, shtetasit Arens Çela dhe A. A. kanë derdhur në favor të shoqërisë “****” sh.p.k. shumën 3,643 euro⁵.

Për sa me sipër, në total rezulton të jetë paguar në rrugë bankare shuma 60,643 euro, me një diferencë prej 157 euro më pak⁶ se çmimi i parashikuar në kontratën e porosisë.

DPPPP-ja⁷ ka informuar raportimin e kontratës së porosisë, si vijon: “Në datën 9.12.2008 znj. A. A. ka prenotuar apartament për çmimin e deklaruar 60,800 euro, pranë shoqërisë ‘****’ sh.p.k.”.

1.2.2. Me kontratën e shitjes nr. ***, datë 7.8.2017⁸, është blerë apartamenti me sip. 67 m², me nr. pasurie ***, nga shoqëria “****” sh.p.k., sipas së cilës çmimi i shitjes prej 60,800 euro është likuiduar sipas kontratës së porosisë.

1.2.3. Sipas vërtetimit nga dokumenti hipotekor datë 8.11.2017, pasuria nr. *** është regjistruar në emër të subjektit dhe bashkëshortes në ZVRPP-në Tiranë.

1.3. Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti, si vijon:

- Në DPV-në e vitit 2008 deklarohet kontratë porosie nr. *** prot., datë 9.9.2008, lidhur me shoqërinë “****” sh.p.k. për blerje apartamenti me sip. 76 m² dhe me vlerë totale 60,800 euro. Pjesa takuese: 50 %. Nuk është deklaruar burimi i krijimit, por në rubrikën “detyrime financiare” janë deklaruar dy hua të marra nga shtetasit N. T. dhe I. Ç. (nëna e bashkëshortes dhe babai i subjektit), përkatësisht në shumat 10,000 euro dhe 5,000 euro.

- Në DPV-të e viteve 2011, 2012, 2013 dhe 2014 apartamenti deklarohet në proces regjistrimi pranë ZVRPP-së.

- Në deklarimin për deklaratën *Vetting* si në pikën 1 më sipër.

1.4. Lidhur me burimin e krijimit, gjatë hetimit administrativ janë marrë në shqyrtim burimet e deklaruara, si vijojnë:

1.4.1. Të ardhurat nga pagat

Me të ardhurat e dokumentuara dhe të vërtetuara nga pagat, bashkëshortët Çela kanë krijuar kursime në forme likuiditetesh në banka ose *cash*, të cilat janë deklaruar rregullisht në DPV-të përkatëse dhe janë përfshirë në analizën financiare (trajtuar hollësisht në pikën 1.6 në vijim, “Analizë e detajuar e të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e pasurisë”).

1.4.2. Kontratë huamarrjeje (verbale) në shumën 10,000 euro me vjehrrën e subjektit, znj. N. T.

Në lidhje me këtë hua, nga aktet e administruara u konstatua se nuk ka një dokument shkresor të vitit 2008 që të vërtetojë dhënien e huas. Por, me deklaratën noteriale⁹ nr. *** rep., datë 25.1.2017, shtetasja N. T. deklaroi se në vitin 2008 i ka dhënë hua shumën prej 10,000 euro,

⁴ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 12.10.2018, të “Alpha Bank”.

⁵ Subjekti ka deklaruar për shoqërinë “****” sh.p.k. se është pjesë e grupit “****” sh.p.k., duke vënë në dispozicion printime nga faqja e “****”. Ky fakt është evidentuar edhe nga Komisioni në faqen zyrtare të kësaj shoqërie, https://****.com/rreth-nesh/aktiviteti/.

⁶ Subjekti ka sqaruar në pyetësorin nr. 3 se kjo diferencë ka ardhur për shkak të ndryshimeve në zbatimin e planimetrisë së apartamentit të prenotuar.

⁷ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 13.3.2019, të DPPPP-së, në dosjen e Komisionit.

⁸ Shihni dokumentin bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit.

⁹ Shihni aktin në aneksin nr. ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

pa afat dhe pa interes, vajzës së saj A. A. për ta ndihmuar për blerjen e banesës me bashkëshortin Arens Çela dhe se kjo shumë i është kthyer totalisht. DPPPP-ja¹⁰ ka konfirmuar për znj. A. A. se në datën 25.1.2017 është deklaruar detyrimi i shumës prej 10,000 euro të marrë hua që në vitin 2008 te pala huadhënëse, shtetasja N. T..

Pasi i janë kërkuar sqarime dhe dokumente për të vërtetuar mënyrën e marrjes dhe shlyerjen e huas, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar se: “... shuma prej 10,000 (dhjetë mijë) euro është marrë dorazi, sipas marrëveshjes verbale midis nesh, pa një kontratë të shkruar në formë, për shkak të marrëdhënies të posaçme familjare...”. Për sa i takon periudhës se marrjes së huas, në përgjigje të pyetësorit nr. 3 subjekti ka deklaruar se: “... për rrjedhojë, huat prej prindërve respektivë janë marrë në limitet e pagesës së këstit të dytë të kredisë, pra në muajin dhjetor të vitit 2008, ku më pas i kemi bërë shlyerjen firmës ndërtuese...”.

Edhe pse nuk ka një dokument shkresor në kohë reale që të vërtetojë huan, marrja e saj dhe detyrimet financiare për shkak të saj janë deklaruar rregullisht në DPV-në e vitit 2008 kur është marrë huaja, deri në vitin 2013 kur është deklaruar shuarja e detyrimit financiar, akte të cilat, sipas pikës 45, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016 përbëjnë provë shkresore për efekt të procesit të rivlerësimit.

Për sa i takon shlyerjes së huas, nga verifikimi i DPV-ve dhe dokumenteve bankare të përmendura në këto deklarata, u konstatua se shlyerja e huas është bërë me këste sipas deklarimeve të subjektit, në këtë mënyrë: (1) kësti në shumën 5,000 euro është shlyer *cash* në vitin 2009, deklaruar në DPV-në e vitit 2009; (2) kësti në shumën 3,000 euro është shlyer nëpërmjet “Tirana Bank”, sipas depozitës në arkë në datën 30.12.2011, deklaruar për vitin 2011; si dhe (3) kësti në shumën 2,000 euro është shlyer nëpërmjet “Tirana Bank”, sipas depozitës në arkë në datën 22.1.2013, deklaruar për vitin 2013. Në vitin 2013 është deklaruar shlyerja totale e huas. Gjatë analizës financiare ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë pasur mundësi financiare me të ardhura të ligjshme për të kthyer huan në vitet 2009, 2011 dhe 2013, pasi gjatë këtyre viteve subjekti ka rezultuar me balanca pozitive.

Në lidhje me ligjshmërinë e burimeve financiare për dhënien e huas nga znj. N. T., në cilësinë e personit tjetër të lidhur, u konstatua se:

Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka dhënë sqarime dhe ka paraqitur dokumente shkresore, nga verifikimi i të cilave ka rezultuar se të ardhurat e dokumentuara të ligjshme të znj. N. T. kanë qenë, si vijojnë:

a) Shuma prej 1,900,000 lekësh është përfituar nga shitja e pasurive të paluajjtshme me kontratën noteriale nr. ***, datë 29.8.2006. Sipas kësaj kontrate rezulton se: (i) znj. N. A. (T.) ka qenë pronare e pasurisë apartament, me sip. 20 m², me nr. ***, në Lushnjë; dhe se (ii) znj. N. A. (T.), së bashku me ish-bashkëshortin, shtetasin A. A., kanë qenë bashkëpronarë të pasurisë apartament, me sip. 54 m², me nr. ***, në Lushnjë – pasuri të cilat i kanë shitur përkatësisht në shumat 400,000 lekë dhe 1,500,000 lekë, në total në shumën 1,900,000 lekë. Gjithashtu, subjekti vuri në dispozicion pagesën e tatimit mbi shitjen në ZVRPP-në Lushnjë, në shumën 9,500 lekë, paguar sipas dy mandatarkëtimeve: nr. ***, datë 30.8.2006 dhe nr. ***, datë 30.8.2006.

Referuar kontratës së shitjes, pjesa takuese e znj. N. T. ka qenë në shumën 400,000 lekë nga shitja e pasurisë nr. *** dhe në shumën 750,000 lekë (1/2 e 1,500,000 lekë) nga shitja e pasurisë nr. ***, në total në shumën 1,150,000 lekë. Duke zbritur tatimin e paguar mbi shitjen, në shumën 9,500 lekë, totali i të ardhurave të znj. N. T. nga shitja e dy pasurive është në shumën 1,140,500 lekë.

¹⁰ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 13.3.2019, të administruar në dosjen e Komisionit.

Pavarësisht këtij fakti, në përgjigje të pyetësorit datë 11.2.2020, subjekti ka deklaruar se nëna e bashkëshortes, znj. N. T., edhe pas zgjidhjes së martesës ligjore me shtetasin A. A. ka vijuar bashkëjetesën me të, duke shprehur, ndër të tjera, se *znj. N. T. kishte zgjidhur martesën ligjore me z. A. A. në vitin 1994 dhe sipas vendimit të gjykatës i ish-in lënë në kujdestari tre fëmijët dhe banesa bashkëshortore me nr. pasurie ***. Më tej, ai sqaron se që prej vitit 1999 e në vijim ata kanë bashkëjetuar në të njëjtin apartament deri në vitin 2001, vit në të cilin si familje janë vendosur në Tiranë, në apartamentin e blerë nga babai i bashkëshortes me të ardhurat nga emigracioni, në rr. “R. Ç.”. Në këtë banesë ka jetuar edhe nëna e bashkëshortes deri në vitin 2016, dhe në këto kushte të ardhurat e përfituara nga shitja e banesës në qytetin e Lushnjës, në shumën prej 1,900,000 lekësh, janë administruar prej saj. Në vitet 2006, 2007 dhe 2008 ajo ka qenë në certifikatë familjare si kryefamiljare, së bashku me tre fëmijët e saj (A. A. është shkëputur nga trangu familjar në vitin 2007).*

Me qëllim verifikimin e pretendimeve të subjektit, u pyet, në cilësinë e dëshmitarit, babai i bashkëshortes se subjektit, z. A. A., i cili në deklarimet e tij pohoi¹¹ se pas zgjidhjes së martesës ka bashkëjetuar me znj. N. T. dhe se të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë së përbashkët në Lushnjë, sipas tij në shumën rreth 2,500,000 lekë, të ardhurat e tij nga emigracioni, si dhe çdo të ardhur i ka administruar gjithmonë ish-bashkëshortja e tij, duke nënkuptuar që të ardhurat nga shitja e pasurive në Lushnjë janë përdorur për dhënien e huas prej 10,000 euro vajzës së tyre. Ndërkohë deklaroi se nuk disponon dokumente për të vërtetuar të ardhurat nga emigracioni, për shkak se kanë qenë vite të hershme.

Gjithashtu, Komisioni kërkoi nga DPGJC-ja adresat e regjistrimit në gjendjen civile të shtetasve N. T. dhe A. A., nga ku rezultoi se në regjistrin kombëtar të gjendjes civile të dy këta shtetas figurojnë të regjistruar banorë në të njëjtën adresë, pallat dhe në të njëjtën shkallë¹²: rr. “R. Ç.”, p. ***, shk. ***, ap. ***, Tiranë. Pra, edhe pasi kanë ardhur në Tiranë, ish-bashkëshortët ligjorë, A. A. dhe N. T., figurojnë të regjistruar në të njëjtën adresë të gjendjes civile, e cila përkon me adresën e pasurisë nr. ***, z. k. ***, Tiranë, në pronësi të shtetasit A. A., fakt që hedh dritë mbi pretendimin e subjektit mbi bashkëjetesën e tyre edhe pas zgjidhjes së martesës, si dhe mbi deklarimet e këtij shtetasi.

Nisur nga sa më sipër, në përfundim të hetimit administrativ, shuma e përfituar prej 1,900,000 lekësh nga shitja e pasurive në Lushnjë është konsideruar si burim i ligjshëm i huas 10,000 euro dhënë prej znj. N. T.. Ndërkohë, në rubrikën “shpenzime të analizës financiare”, të kryer për hua dhënësen N. T., është përfshirë edhe shtetasi A. A..

b) Të ardhura nga shitja e pasurisë tokë truall në qendër të qytetit të Lushnjës, pasuri në bashkëpronësi, si trashëgimtare e radhës së parë me 1/12 pjesë takuese, sipas kontratës nr. ***, datë 27.11.2006, me çmim shitjeje 1,000,000 lekë. Subjekti pretendon se realisht znj. N. T. ka përfituar nga shitja e pasurisë shumën 4,631 euro, por nuk e vërteton këtë pretendim me dokumente shkresore. Nga kontrata e shitjes së kësaj pasurie, për shitësen N. T. vërtetohet e ardhura në shumën 83,000 lekë, e cila u përfshi në analizën financiare.

c) Të ardhura të shtetasi D. A., djali i znj. N. T., si i vetëpunësuar, po pa u dokumentuar pagimi i sigurimeve shoqërore dhe detyrimeve tatimore.

ç) Të ardhura nga shtetasja D. A., vajza e znj. N. T., në shumën 369,476 lekë, për periudhën 2007 – 2008, të cilat, pasi u dokumentuan, u përfshinë në analizën financiare.

Për të verifikuar mundësinë e personit të lidhur, znj. N. T., për dhënien e huas 10.000 euro në vitin 2008, Komisioni ka kryer analizë financiare me të dhënat që dispononte, nga data 1.9.2006 (referuar faktit që më 30.8.2006 është shitur pasuria në Lushnjë) deri në fund të vitit 2008 kur

¹¹ Shihni procesverbalin e pyetjes së shtetasit A. A., në dosjen e Komisionit.

¹² Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 19.6.2020, nga DPGJC-ja, në dosjen e Komisionit.

është dhënë huaja, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën vijuese, ku shpenzimet e jetesës janë llogaritur për 4 persona¹³.

Përshkrimi	Shtator 2006 – 2008
Të ardhura	2 352 809
Nga shitja e dy pasurive, datë 30.8.2006, Lushnjë	1 900 000
Shitje prone e paluajtshme truall në vitin 2006	83 333
Të ardhura nga paga, D. A.	369 476
Shpenzime	2 470 861
Dhënë hua për apartamentin, shuma 10,000 euro	1 231 825
Shpenzimet e jetesës sipas standardit të ILDKPKI-së	1 239 036
Mundësia për kursime	-118 052

Siç duket nga tabela, në fund të vitit 2008 personi i lidhur, znj. N. T., dhe familja e saj, kanë pasur të ardhura të ligjshme në shumën 2,352,809 lekë, të cilat, pavarësisht një balance negative prej 118,052 lekësh të rezultuar nga përlllogaritja e huas, plus shpenzimeve jetike, në përfundim të hetimit administrativ, nga Komisioni u konsideruan të mjaftueshme për të dhënë shumën e huas prej 10,000 euro në vitin 2008 vajzës së saj, bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit. Në këtë vlerësim Komisioni ka mbajtur në konsideratë faktin që kjo analizë i përket nënës së bashkëshortes së subjektit, e cila, si ajo, ashtu edhe familjarët e saj, nuk kanë qenë subjekte deklaruese dhe, për rrjedhojë, nuk kanë pasur detyrimin e deklarimit të të ardhurave, si dhe faktit që në mungesë të të dhënave të plota ka qenë objektivisht e pamundur për të kryer një analizë të saktë dhe të mirëfilltë të gjendjes së tyre financiare. Në këto kushte, Komisioni çmon se analiza e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor është më afër situatës reale të gjendjes financiare të familjes së znj. N. T..

1.4.3. Kontratë huamarrjeje verbale në shumën 5,000 euro me babain e subjektit, z. I. Ç.

Në lidhje me këtë burim, nga aktet në dosje rezulton se nuk ka një akt shkresor të vitit 2008 që të vërtetojë dhënien e huas. Por, me deklaratën noteriale nr. ***, datë 23.1.2017¹⁴, shtetasi I. Ç. deklaron se në vitin 2008 i ka dhënë hua shumën 5,000 euro, pa afat dhe pa interes, djalit të tij Arens Çela për blerjen e banesës bashkëshortore, së bashku me shtetasen A. A. dhe se kjo shumë i është kthyer totalisht.

Pasi i janë kërkuar sqarime dhe dokumente për të vërtetuar mënyrën e marrjes dhe shlyerjes së huas, në pyetësonin nr. 2 subjekti ka deklaruar se: “... shuma prej 5,000 (pesë mijë) euro është marrë dorazi, sipas marrëveshjes verbale midis nesh, pa një kontratë të shkruar në formë, për shkak të marrëdhënies të posaçme familjare...”. Ndërsa, për sa i takon periudhës, në përgjigje të pyetësonit nr. 3, subjekti ka deklaruar se: “... huat prej prindërve respektivë janë marrë në limitet e pagesës së këstit të dytë të kredisë, pra, në muajin dhjetor të vitit 2008, ku më pas i kemi bërë shlyerjen firmës ndërtuese”.

Edhe pse marrëdhënia e huas nuk është formalizuar me akt shkresor në kohë reale, në DPV-në e vitit 2008, periudhë kur është marrë huaja, dhe deri në vitin 2012 kur është deklaruar shuarja e detyrimit financiar, subjekti ka deklaruar rregullisht dhe saktësisht në lidhje me huan verbale të marrë prej babait të tij, z. I. Ç., si dhe detyrimin financiar të mbetur. Nga analiza financiare ka rezultuar se huaja është shlyer me të ardhura të ligjshme dhe subjekti ka rezultuar me balancë pozitive gjatë vitit 2012.

¹³ Në përbërjen familjare janë konsideruar 4 persona: N. T., dy fëmijët e saj D. dhe D. A., si dhe babai i fëmijëve, A. A..

¹⁴ Shihni aktin në aneksin nr. ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

Në lidhje me ligjshmërinë e burimeve financiare për dhënien e huas nga z. I. Ç., në cilësinë e personit tjetër të lidhur, është konstatuar se:

Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se: *“Prindërit e mi, znj. P. Ç. dhe z. I. Ç., në periudhën kohore të dhënies së huas prej 5,000 (pesë mijë) euro kanë realizuar të ardhura prej pagës së tyre si mjekë, në qytetin e Lushnjës...”*. Për të vërtetuar këtë pretendim subjekti ka paraqitur vërtetimet e pagave për periudhën 1994 – 2016, të prindërve të tij P. Ç.¹⁵ dhe I. Ç.¹⁶.

Gjithashtu, subjekti pretendoi se përveç të ardhurave nga paga, nëna e tij P. Ç. ka pasur një depozitë në shumën 500,000 lekë në “Raiffeisen Bank”, në emër të saj dhe të nënës L. P., duke sqaruar se: *“... kjo llogari ka qenë në emër të gjyshes time, të ndjerës L. P. dhe nëna ime ka qenë përfituesja pas vdekjes së gjyshes në datën 19.4.2005, sipas parashikimit të kontratës me bankën¹⁷...”*. Pretendimet e subjektit në lidhje me këtë shumë vërtetohen me shkresën për nxjerrje llogarie të “Raiffeisen Bank”¹⁸, shumë e cila është përfshirë si e ardhur ligjore në analizën financiare.

Nga verifikimi i të gjitha dokumenteve të administruara ka rezultuar se në vitet 2007 dhe 2008 bashkëshortët Çela kanë pasur: të ardhura nga pagat në shumën 1,964,265 lekë; të ardhura nga një kredi e marrë në “Alpha Bank” në shumën 10,000 euro¹⁹; si dhe teprica të kursyera deri në vitin 2006 në shumën 1,348,627 lekë. Ndërkohë, pasi janë verifikuar informacionet nga bankat dhe institucionet e tjera në lidhje me pasuritë e personit të lidhur I. Ç., Komisioni ka kryer një analizë financiare me të dhënat që disponohen, pasqyruar të përmbledhura sipas tabelës në vijim, duke llogaritur shpenzimet e jetesës për 4 persona, sipas standardit të ILDKPKI-së, tabelë e cila mund të ndryshonte në varësi të deklarimeve dhe provave që subjekti mund të paraqiste deri në përfundim të procesit.

Analiza e prindërve të subjektit	Viti 2007	Viti 2008	Totali deri në vitin 2008
Pasuri	8 424	7 326 298	7 334 722
Blerë apartament në Lushnjë, datë 24.10.2008		4 143 480	4 143 480
Blerë apartament në Lushnjë, datë 26.8.2008		3 200 000	3 200 000
<i>Shtesa/pakësime, likuiditete</i>	<i>8 424</i>	<i>-17 182</i>	<i>-8 758</i>
Të ardhura të dokumentuara	3 503 354	988 410	4 491 764
Të ardhura nga z. I. Ç.	603 548	585 970	1 189 518
Të ardhura nga znj. P. Ç.	372 307	402 440	774 747
Marrë kredi 10,000 euro te “Alpha Bank”	1 178 873		1 178 873
Mbartur nga vitet e mëparshme	1 348 627		1 348 627
Shpenzime	691 572	1 384 121	2 075 693
Shpenzime jetese	546 480	546 480	1 092 960
Dhënë hua subjektit, 5,000 euro		615 913	615 913
Shlyer kredia te “Alpha Bank”	145 092	221 729	366 821
Mundësia për kursime	2 803 358	-7 722 009	-4 918 651

¹⁵ Vërtetim nr. *** prot., datë 31.8.2018, i Ministrisë së Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, Qendra Shëndetësore Lushnjë; vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare *neto* nga Qendra Shëndetësore nr. 1, Lushnjë, për vitet 2007 - 2017; vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare *neto* nga DRFSDKSH-ja për periudhën 2002 – mars të vitit 2007; vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare *neto* nga Drejtoria e Kujdesit Shëndetësor për periudhën 1994 – korrik 1995.

¹⁶ Vërtetim nr. *** prot., datë 13.8.2018, i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë për vitet 2006 - 2016; vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* nga Drejtoria e Kujdesit Shëndetësor Lushnjë për periudhën 1994 – qershor 2016.

¹⁷ Nga verifikimi i lëvizjes së llogarisë në emër të shtetasës P. Ç. në “Raiffeisen Bank”, rezultoi se kjo shumë ka qëndruar e investuar në depozitë me afat dhe me maturimin e saj është tërhequr në datën 8.6.2007.

¹⁸ Shihni shkresën nxjerrje llogarie në “Raiffeisen Bank”, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2.

¹⁹ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. ***, datë 18.2.2019, të “Alpha Bank”, në dosjen e Komisionit.

<i>Mundësia për kursime kumulative</i>	2 803 358	-4 918 651
--	-----------	------------

Analiza e mësipërme fillon në vitin 2007, pas analizës financiare të kryer për dhurimin e shumës 500,000 lekë ndaj subjektit në vitin 2006 për blerjen e një automjeti²⁰ dhe mbaron në vitin 2008, kur është dhënë huaja 5,000 euro. Siç vërehet nga kjo analizë, të ardhurat në total prej 4,491,764 lekësh nuk kanë mjaftuar për të krijuar pasuritë dhe likuiditetet e vëna gjatë këtyre viteve nga prindërit e subjektit për shkak të një balance negative prej 4,918,651 lekësh.

Për sa më sipër, në përfundim të hetimit administrativ duket se personi i lidhur, z. I. Ç., nuk ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për t'i dhënë hua në shumën prej 5,000 euro në vitin 2008 subjektit të rivlerësimit, dhe për këtë arsye kjo hua nuk është përfshirë në analizën financiare. Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 subjektit i kaloi barra e provës për të vërtetuar të kundërtën e konstatimit të mësipërm.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

Në parashtrimet e tij, subjekti ka kundërshtuar barrën e provës, duke shpjeguar dhe pretenduar se:

Së pari, në analizën financiare të prindërve të tij, blerja e dy apartamenteve në Lushnjë është pasqyruar si shpenzim i kryer në vitin 2008, si në tabelën e mësipërme, ndërkohë që këto shpenzime janë kryer prej tyre në vitet 2006 dhe 2007, pra, përpara dhënies së huas prej 5,000 euro në fund të vitit 2008, si dhe para marrjes së detyrës së prokurorit nga subjekti, datë 4.10.2006.

Për të vërtetuar këtë pretendim subjekti ka paraqitur dokumentet shkresore, si vijojnë:

a. Kontratë porosie nr. ***, datë 10.3.2006, midis z. I. Ç., në cilësinë e porositësit, dhe z. A. N., në cilësinë e sipërmarrësit, me objekt porositjen e dy apartamenteve të poshtëshënuara në qytetin e Lushnjës:

1) apartament 2+1, me sipërfaqe totale 107 m², në çmimin 37,450 euro, shumë e cila do të likuidohet në këtë mënyrë: (i) shuma 2,450 euro u likuidua në dorë para redaktimit të kontratës; (ii) kësti i parë prej 15,000 euro do të paguhej deri në datën 20.3.2006; (iii) kësti i dytë prej 30% të shumës së mbetur, ose 6,000 euro, do të paguhej deri në datën 30.10.2006; si dhe (iv) diferenca e mbetur do të paguhej në momentin e përfundimit dhe të dorëzimit të porositësi;

2) apartament 1+1, me sip. 77 m², në çmimin 26,950 euro, shumë e cila do të likuidohet në këtë mënyrë: (i) kësti i parë në shumën 10,000 euro do të paguhej deri në datën 20.3.2006; (ii) kësti i dytë në shumën prej 30 % të vlerës së mbetur pa likuiduar, ose 6,865 euro, do të paguhej deri më 30.10.2006; si dhe (iii) diferenca e mbetur do të likuidohet në momentin e përfundimit dhe të dorëzimit të porositësi.

Sipas kësaj kontrate, afati i përfundimit të objektit do të jetë 15 muaj nga data e lidhjes së saj, pra në datën 10.6.2007, fakt që vlerësohet se hedh dritë mbi pretendimin e subjektit që pagesat për blerjen e pasurive janë kryer përpara këtij afati.

b. Kontratë me shoqërinë KESH sh.a., të hapur në datën 12.9.2007, në emër të z. I. Ç., nëpërmjet së cilës subjekti provon se prindërit kanë banuar në njërin prej apartamenteve që në vitin 2007, fakt që hedh dritë mbi pretendimin se apartamentet janë dorëzuar të përfunduara këtë vit dhe pagesa e çmimit të shitjes është kryer brenda vitit 2007.

²⁰ Shihni pikën 1 në rubrikën "konstatime të tjera".

c. Mandatarkëtim nr. ***, datë 18.3.2006, për pagimin e vlerës 35,000 USD, me përshkrimin e pagesës “për këstin e parë të shtëpive”.

ç. Kontratë kredie bankare datë 23.4.2007, me “Alpha Bank” sh.a., në shumën 10,000 euro, në emër të prindërve të subjektit, I. dhe P. Ç., e cila sipas tij, por edhe logjikisht, është përdorur për pagesën e vitit 2007.

Bazuar në sa më sipër, pavarësisht se apartamentet në Lushnjë janë blerë nga babai i subjektit, z. I. Ç., me kontratat përfundimtare të shitjes në vitin 2008²¹, nëpërmjet provave shkresore të paraqitura, subjekti vërtetoi pretendimin e tij se çmimi i tyre në vlerën totale 64,400 euro/7,343,480 lekë, nuk është paguar në vitin 2008 ashtu sikurse Komisioni e kishte llogaritur, por në vitet 2006 dhe 2007. Për rrjedhojë, në vlerësimin përfundimtar të çështjes, Komisioni çmoi se kjo vlerë duhet të hiqet nga rubrika “pasuri” në analizën financiare të vitit 2008, fakt që ndikon këtë analizë duke ndryshuar balancën nga negative në pozitive.

Së dyti, subjekti ka pretenduar të ardhura të prindërve të tij në shumën 1,800,000 lekë nga shitja e një apartamenti në Lushnjë në datën 13.11.2006, për të cilin ka paraqitur dokumentet, si vijojnë:

a. Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 25.6.1997, sipas të cilës shitësi V. Z. (vërtetuar pronësia me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 1.7.1996) i shet blerësit I. Ç. apartamentin me sip. 65 m², në Lushnjë (ngjitur me apartamentin e blerësit), në shumën 1,150,000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale. Këtë pasuri shtetasi V. Z. e kishte blerë nga shtetasi I. L. me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 1.7.1996, në shumën 775,000 lekë (apartament me sip. 62 m², p. ***, k. ***, h. ***, lagjia “L. Dh.”, Lushnjë).

b. Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 13.11.2006, sipas së cilës shitësit I. L. dhe M. L., përfaqësuar me prokurë të posaçme nr. ***, datë 13.9.2006, nga z. I. Ç., i shesin blerësve J. A. dhe K. A. apartamentin me sip. 65 m² në Lushnjë, në çmimin 1,800,000 lekë.

Në lidhje me këtë kontratë, subjekti ka sqaruar se: *“Në kontratë, babai im, z. I. Ç., del si përfaqësues i shitësit I. L., pasi më ka shpjeguar se noteri publik, në momentin që do përpilonte kontratën e shitjes, ka konstatuar se kontratat e mëparshme të shitjeve midis shtetasve I. L. dhe V. Z. dhe këtij të fundit dhe babait tim, nuk ishin regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme. Mosregjistrimi i kontratave noteriale të shitjeve të njëpasnjëshme, pranë ASHK-së (ish-ZVRPP) sipas asaj që më ka treguar babai im, ka ndodhur për shkak të situatës së jashtëzakonshme që kalonte vendi në vitin 1997, dhe sipas tij askush s’i kishte kërkuar këtë dokumentacion, kur ka bërë blerjen e kësaj prone”.*

Nga përmbajtja e të dyja kontratave të sipërpërmendura, konstatohet se:

i) Në vitin 1997 prindërit e subjektit kishin blerë nga shtetasi V. Z. një apartament me sip. 65 m². Nga përmbajtja e kontratës së shitblerjes, pronësia e shtetasit V. Z. mbi këtë apartament ishte vërtetuar vetëm me kontratën e shitblerjes së lidhur midis shitësit I. L. dhe blerësit V. Z., në vitin 1996.

²¹ Për pasurinë apartament me sip. 96.36 m², me nr. ***, shihni kontratën nr. ***, datë 24.10.2008, në dokumentet e vëna në dispozicion nga ASHK-ja Lushnjë, me shkresën nr. *** prot., datë 4.3.2019. Për pasurinë apartament banimi me sip. 66.3 m², me nr. ***, ASHK-ja Lushnjë nuk ka vënë në dispozicion kontratën e blerjes së kësaj pasurie nga z. I. Ç., për shkak se është shitur prej tij me kontratën nr. ***, datë 24.12.2011, të cilën e ka vënë në dispozicion. Në përmbajtjen e kësaj kontrate evidentohet se kjo pasuri, objekt shitjeje, është blerë nga z. I. Ç. me kontratën nr. ***, datë 26.8.2008, e cila është regjistruar në ZVRPP-në Lushnjë sipas vërtetimit nga dokumenti hipotekor, lëshuar në datën 30.9.2008. Në rubrikën “Komente nga regjistruesi” të këtij vërtetimi, është shënuar se pasuria është blerë me kontratën nr. ***, datë 26.8.2008. Në kartelën e kësaj pasurie figuron se çmimi i blerjes së pasurisë është 3,200,000 lekë. Vërtetimin nga dokumenti hipotekor me datë lëshimi 30.9.2008, e gjeni bashkëlidhur me shkresën nr. *** prot., datë 1.8.2019, të “Alpha Bank”, në dosjen e Komisionit. Kartelën e pasurisë e gjeni bashkëlidhur me shkresën e dërguar nga ASHK-ja Lushnjë. Për rrjedhojë, është vërtetuar blerja me akte përfundimtare shitjeje të dy pasurive nga personi tjetër i lidhur, z. I.Ç., në vitin 2008, në vlerën totale prej 7,343,480 lekësh, të cilat kanë qenë porositur prej tij me kontratën e porosisë nr. ***, datë 10.3.2006.

ii) Ne vitin 2006, prindërit e subjektit ia shitën këtë pasuri në vlerën 1.800.00 lekë blerësve J. A. dhe K. A.. Duke qenë se apartamenti në fjalë nuk ishte regjistruar as në pronësi të shitësit të parë shtetasit V. Z., dhe as në emër të babait të subjektit I. Ç., pasi ky e bleu nga V. Z., zgjidhja ligjore e noteres ka qenë që në kontratën e datës 13.11.2006, si palë shitëse të ishin shitësit e parë të pasurisë, shtetasit I. L. dhe M. L., të cilët përfaqësoheshin me prokurë nga shtetasi I. Ç., i cili ka nënshkruar në emër të tyre në cilësinë e shitësve dhe palë blerëse J. A. dhe K. A.. Pra, kështu, sikurse subjekti pretendon, pavarësisht se *de jure* pronarët e pasurisë kanë qenë shtetasit I. L. dhe M. L., *de facto* pronar i saj ka qenë shtetasi I. Ç.. Në këtë konkluzion, Komisioni arriti në vlerësim të të gjitha fakteve dhe provave që subjekti ka paraqitur pas kalimit të barrës së provës, si dhe në referencë të vendimit nr. ***, datë 6.1.2009, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë për unifikimin e praktikës gjyqësore, ku midis të tjerave, është cituar se: *“Në funksion të unifikimit të praktikës gjyqësore Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konkludojnë se: ‘Pronësia mbi një pasuri të paluajtshme kalon në çastin e lidhjes së kontratës së tjetërsimit të kësaj pasurie. Blerësi ose përfituesi i kësaj pasurie bëhet pronar i ligjshëm i saj, që në momentin e nënshkrimit të kontratës, duke fituar dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen me qenien e tij si pronar mbi këtë pasuri’. ‘Pra, transkriptimi/regjistrimi në regjistrat përkatës publikë kërkohet për veprimet juridike (kontratat) që tjetërsojnë pasuritë e paluajtshme, për veprime juridike (kontrata) që kanë lidhje me të drejtat reale mbi sende të caktuara (kontrata e qirasë mbi 9 vjet), si dhe për sende të luajtshme të një kategorie të veçantë, siç janë anije, aeroplanë, automjete, etj. Transkriptimi ose regjistrimi nuk është gjë tjetër veçse një mjet i nevojshëm për t’i dhënë publicitetin kontratës, për të bërë të njohur ekzistencën e saj dhe të pronarit nga të tretët. Transkriptimi ka funksionin e publikimit deklarativ. Kontrata si veprim juridik i dyanshëm, në rast se plotëson kushtet për vlefshmërinë e saj edhe në rast se nuk regjistrohet në regjistrin e pasurive të paluajtshme është plotësisht e vlefshme mes palëve që e kanë realizuar atë. Është kontrata ajo që transferon mes palëve pronësinë e sendit të paluajtshëm, krijon të drejta reale mbi sendin dhe legjitimon pronarin të kërkojë dhe mbrojë këto të drejta”*.

Bazuar në të gjitha sa më sipër, për sa kohë subjekti ka provuar me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 25.6.1997, marrëdhënien e shitblerjes mes shtetasit V. Z. (i cili nuk e kishte regjistruar në hipotekë këtë pasuri), në cilësinë e shitësit, dhe babait të tij I. Ç., në cilësinë e blerësit, Komisioni vlerësoi se nuk mund të vihet në dyshim pronësia e prindërve të subjektit mbi këtë apartament, dhe për pasojë edhe përfitimi prej tyre i shumës prej 1,800,000 lekësh nëpërmjet kontratës së shitjes së pasurisë me akt noterial nr. ***, datë 13.11.2006.

Për rrjedhojë, shuma prej 1,800,000 lekësh, përfituar në datën 13.11.2006, është konsideruar si e ardhur e ligjshme në analizën financiare të vitit 2007, për personin tjetër të lidhur, z. I. Ç.. Duke qenë se pagesa e radhës për çmimin e blerjes së dy apartamenteve sipas kontratës së porosisë së vitit 2006 është kryer në datën 30.10.2006, shuma prej 1,800,000 lekësh e përfituar më 13.11.2006, është konsideruar si e ardhur e mbartur nga viti 2006 dhe e përdorur në vitin 2007.

Së treti, subjekti kërkon të llogariten shpenzimet për konsum për 3 persona dhe jo për 4, sikurse është përlllogaritur nga Komisioni. Kjo për arsye se, sipas tij, subjekti ka krijuar të ardhura personale që prej vitit 2004 dhe, për rrjedhojë, edhe shpenzimet e tij i ka përballuar vetë, pretendim i cili qëndron. Për sa i takon vëllait A. Ç., subjekti pretendon se ka krijuar të ardhura personale që prej tetorit të 2008, si kandidat magjistrat në Shkollën e Magjistraturës, pretendim i cili është i vërtetë²². Bazuar në këto pretendime, janë rishikuar shpenzimet e jetesës, fakt që ka ndikuar në analizën financiare përfundimtare për periudhën 2007 – 2008, pasqyruar në tabelën vijuese.

²² Shihni kopje të diplomës me titullin “Magjistrat” të z. A. I. Ç., nga e cila evidentohet se ka ndjekur Shkollën e Magjistraturës për periudhën 2008 – 2011.

Analiza e prindërve të subjektit	Periudha 2007 – 2008
PASURI	3 118 579
Pagesat e kryera për 2 apartamentet gjatë vitit 2007	3 127 337
<i>Shtesa/pakësime, likuiditete</i>	-8 758
Të ardhura të dokumentuara	4 943 138
Të ardhura nga paga e z. I. Ç.	1 189 518
Të ardhura nga paga e znj. P. Ç.	774 747
Nga shitja e pasurisë (ap. Lushnjë) më 30.11.2006	1 800 000
Marrë kredi 10,000 euro te “Alpha Bank”	1 178 873
SHPENZIME	1 768 298
Shpenzime jetese ²³	785 565
Dhënë hua subjektit, 5,000 euro	615 913
Shlyer këste kredie te “Alpha Bank”	366 821
Mundësia për kursime	56 260

Së katërti, subjekti ka sjellë në vëmendje vendimin nr. 15, datë 17.7.2019, të KPA-së, i cili orienton Komisionin për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme, sipas paragrafit 2, të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, si vijon: *“Kolegji çmon se në rastet kur subjekti i rivlerësimit gjendet para situatës së parashikuar prej nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ai duhet të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të asaj pasurie, e cila është objekt dhurimi apo huaje, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë që kanë personat e tjerë të lidhur. Interpretimi në të kundërt i kësaj dispozite konsiderohet se shkel parimin e proporcionalitetit, pasi e ngarkon subjektin me një barrë përtej asaj që ai ligjërisht është ngarkuar të mbajë dhe barazon statusin e një shtetasi tjetër, personit tjetër të lidhur, që përgjithësisht nuk ka figuruar të ketë qenë subjekt deklarues, me atë të vetë subjektit të rivlerësimit, një mision që del jashtë qëllimit të ligjit e për më tepër duket edhe i pamundur”*.²⁴

Për sa i takon argumenteve të paraqitura në lidhje me analizën që i bëhet pasurive të personave të tjerë të lidhur, Komisioni çmon se me të drejtë subjekti i është referuar qëndrimit të KPA-së, por nënvizon faktin që në rastin konkret subjekti ka deklaruar marrjen e huas prej 5,000 euro në dhjetor të vitit 2008, ndërkohë që kontratat për blerjen e dy apartamenteve të banimit prej babait të tij, z. I. Ç., janë redaktuar pak kohë më parë se dhënia e huas, përkatësisht në datat 26.8.2008 dhe 24.10.2008. Për këtë arsye, përfshirja e këtyre pasurive në analizën financiare për të verifikuar mundësinë e dhënies së huas prej 5,000 euro në dhjetor të vitit 2008, ka qenë sa e pashmangshme, aq edhe e domosdoshme. Përveç kësaj, hetimi i kryer nga Komisioni, si dhe provat e paraqitura nga subjekti në ushtrim të barrës së provës, vërtetuan në mënyrë shteruese se nuk ka asnjë lidhje midis subjektit dhe dy pasurive të blera në qytetin e Lushnjës nga babai i tij I. Ç., në cilësinë e personit tjetër të lidhur. Për më tepër, u vërtetua se pagesat për blerjen e këtyre apartamenteve nuk janë kryer brenda vitit 2008, kur është dhënë huaja prej 5,000 euro, por në vitet 2006 dhe 2007, pjesërisht kur subjekti nuk ka qenë në detyrë dhe pjesërisht brenda një viti që ai ka filluar detyrën si prokuror.

Bazuar në të gjitha sa më sipër arsyetuar, në përfundim të procesit të rivlerësimit, subjekti arriti të kundërshtojë bindshëm barrën e provës në lidhje me pamundësinë e babait të tij, z. I. Ç., për të justifikuar me të ardhura të ligjshme dhënien e huas në shumën 5,000 euro në vitin 2008, shumë e cila u përfshi si e ardhur e ligjshme në analizën financiare përfundimtare.

²³ Shpenzimet e jetesës janë përlogaritur për 3 persona për periudhën 1.1.2007 – 1.10.2008 dhe pas kësaj date deri më 31.12.2008, vetëm për prindërit e subjektit.

²⁴ Cituar paragrafi 110 i përmbajtjes së vendimit nr. 15, datë 17.7.2019, të Komisionit të Posaçëm të Apelit.

1.4.4. Kontratë kredie bankare me “Alpha Bank” sh.a., në vlerën 3,000,000 lekë

Në lidhje me këtë burim, nga verifikimi i akteve shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja dhe Komisioni, gjatë hetimit administrativ²⁵ rezultoi se:

- Me kontratën kufi kredie shumëqëllimore nr. ***, datë 22.1.2009, me “Alpha Bank”, vërtetohet akordimi i kredisë në kufirin prej 4,300,000 lekësh, me qëllim blerje apartamenti, me palë kredimarrëse shtetasit Arens Çela dhe A. A. dhe dorëzanës prindërit e subjektit, shtetasit I. Ç. e P. Ç., të cilët nëpërmjet kontratës së hipotekës kanë vënë në hipotekë në favor të bankës dy pasuri: (1) apartament me sip. 66.30 m², në Lushnjë; dhe (2) apartament me sip. 96.36 m², në Lushnjë.

- Në datën 3.2.2009 është bërë disbursimi i kredisë në shumën 3,000,000 lekë, e cila ka kaluar në datën 1.12.2011 në llogarinë dyemërore të shtetasve A. A. dhe Arens Çela.

- Në datën 10.3.2009 shuma prej 2,550,000 lekësh është konvertuar në euro dhe po në këtë datë shuma 20,000 euro ka kaluar në llogari të shoqërisë “****” sh.p.k.

Nga deklaratimet periodike vjetore, rezultoi se subjekti ka deklaruar rregullisht në lidhje me marrjen dhe shlyerjen e kredisë me të ardhura të ligjshme, si vijon:

- Në DPV-në e vitit 2009 është deklaruar kontratë kredie bankare me “Alpha Bank” sh.a., në vlerën 3,000,000 lekë, me afat 13-vjeçar, me këste të barabarta mujore në vlerën 34,100 lekë, solidare nën detyrim me bashkëshortin, në masën 50 %. Shuma e shlyer: 341,000 lekë. Gjendja e detyrimit të mbetur: 2,891,655 lekë. Nga analiza financiare e vitit 2009 subjekti rezulton me balancë pozitive, si rrjedhim, ka pasur mundësi me të ardhura të ligjshme për të kryer pagesën.

- Në DPV-në e vitit 2010 është deklaruar shuma e shlyer prej 866,500 lekësh dhe shuma e mbetur prej 2,316,810 lekësh. Nga analiza financiare e vitit 2010 subjekti rezulton me balancë pozitive, si rrjedhim, ka pasur mundësi me të ardhura të ligjshme për të kryer pagesën.

- Në DPV-në e vitit 2011 është deklaruar shlyerja e shumës prej 2,505,020 lekësh, si dhe shlyerja totale e kredisë. Në këtë vit, subjekti deklaroi huan në shumën 1,430,000 lekë marrë nga babai i tij I. Ç., me qëllim shlyerjen e kredisë. Lidhur me mundësinë e pagesës së diferencës prej 1,205,020 lekësh (2,505,020 lekë - 1,300,000 lekë²⁶), referuar analizës financiare të vitit 2011, rezulton se subjekti ka pasur mundësi financiare me të ardhura të ligjshme për shlyerjen e saj²⁷.

Për sa i takon shlyerjes së kredisë, me dokumentin e lëshuar nga “Alpha Bank” në datën 24.10.2016, është vërtetuar se shlyerja ka përfunduar më 1.12.2011, dhe për shkak të një periudhe shumë të shkurtër deri në fund të vitit, analiza financiare është ajo e kryer për vitin 2011.

Nga analiza financiare e viteve përkatëse është konstatuar se subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të shlyer kredinë, me shumë fillestare 3,000,000 lekë marrë në “Alpha Bank” në vitin 2009, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën vijuese:

²⁵ Shihni aktet në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së: shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 1.8.2019, nga “Alpha Bank”; shkresën nr. *** prot., datë 12.10.2018, dhe nr. *** prot., datë 20.11.2020, nga “Alpha Bank”, në dosjen e Komisionit; si dhe shkresa kthim përgjigje nr. *** prot., datë 13.3.2019, e DPPP-së, konfirmon të dyja transaksionet e kryera dhe pikërisht: (i) në datën 10.3.2009 është deklaruar tërheqje *cash* nga llogaria në “Alpha Bank” në shumën 2,550,000 lekë; (ii) në datën 10.3.2009 është deklaruar depozitim në llogari në “Alpha Bank”, në shumën 20,030 euro.

²⁶ Nga shuma 1,430,000 lekë transferuar nga babai te subjekti, shuma 1,300,000 lekë ka kaluar për shlyerje kredie, ndërsa shuma 144,000 lekë ka kaluar për krijimin e një depozite-garanci për kartën e kreditit.

²⁷ Referuar analizës financiare për vitin 2011, subjekti rezulton me një balance negative në shumën 26,293 lekë, balancë e cila për shkak të vlerës së vogël, dhe për efekt të marzhit të ndonjë gabimi në llogaritje, nuk është marrë në konsideratë.

Përshkrimi	Viti 2009	Viti 2010	Viti 2011
Pasuri	432 150	218 824	-271 278
<i>Shtesa/pakësime, likuiditete</i>	432 150	218 824	-271 278
Detyrime	-564 240	-1 090 036	-1 300 563
Detyrim ndaj “***” 23,800 euro	-2 743 400	-505 685	
Kredi 3,000,000 lekë në “Alpha Bank”	2 865 010	-584 351	-2 315 663
Hua 10,000 euro nga znj. N. T.	-685 850		-414 900
Hua 1,430,000 lekë nga babai I. Ç.			1 430 000
Të ardhura të dokumentuara	1 830 028	2 176 932	1 814 650
Të ardhura nga paga e subjektit	1 010 824	867 472	906 128
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	819 204	859 460	908 522
Të ardhura nga shitja e automjetit “Mercedes-Benz”		450 000	
Shpenzime	668 216	717 077	811 658
Shpenzime jetese	341 550	409 860	409 860
Paguar interesa për kredinë te “Alpha Bank”	238 666	240 136	170 348
Shpenzime udhëtimi sipas sistemit <i>TIMS</i>	0	13 881	207 450
Shpenzime udhëtimi ditore	88 000	53 200	24 000
Mundësia për kursime	165 422	150 996	-26 293

Si burim për shlyerjen e kësteve të kredisë, gjatë periudhës 2009 – 2011 kanë shërbyer të ardhurat nga: (i) pagat e subjektit dhe të bashkëshortes; (ii) shitja e një automjeti; si dhe (iii) huaja 1,430,000 lekë marrë nga babai i subjektit në vitin 2011 (trajtuar në vijim në pikën 1.5).

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, balanca negative e vitit 2011 ka ndryshuar për shkak të përfshirjes si e ardhur e shumës 122,400 lekë, përfituar nga bashkëshortja nga mësimdhënia në Albanian University, pretenduar dhe vërtetuar nga subjekti gjatë parashtrimeve të tij, duke u bërë nga -26.293 lekë në +96,107 lekë²⁸.

Pavarësisht rezultatit të mësipërm, nga lëvizjet e llogarisë së kredisë te “Alpha Bank²⁹, është evidentuar se subjekti ka kryer dy derdhje *cash* në datat 10.1.2011 dhe 4.7.2011, përkatësisht në shumat prej 500,000 lekësh në secilën datë, me qëllim shlyerjen e kredisë. Me ndihmën e Njësisë së Shërbimit Ligjor është kryer analiza financiare mbi mundësinë e subjektit për t’i kryer këto depozitime, paraqitur në tabelën vijuese:

Përshkrimi	Deri më 10.1.2011	Periudha 10.1 – 4.7.2011
PASURI	-389,115	56,858
<i>Shtesa/pakësime, likuiditete</i>	-389,115	56,858
DETYRIME	-500,000	-500,000
Depozituar për shlyerje kredie te “Alpha Bank”	-500,000	-500,000
Të ardhura të dokumentuara	124,528	861,235
Të ardhura nga punësimi i subjektit	64,828	488,835
Të ardhura nga punësimi i bashkëshortes	59,700	372,400
Shpenzime	39,729	476,665
Shpenzime jetese	11,229	204,930

²⁸ Shihni rezultatit financiar të çdo viti te tabela përmbledhëse në fund të kapitullit “Vlerësimi i pasurisë”.

²⁹ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 20.11.2020, të “Alpha Bank”, në dosjen e Komisionit.

Paguar këste për kredinë te “Alpha Bank”	28,500	114,520
Shpenzime udhëtimi		145,215
Shpenzime udhëtimi ditore		12,000
Mundësia për kursime	-26,086	-172,288

Në përfundim të hetimit administrativ, subjektit i kaloi barra e provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të kundërshtuar balancat negative të konstatuara.

Në parashtrimet e tij, subjekti ka sqaruar se *ka pasur gjendje cash në shumën 600,000 lekë në fund të vitit 2010, e cila është deklaruar në DVP/2010, dhe se kjo shumë është përdorur për depozitimin e kryer prej 500,000 lekësh në datën 10.1.2011. Po kështu, në lidhje me pagesën për llogari të kredisë bankare, të kryer në datën 4.7.2011, subjekti ka deklaruar se gjatë vitit 2011 bashkëshortja e tij ka realizuar të ardhura në shumën 123,400 lekë nga mësimdhënia si pedagoge pranë Albania University. Këto të ardhura janë deklaruar në DVP/2011, si dhe në deklaratën Vetting. Nga këto të ardhura të derdhura nga universiteti në “ProCredit Bank”, shuma prej 99,800 lekësh është tërhequr prej saj në datën 17.6.2011, duke shërbyer si burim për depozitimin prej 500,000 lekësh në “Alpha Bank”. Kjo shumë, nëse i shtohet shumës prej 100,000 lekësh e cila është teprica e gjendjes cash pas datës 10.1.2011, do të krijohej shuma 199,800 lekë e cila e tejkalon rezultatin negativ në vlerën 172,288 lekë, që konstaton Komisioni.*

Në analizë të këtyre pretendimeve, Komisioni çmoi se ato qëndrojnë, pasi shuma *cash* që subjekti ka deklaruar se ka pasur në DPV-në e vitit 2010, ka shërbyer si burim për depozitimin e shumës 500,000 lekë më 10.1.2011, dhe shuma e mbetur e gjendjes *cash* prej 100,000 lekësh është përdorur për depozitimin në datën 4.7.2011. Po kështu, pagat e bashkëshortes nga Albania University deri në datën 4.7.2011, në shumën 99,000 lekë, janë përfshirë në analizën financiare të rishikuar të këtij viti, e cila bëhet me rezultat pozitiv.

1.5. Në lidhje me mundësinë financiare të personit të lidhur I. Ç., për dhënien e huas në shumën 1,430,000 lekë në vitin 2011, sipas detyrimit të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka vënë në dispozicion dokumente shkresore që vërtetojnë të ardhura të prindërve të tij si mjekë në Lushnjë. Ndërsa, në përgjigjet e pyetësorit të datës 11.2.2020, subjekti ka deklaruar se babai, z. I. Ç., ka realizuar të ardhura honorare edhe nga mësimdhënia në degën e infermierisë të universitetit “****” (filiali Lushnjë), duke vënë në dispozicion gjendjen bankare në “Union Bank” për periudhën 1.6.2011 – 1.3.2014, nga verifikimi i së cilës u konstatua se të ardhurat nga pagat e z. I. Ç. për vitin 2011 janë në shumën 43,200 lekë, e cilat është përfshirë si e ardhur në analizën financiare.

Bazuar në dokumentet që vërtetojnë të ardhurat ligjore të familjes Çela, si dhe verifikimet në lidhje me pasuri të tjera të personit të lidhur I. Ç., është kryer analizë e përmbledhur në tabelën më poshtë, nga viti 2009 (për shkak se deri në vitin 2008 është kryer analiza e mëparshme, me qëllim verifikimin e burimit për dhënien e huas në shumën 5,000 euro) deri në fund të nëntorit të vitit 2011 (kohë kur është dhënë huaja), ku shpenzimet e jetesës janë llogaritur për 4 persona sipas standardit të ILDKPKI-së.

Analiza e prindërve të subjektit	Viti 2009	Viti 2010	Datë 30.11.2011
Pasuri	460 924	516 037	-1 119 444
<i>SHTESA/PAKËSIME/LIKUIDITETE</i>	<i>460 924</i>	<i>516 037</i>	<i>-1 119 444</i>
Të ardhura dokumentuar	1 177 459	1 247 493	1 018 067
Të ardhura nga I. Ç.	694 979	714 048	508 818

Të ardhura nga P. Ç.	482 480	533 445	509 249
SHPENZIME	793 386	792 174	2 151 114
Shpenzime jetese	546 480	546 480	500 940
Dhënë hua subjektit			1 430 000
Shlyer kredia tek "Alpha Bank"	246 906	245 694	220 174
Mundësia për kursime	-76 851	-60 717	-13 603

Siç vërehet, babai i subjektit, z. I. Ç., ka pasur të ardhura të ligjshme nga pagat në shumën 3,443,019 lekë, ndërkohë që me përllogaritjen e shpenzimeve rezultojnë balanca negative në vlera të vogla për vitet 2009, 2010 dhe 2011, për të cilat subjektit i është kërkuar të japë shpjegime.

Në parashtrimet e datës 5.1.2021, subjekti ka deklaruar se këto balanca kanë ardhur për shkak të llogaritjes gabim të shpenzimeve të jetesës për familjen e personit të tjetër të lidhur I. Ç.. Sa i takon këtij pretendimi, Komisioni e vlerësoi atë të bazuar, referuar fakteve: (i) gjatë këtyre viteve subjekti ka qenë i shkëputur nga familja prindërore; (ii) vëllai i tij A. Ç., pas fillimit të Shkollës së Magjistraturës në tetor të vitit 2008, është shkëputur gjithashtu nga familja dhe ka përfutur bursë, me të cilën ka përballuar shpenzimet. Për këtë arsye, në analizën financiare të rishikuar janë përllogaritur shpenzime jetese vetëm për dy prindërit e subjektit, duke sjellë si pasojë eliminimin e balancave negative në analizën e mësipërme.

Veç sa më sipër, nga të dhënat bankare rezultoi se huaja në shumën 1,430,000 lekë ka kaluar nëpërmjet "Alpha Bank"³⁰ me transfertë bankare nga llogaria e prindërve në llogarinë e subjektit, në datën 30.11.2011, me përshkrimin "kalim nga I. Ç. tek i biri Arens Çela për shlyerje kredie". Duke ndjekur origjinën e krijimit të shumës 1,430,000 lekë, nga lëvizjet e llogarisë së prindërve të subjektit evidentohet se kjo shumë vjen nga viti 2009, gjatë të cilit janë kryer disa depozitime *cash* me të ardhura të ligjshme.

Bazuar në të gjitha faktet dhe provat si më sipër, Komisioni nuk evidentoi asnjë problematikë dhe dyshim sa i takon huas prej 1,430,000 lekësh dhënë nga z. I. Ç., referuar provave e rrethanave si vijojnë: (i) kjo hua ka kaluar në llogari të subjektit me transfertë bankare të datës 30.11.2011; (ii) huaja është deklaruar në DPV-në e vitit 2011, me qëllim shlyerjen e detyrimit të shumës 2,505,020 lekësh ndaj "Alpha Bank"; (iii) nga shuma e dhënë hua, pjesa prej 1,300,000 lekësh, është përdorur për të mbyllur kredinë më 1.12.2011; (iv) personi tjetër i lidhur I. Ç. ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për të dhënë këtë hua, në kuptim të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016 dhe orjentimit të KPA sipas vendimit nr. 15, datë 17.7.2019, të cilit subjekti i referohet.

1.6. Analizë e detajuar e të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e pasurisë objekt shqyrtimi

Pavarësisht se Komisioni ka kryer një analizë të secilit prej burimeve të deklaruara për blerjen e pasurisë apartament me sip. 67 m², me nr. pasurie ***, blerë me çmimin 60,800 euro, Tiranë, me ndihmën e Njësisë së Shërbimit Ligjor është kryer analizë financiare e detajuar e të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e pasurisë, si vijon:

Së pari, shuma 18,000 euro, paguar më 9.9.2008, e ka burimin te kursimet e subjektit dhe konkretisht: (i) nga pagat e bashkëshortëve për periudhën 1.1 – 9.9.2008; (ii) likuiditete të tërhequra nga bankat dhe përdorimi i likuiditeteve *cash*.

³⁰ Shihni shkresën nr. ***, datë 20.11.2020, nga "Alpha Bank".

Së dyti, shuma 19,000 euro, paguar më 12.12.2008, e ka burimin te dy huat e marra nga prindërit e secilit prej bashkëshortëve 10,000 euro dhe 5,000 euro, si dhe te shuma 4,000 euro si kursim i pagave të bashkëshortëve gjatë vitit 2008.

Së treti, shuma 20,000 euro me burim kredinë e marrë në “Alpha Bank”, paguar më 10.3.2009.

Së katërti, shuma 3,643 euro është paguar në datën 24.4.2010 me të ardhura të ligjshme, pasi referuar analizës financiare, subjekti rezultoi me balancë pozitive gjatë këtij viti.

Duke qenë se këstet e paguara në vitet 2009 dhe 2010 janë vërtetuar me të ardhura të ligjshme, Komisioni ka kryer analizën financiare për të verifikuar ligjshmërinë e krijimit të shumës 37,000 euro, paguar në vitin 2008, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën vijuese:

Përshkrimi	Viti 2008
Pasuri	5 939 845
Apartament sip. 76 m ² , shuma 60,800 euro, rr. “N. M.”	7 489 496
<i>SHTESA/PAKËSIME/LIKUIDITETE</i>	<i>-1 549 651</i>
Detyrime	4 163 569
Detyrim ndaj ndërtuesit “****” 23,800 euro	2 931 744
Hua nga N. T. 10,000 euro	1 231 825
Hua nga I. Ç. 5,000 euro	0
Të ardhura dokumentuar	1 819 682
Të ardhura nga punësimi i subjektit	922 694
Të ardhura nga punësimi i bashkëshortes	896 988
Shpenzime	583 660
Shpenzime jetese, <i>standard i ILDKPKI-së</i> për 2 persona	273 240
Shpenzime udhëtimi	310 420
Mundësia për kursime	-540 255

Në këtë analizë janë përfshirë të ardhurat e bashkëshortëve Çela, me burim pagat dhe kursimet e tyre, përdorur për pagimin e shumës 22,000 euro³¹, referuar provave si vijojnë:

- U verifikuan DPV-të e subjektit dhe bashkëshortes për vitin 2007, në të cilat është deklaruar përkatësisht: (i) nga subjekti në rubrikën “ndryshimet e interesave private” “*kursime në gjendje cash, shtuar 100,000 lekë*”; (ii) nga bashkëshortja në rubrikën “deklarimi i interesave private”, “*kursime në gjendje cash në shumën 50,000 lekë*”.
- U verifikua DPV-ja për vitin 2008, ku janë deklaruar përkatësisht: (i) nga subjekti “*kursime në gjendje cash, pakësuar 400,000 lekë, vlera aktuale 0 (zero) lekë*”; (ii) nga bashkëshortja “*kursime pakësuar në zero*”.
- Subjekti i rivlerësimit u pyet në lidhje me burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për të paguar shumën prej 22,000 euro dhe në përgjigjet e pyetësorit të datës 26.5.2020, ka deklaruar se të ardhurat kanë qenë me burim nga:
 - bursa si magjistrat;
 - paga si prokuror për periudhën nëntor 2006 – dhjetor 2008;
 - kursime të krijuara prej bashkëshortes, znj. A. A., përpara fillimit të detyrës si gjyqtare dhe përpara martesës, me burim: paga si juriste në Bashkinë Tiranë, bursa si magjistrate, si dhe depozitat bankare në emër të saj;

³¹ Nga të cilat 18,000 euro janë paguar më 9.9.2008 dhe 4,000 euro më 12.12.2008.

- paga e bashkëshortes së subjektit, znj. A. A., si gjyqtare, në periudhën nëntor 2006 – dhjetor 2008, deklarime të cilat përputhen me deklaratimet në DPV-të e viteve 2007 dhe 2008.

Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në sa më sipër, u vërtetua se për pagimin e shumës 22,000 euro ose 2,710,015 lekë, subjekti ka pasur burime të justifikuar ligjërisht nga pagat dhe kursimet, të përfshira në analizën e mësipërme, e cila rezultoi me një balancë negative prej -540,255 lekësh. Në këtë analizë, e cila i është vënë në dispozicion subjektit me mbylljen e hetimit administrativ, ishte përfshirë huaja në shumën 10,000 euro, marrë nga shtetasja N. T. dhe nuk ishte përfshirë huaja prej 5,000 euro marrë nga z. I. Ç.. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, kjo hua është përfshirë si e ardhur e ligjshme për shkak se subjekti vërtetoi të kundërtën e barrës së provës³² dhe, për rrjedhojë, në analizën përfundimtare financiare viti 2008 nuk rezultoi me balancë negative.

Vlerësimi përfundimtar në lidhje me pasurinë apartament banimi, me nr. pasurie ***

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni çmoi se subjekti ka kryer deklarime të sakta dhe në përputhje me ligjin si në DPV-të përkatëse ashtu edhe në deklaratën *Vetting*, si dhe ka justifikuar blerjen e pasurisë me të ardhura të ligjshme.

2. Automjet tip “Daimler Chrysler **”, me nr. shasie *****, me naftë, 5 vende, blerë sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 30.3.2016. Vlera: 3,000 euro. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: të ardhurat nga pagat e bashkëshortëve.

Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri

Nga dokumentet e vëna në dispozicion nga ILDKPKI-ja³³ dhe DPSHTRr-ja³⁴ rezultoi se me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 30.3.2016, znj. A. A. ka blerë automjetin nga shtetasja J. B. në vlerën 3,000 euro. Kjo pasuri është deklaruar në deklaratimin e vitit 2016: “*Blerë autoveturë, marka Daimler Chrysler, tipi ***, shasia ***, me naftë, 5 vende. Vlera: 3,000 euro. Pjesa takuese: 50%*”, por pa u deklaruar burimi i krijimit. Nga analiza financiare e kryer deri në momentin e blerjes së automjetit, datë 30.3.2016, rezultoi se subjekti ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për të paguar çmimin e shitjes prej 3,000 euro.

Përshkrimi	Datë 30.3.2016
Pasuri	208 905
Automjet tip “Daimler Chrysler” targa ***	405 810
<i>SHTESA/PAKËSIME/LIKUIDITETE</i>	<i>-196 905</i>
Të ardhura dokumentuar	575 441
Të ardhura nga punësimi i subjektit	316 197
Të ardhura nga punësimi i bashkëshortes	259 244
Shpenzime	361 266
Shpenzime jetese	205 706
Shpenzime shkollimi vajza	128 507
Shpenzime udhëtimi sipas sistemit <i>TIMS</i>	27 054
Mundësia për kursime	5 270

³² Shtjelluar më sipër në vendim, pika 1.4.3.

³³ Shihni aktet në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁴ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 15.10.2018, nga DPSHTRr-ja dhe shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 19.10.2018, nga DPSHTRr-ja në dosjen e Komisionit.

Për sa i takon mosdeklarimit të burimit të krijimit të automjetit në DPV-në e vitit 2016, pasi i është kërkuar të japë sqarime, në parashtrimet e veta subjekti ka deklaruar se ky ka qenë një lapsus, ndërkohë që është deklaruar saktësisht në deklaratën *Vetting*. Sipas tij ka qenë saktësisht i kuptueshëm burimi i krijimit që kanë qenë të ardhurat nga pagat, pasi në DPV-në e vitit 2016 janë deklaruar vetëm të ardhura prej pagës së tij dhe bashkëshortes, ndërkohë që nuk janë deklaruar detyrime financiare ndaj personave fizikë apo juridikë.

Në përfundim të hetimit administrativ nuk rezultoi asnjë problematikë dhe dyshim në lidhje me automjetin objekt shqyrtimi. Për sa i takon mungesës së deklarimit të burimit të krijimit të këtij automjeti në DPV-në e vitit 2016, sipas shtojcës nr. 2, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni çmon se për sa kohë u vërtetuan të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e automjetit dhe subjekti ka deklaruar saktësisht burimin në deklaratën *Vetting*, kjo pasaktësi vlerësohet si formale e pa pasoja që paralizojnë subjektin e rivlerësimit.

3. Likuiditet në vlerën 500,000 lekë të dhëna hua, pa afat dhe pa interes nënës së bashkëshortes, znj. N. T., sipas marrëveshjes verbale të vitit 2014. Burimi i krijimit: (1) të ardhura nga paga e bashkëshortes si gjyqtare dhe paga si prokuror; (2) tërheqja e shumës së depozituar (kursimet) në bankën e nivelit të dytë “Tirana Bank”.

Në lidhje me këtë likuiditet të dhënë hua, gjatë hetimit administrativ nuk kanë rezultuar dyshime e problematika, referuar fakteve e provave si vijojnë:

- Me deklaratën noteriale nr. ***, datë 25.1.2017³⁵, shtetasja N. T. deklaroi se në vitin 2014, për nevojat e saj ka marrë një hua prej vajzës dhe bashkëshortit Arens Çela në shumën 500,000 lekë pa afat dhe pa interes dhe ende nuk e ka shlyer këtë hua.

- Në DPV-në e vitit 2014, nga subjekti është deklaruar huadhënie në shumën 500,000 lekë pa afat dhe pa interes nënës së bashkëshortes N. T., shumë kjo e siguruar nga tërheqja e shumës së depozituar në “Tirana Bank” dhe kursimet nga paga.

- Pas verifikimit nga kjo bankë³⁶ ka rezultuar se në datën 4.12.2014, shtetasi Arens Çela ka tërhequr nga llogaria shumën prej 353,856 lekësh.

- Nga analiza financiare rezultoi se subjekti ka pasur mundësi me të ardhura të ligjshme për dhënie e huas në vitin 2014, hua e cila nuk është shlyer nga znj. N. T., sikurse subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting*.

Lidhur me detyrimet financiare

Subjekti nuk ka deklaruar detyrime financiare në deklaratën *Vetting*, por ato janë deklaruar rregullisht e saktësisht në deklaratat periodike vjetore dhe janë trajtuar më sipër në këtë vendim. Nga analiza financiare ka rezultuar se subjekti ka pasur burime të ligjshme për shlyerjen e tyre, sikurse evidentohet në rezultatin financiar të çdo viti, pasqyruar në tabelën përmbledhëse në fund të kapitullit “vlerësimi i pasurisë”.

Deklarime të personit të lidhur, znj. A. A.

Bashkëshortja e subjektit, znj. A. A., ka deklaruar të njëjtat pasuri si subjekti i rivlerësimit, z. Arens Çela.

KONSTATIME TË TJERA

³⁵ Shihni aktin në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁶Shihni shkresën nr. *** prot., datë 16.10.2018, nga “Tirana Bank”.

1. Në DPDFD-në e datës 1.11.2006, subjekti ka deklaruar një automjet tip “Mercedes-Benz” në vlerën 500,000 lekë dhe si burim krijimi dhuratë nga prindërit. Komisioni ka kryer një analizë financiare me të dhënat që dispononte për të verifikuar mundësinë e prindërve të subjektit për të krijuar me të ardhura të ligjshme shumën e dhuruar prej 500,000 lekësh, siç pasqyrohet në tabelën vijuese, kryer për periudhën 1994 – 2006, ku llogaritja e shpenzimeve të jetesës është bërë për 4 persona³⁷. Nga kjo analizë e kryer në përfundim të hetimeve paraprake, duket se z. I. Ç. ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për dhurimin e shumës 500,000 lekë, e cila ka shërbyer për blerjen e automjetit.

Analiza e prindërve të subjektit	Periudha 1994 – 2006
Pasuri	500 051
<i>SHTESA/PAKËSIM/LIKUIDITETE</i>	<i>500 051</i>
Të ardhura të dokumentuara	6 203 117
Të ardhura nga I. Ç. (babai)	3 031 428
Të ardhura nga P. Ç. (nëna)	2 671 689
Trashëgimi nga gjyshja e subjektit te nëna e tij	500 000
Shpenzime	4 354 439
Shpenzime jetese për 4 persona	3 854 439
Dhuar subjektit për automjetin	500 000
Mundësia për kursime	1 348 627

Në parashtrimet e tij, siç është përmendur më sipër në këtë vendim, subjekti ka kundërshtuar barrën e provës në lidhje me pamundësinë e babait të tij, I. Ç., për të dhënë huan në vlerën 5,000 euro, në vitin 2008. Për të vërtetuar këtë pretendim, subjekti ka paraqitur disa dokumente, të cilat vërtetojnë porositjen e dy apartamenteve nga prindërit e tij në mars të vitit 2006, ku shuma prej 27,450 euro është paguar para datës së emërimit në detyrë të subjektit, datë 4.10.2006. Gjithashtu, ka vërtetuar me dokumente shkresore të ardhura të përfituara nga shitja e dy apartamenteve në Lushnjë në vitet 1999 dhe 2006, përkatësisht, në shumat 1,000,000 lekë³⁸ dhe 1,800,000 lekë, trajtuar hollësisht në pikën 1.4.3 të vendimit.

Referuar fakteve të reja të administruara pasi subjekti paraqiti parashtrimet e tij, u bë i domosdoshëm rishikimi i analizës financiare të kryer për të verifikuar mundësinë e prindërve të subjektit për të dhuruar shumën 500,000 lekë, përdorur për blerjen e automjetit në vitin 2006.

Në analizën e rishikuar janë marrë në konsideratë: (i) shpenzime në vlerën 27,450 euro ose 3,395,647 për të dy apartamentet, paguar në mars të vitit 2006 sipas kontratës së porosisë; (ii) shpenzim në vlerën 1,158,230 lekë për blerjen e dy apartamenteve nga prindërit e subjektit në vitet 1993 dhe 1997; (iii) të ardhura nga shitja e apartamentit në Lushnjë në shumën 1,000,000 lekë; (iii) shpenzimet e jetesës sipas përbërjes familjare³⁹. Pas rishikimit, analiza financiare, dërguar me rezultatet e hetimit administrativ, e cila kishte qenë pozitive në vlerën 1,348,627 lekë, kthehet në balancë negative, duke çuar në konkluzionin se prindërit e subjektit nuk kanë

³⁷ Subjekti, dy prindërit dhe vëllai i tij.

³⁸ Shihni kontratën nr. ***, datë 1.11.1999, paraqitur me parashtrimet e subjektit në dosjen e Komisionit.

³⁹ Periudha 1994 – 2000 në masën 66% të të ardhurave nga pagat e prindërve të subjektit; nga 2000 deri në tetor 2004, kur subjekti është larguar për studime në Shkollën e Magjistraturës për 3 persona, dy prindërit dhe vëllai i tij; periudha tetor 2004 – 10.4.2006 për dy prindërit e subjektit.

pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për t'i dhuruar subjektit shumën prej 500,000 lekësh në vitin 2006.

Pavarësisht këtij rezultati, Komisioni çmon të sqarojë se në këtë analizë, si kohë për blerjen e automjetit është marrë periudha 1.1 – 4.10.2006, për shkak të deklarimit të automjetit në DPDFD për vitin 2006, por pa u vërtetuar me dokumentacion blerja e tij në këtë periudhë. Ndërsa, në rastin që automjeti është blerë më parë se data 1.1.2006, atëherë me gjasa, analiza financiare mund të ishte me balancë pozitive, në varësi të periudhës kur është blerë automjeti.

Gjithsesi, duke mbajtur në konsideratë faktin se shuma prej 500,000 lekësh përdorur për blerjen e automjetit në vitin 2006, që ishte viti i parë i deklarimit nga subjekti, është dhuruar nga prindërit me të ardhurat e tyre të siguruara përpara se subjekti të ishte emëruar në detyrë, Komisioni vlerëson se mungesa e të dhënave që vërtetojnë të ardhura të ligjshme të tyre në momentin e dhurimit të kësaj shume, nuk mund të bëhet shkak për penalizimin e subjektit të rivlerësimit.

2. Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se znj. N. T., nëna e bashkëshortes së subjektit, ka porositur pranë shoqërisë “***” sh.p.k., një apartament banimi në vitin 2014, në shumën 114,170 euro, me kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 27.8.2014. Edhe pse gjatë kësaj periudhe nuk u vërtetua asnjë marrëdhënie interesi midis bashkëshortëve Çela dhe znj. N. T. si person tjetër i lidhur, Komisioni kreu disa veprime verifikuese me qëllim heqjen e çdo dyshimi mbi pronësinë ose posedimin e mundshëm të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes, në përfundim të të cilave nuk u evidentuan lidhje të çfarëdolloji të tyre me këtë pasuri, referuar fakteve e rrethanave si vijojnë:

i) ZVRPP-ja Tiranë nuk ka konfirmuar regjistrimin e kësaj pasurie në emër të subjektit dhe bashkëshortes dhe as në emër të znj. N. T., për të cilën nuk figurojnë pasuri të tjera në pronësi⁴⁰ (subjekti deklaroi se ende nuk është lidhur kontrata përfundimtare e shitjes së kësaj pasurie).

ii) OSHEE-ja konfirmoi se⁴¹ për këtë pasuri, znj. N. T. është abonent me kontratë nr. ***, me datë hapje 11.5.2015, pra rreth nëntë muaj më vonë nga dita e porositjes (datë 27.8.2014).

iii) Nga verifikimi i lëvizjeve bankare nuk rezultoi që subjekti apo bashkëshortja të kenë kryer transaksione në lidhje me këtë pasuri me shoqërinë ndërtimore dhe me administratorin e saj, z. F. B..

iv) Nuk ka rezultuar asnjë e dhënë nga cilido burim për lidhje të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes me këtë pasuri.

3. Në deklarimin e vitit 2007, bashkëshortja e subjektit, e cila është martuar me subjektin në janar të vitit 2007, ka deklaruar llogari bankare në shumën 780,000 lekë dhe 3,800 USD, në total 1,095,514 lekë. Edhe pse këto shuma e kanë burimin në vitet përpara se subjekti të martohej me bashkëshorten, duke qenë se kanë shërbyer si burim për të paguar një pjesë të çmimit të shitjes së apartamentit në Tiranë, Komisioni ka verifikuar burimin e ligjshëm të këtyre likuiditeteve. Pas verifikimeve të kryera rezultoi se likuiditeti i krijuar para martesës dhe i mbartur prej znj. A. A. pas martesës është në vlerën 1,021,803 lekë⁴². Kjo shumë përbëhet nga: (i) shuma 1,244 USD, dhuruar nga babai i saj dhe deklaruar nga znj. A. A. si pasuri-likuiditet në DPDFD-në e vitit 2006; dhe (ii) shuma 905,275 lekë e krijuar nga kursimet e saj para martesës. Duke qenë se për shumën 1,244 USD/116,528 lekë, dhuruar nga babai i saj, nuk është provuar burimi i ligjshëm në analizën financiare të vitit 2007, si e ardhur e ligjshme është përfshirë vetëm shuma 905,275 lekë. Në lidhje me burimin e ligjshëm të kësaj shume është kryer analiza

⁴⁰Shihni shkresën nr. *** prot., datë 27.2.2019, në dosjen e Komisionit.

⁴¹Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 28.2.2019, nga OSHEE-ja në dosjen e Komisionit.

⁴² Shuma 1,021,803 lekë është totali i likuiditeteve të znj. A. A. në fund të vitit 2006 i përbërë nga gjendja *cash* dhe gjendje në llogaritë bankare të saj.

financiare paraqitur si në tabelën vijuese, nga e cila rezultoi se znj. A. A. ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar këtë shumë, para martesës.

Përshkrimi	2004	2005	2006	Total
Juriste në Bashkinë Tiranë	163 016			163 016
Magjistrate në Shkollën e Magjistraturës	116 325	465 300	350 805	932 430
Gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë			208 040	208 040
Total të ardhura	279 341	465 300	558 845	1 303 486
Shpenzime jetese	93 964	109 557	109 557	313 078
Mundësia për kursim	185 377	355 743	449 288	990 408

4. Në datën 13.3.2006 në llogarinë e bashkëshortes në “Tirana Bank”, shtetasja M. S. ka derdhur shumën prej 35,039 USD, shumë e cila është tërhequr nga znj. A. A., datë 17.3.2006. Lidhur me këtë konstatim është pyetur subjekti, i cili është përgjigjur se: “... shtetasja shqiptaro-amerikane, znj. M. S., është tezja ime (motra e nënës) emri i familjes së origjinës është M. P. (aktualisht ajo mban këtë mbiemër, pasi ka zgjidhur martesën). Në muajin mars të vitit 2006 unë dhe bashkëshortja kemi qenë të fejuar (martesa është lidhur në janar të vitit 2007) dhe ajo ishte e vetmja nga familja jonë që kishte një llogari të hapur në monedhën dollar amerikan (USD), në bankën e nivelit të dytë. Bashkëshortja ime, znj. A. A., është dekretuar gjyqtare në shkallën e parë, në datën 4.10.2006 me Dekret të Presidentit të Republikës. Shuma e parave prej 35,039 USD është tërhequr prej bashkëshortes sime për t’ia kaluar më pas nënës sime, znj. P. Ç. (P.), pasi ky ishte qëllimi i transaksionit dhe nëna ime nuk kishte llogari bankare në dollar”.

Bashkëngjitur ka paraqitur kopje të akteve të gjendjes civile për të provuar lidhjen familjare sipas shpjegimit të dhënë, si më sipër.

Pas verifikimit në sistemin TIMS rezultoi që znj. M. P. (S.) është shtetase amerikane. Ky fakt, pra, vërtetimi i tërheqjes së shumës nga znj. A. A. katër ditë pas derdhjes, si dhe fakti që kjo shumë nuk është përdorur dhe deklaruar si burim për blerjen e ndonjë pasurie nga subjekti dhe bashkëshortja, i bëjnë të besueshme pretendimet e subjektit.

5. Gjatë viteve 2014 dhe 2015 janë konstatuar disa derdhje mujore në llogarinë bankare të subjektit nga fondacioni “G.”, gjatë viteve 2014 dhe 2015. Çdo shumë e depozituar mban përshkrimin “by order of fond G. kthim pagese E. Ç.”.

Nga të dhënat bankare u evidentua se në të njëjtën datë të kreditimit, subjekti ka bërë pagesë në të njëjtat shuma për fondacionin “G.”. I pyetur gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti ka sqaruar se⁴³: “... fondacioni ‘G.’ në bashkëpunim me BKT-në kanë pajisur të gjithë prindërit e fëmijëve për pagesë me kartë studenti, me anë të cilës duhet të bëhej pagesa mujore. Të gjitha pagesat që rezultojnë të kthyera nga fondacioni ‘G.’ në llogarinë e tij janë pagesa që janë kryer nga ana e tij ditë më parë në llogari të fondacionit dhe jo të numrit të llogarisë së kartës personale”. Pra, kthimi është bërë që më pas e njëjta shumë të kalonte në llogarinë e kartës, që të merrej pagesa nga sistemi, sipas mënyrës së pagesave.

Pretendimet e subjektit vërtetohen me aktet bankare “depozitim cash” në BKT, të depozituara prej tij dhe me përgjigjen e fondacionit “G.”⁴⁴, në të cilën sqarohet marrëveshja e bërë me BKT-në, sipas së cilës, nga BKT-ja i hapej çdo prindi një kartë krediti, nga ku shuma prej 22,000 lekësh do të kalonte në çdo datë 2 të muajit në llogarinë e fondacionit “G.”. Më pas, prindërit kishin kohë deri më datën 16 të muajit përkatës të kryenin pagesën e kështit në fjalë te llogaria

⁴³ Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 3 në dosjen e Komisionit.

⁴⁴ Shihni shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 9.7.2019, nga fondacioni “G.”, në dosjen e Komisionit.

e kartës së kreditit. Gjithashtu, fondacioni “G.” ka vënë në dispozicion kontratën e dorëzarisë nr. ***, datë 23.1.2016, me palë dorëzanesë fondacionin dhe kredidhënës BKT-në.

Lidhur me një konflikt të mundshëm interesi, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda informoi se nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal i trajtuar nga prokurori Arens Çela në ngarkim të subjekteve “fondacioni G.”, institucionet arsimore “M. A.” dhe “T. O.”⁴⁵.

6. Sa i takon adresave të banimit, Komisioni kreu verifikime në lidhje me tri adresa të deklaruara nga subjekti, si vijojnë, dhe në përfundim nuk u konstatuan problematika:

- adresa: rruga “R. Ç.”, ap. ***, p. ***, njësia nr. 8, Tiranë, deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës për vitin 2006;

- adresa: rruga “M. Sh.”, p. ***, njësia nr. 8, Tiranë, deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës për vitin 2006;

- adresa e regjistrimit në gjendjen civile, rruga “F. Xh.”, njësia nr. 8 Tiranë, deklaruar në DPV-të për periudhën 2007 – 2016.

Për pronarët e këtyre pasurive nuk ka rezultuar që subjekti të jetë në kushtet e konfliktit të interesit, si dhe këta shtetas nuk kanë qenë të përfshirë në veprimtari të krimit të organizuar.

7. Gjatë procesit të rivlerësimit u evidentua se për disa vite subjekti ka punuar në qytete të ndryshme, për të cilat iu kërkuan sqarime në lidhje me shpenzimet e transportit dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 3 ka dhënë shpjegime të detajuara. Për të gjitha periudhat, shpenzimet e transportit janë përlllogaritur dhe përfshirë në analizën financiare.

8. Në lidhje me automjetin me targa ***, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ky automjet është i tipit furgon, i marrë me qira për udhëtim në Mal të Zi, nga familja e tij dhe disa miq të tjerë, gjithsej 9 persona. Nga verifikimet e kryera në sistemin AMF, rezultoi se ky automjet është tip “****”, modeli ***, me ngjyrë të kuqe, viti i prodhimit 2005, me 2 apo 3 vende, ndërsa si policëmbajtës kanë figuruar shtetasit me gjeneralitetet në një rast M. M. dhe në një rast tjetër M. M. i datëlindjes 25.12.1968. Siç vërehet ka të dhëna kontradiktore lidhur me këtë automjet midis deklarimeve të subjektit dhe të dhënave të sistemit AMF. Për këtë arsye, Komisioni kërkoi të dhëna nga DPSHTRr-ja, e cila konfirmoi të dhënat e sistemit AMF, duke vënë në dispozicion dosjen e automjetit me targa ***, tipi “****”, viti i prodhimit 2005, me nr. shasie ***, nr. vendeve 1+1, i cili ka pasur targën ***, në pronësi të shtetasit M. B. M. i datëlindjes 25.12.1968⁴⁶. Për këtë shtetas nuk u konstatuan të dhëna për konflikte të mundshme interesi të subjektit gjatë ushtrimit të detyrës⁴⁷ apo për përfshirje në veprimtari të krimit të organizuar⁴⁸.

Ndërsa në parashtrime, subjekti i qëndron shpjegimeve të tij se automjeti, me të cilin kishte udhëtuar me 9 miq në drejtim të Malit të Zi, ishte furgon i marrë me qira shoqërisë tregtare, “****” dhe jo automjeti tip “****” me targa ***, i cili rezulton në sistemin *TIMS*, duke sqaruar se ka qenë punonjësi i policisë kufitare, që ka shënuar gabim germën e fundit të targës AJ në vend të AI, ndërsa ka shënuar saktë llojin e automjetit-furgon. Për të vërtetuar pretendimet e tij, subjekti ka paraqitur një e-mail të shoqërisë “****” dhe foto të automjetit, në të cilat konfirmohet fakti se në vitin 2012 (9.3.2012 – 12.3.2012) subjekti Arens Çela ka marrë me qira

⁴⁵ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 11.7.2019 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në dosjen e Komisionit.

⁴⁶ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 14.9.2020, nga DPSHTRr-ja në dosjen e Komisionit..

⁴⁷ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 14.9.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat; shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 18.9.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe kthim përgjigje nr. *** prot., datë 10.9.2020, nga SPAK-u në dosjen e Komisionit.

⁴⁸ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 10.9.2020, nga SPAK-u në dosjen e Komisionit.

automjetin furgon tip “Volkswagen”, 8+1 vende, me ngjyrë të bardhë dhe se ky automjet referuar fotove ka qenë me targa ***.

Analiza financiare

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni ka kryer analizën financiare për të verifikuar mundësinë e subjektit për të përballuar krijimin e pasurive dhe shpenzimet përgjatë gjithë periudhës së rivlerësimit, paraqitur në mënyrë të përmbledhur në tabelën më poshtë.

Nga kjo analizë rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar pasuritë dhe për të kryer të gjitha shpenzimet e evidentuara, përveç një balance negative në vlerën -489,016 lekë, që ka rezultuar në vitin 2006, për shkak se dhurata e prindërve për blerjen e automjetit në vlerën 500,000 lekë nuk është konsideruar si e ardhur e ligjshme, përderisa nuk u provua burimi i ligjshëm i saj.

	1	2	3	4	5	6
Përshkrimi	PASURI	DETYRIME	PASURI NETO (1-2)	TË ARDHURA	SHPENZIME	Mundësia për kursime 4-3-5
2006	877 082	0	877 082	532 603	144 537	-489 016
2007	1 164 805	0	1 164 805	2 502 413	500 315	837 293
2008	5 939 845	4 779 481	1 160 364	1 819 682	583 660	75 658
2009	432 150	-564 240	996 390	1 830 028	668 216	165 422
2010	-281 176	-1 090 036	808 859	1 726 932	767 077	150 996
2011	-271 278	-1 300 563	1 029 285	1 937 050	811 658	96 107
2012	86 127	-615 913	702 040	1 833 339	771 239	360 060
2013	2 046	-761 075	763 121	1 918 545	887 722	267 702
2014	-433 074	-1 060 000	626 926	2 232 367	1 264 643	340 799
2015	175 439	-240 000	415 439	2 170 697	1 399 064	356 195
2016	208 905	0	208 905	2 569 417	1 895 895	464 618
TOTAL	7 900 871	-852 345	8 753 216	21 073 073	9 694 024	2 625 832

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, Komisioni çmoi se subjekti i rivlerësimit, z. Arens Çela, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, pasi përmbush kriteret e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, për shkak se ka kryer deklaratime të sakta si në DPV ashtu dhe në deklaratën *Vetting*, si dhe ka justifikuar me të ardhura të ligjshme pasuritë dhe shpenzimet për të gjithë periudhën e rivlerësimit. Balanca negative prej -489,016 lekësh, për shkak të vlerës së saj, si dhe faktit që vjen prej pamundësisë financiare të babait të tij për të dhuruar shumën 500,000 lekë, përpara se subjekti të bëhej subjekt deklarues, nuk mund të jetë shkak për penalizim të subjektit të rivlerësimit.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit të pasurisë, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, Komisioni çmoi se subjekti i rivlerësimit, z. Arens Çela, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, pasi përmbush kriteret e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

Metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizën financiare

Në analizën financiare, për çdo pasuri të krijuar dhe/ose shpenzim të kryer, është analizuar mundësia financiare e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, duke krahasuar në çdo rast informacionet e marra në rrugë zyrtare nga institucionet kompetente ligjore me deklaratimet e subjektit. Kjo analizë është kryer duke marrë në konsideratë:

Të ardhurat

- Të ardhurat nga pagat e dokumentuara të subjektit duke filluar nga viti 2006 dhe deri në fund të periudhës së vlerësimit⁴⁹.
- Të ardhurat nga punësimi, të dokumentuara, të bashkëshortes së subjektit nga data e martesës së tyre 1.1.2007⁵⁰.
- Të ardhurat nga shitja e automjetit në vitin 2010, sipas kontratës së shitblerjes përkatëse.

Shpenzimet

- Shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur bazuar në standardin e ILDKPKI-së dhe sipas përbërjes familjare të subjektit të rivlerësimit.
- Interesat bankare të paguara për kredinë e marrë në “Alpha Bank”.
- Shpenzimet e udhëtimit dhe pushimeve, për të cilat është konsideruar raporti nga sistemi *TIMS* dhe sqarimet e dhëna nga subjekti në pyetësin standard. Metodologjia e përlllogaritjes së këtyre shpenzimeve është ajo e përcaktuar në vendimin (JR) nr. 11, datë 22.5.2019, të KPA-së.
- Shpenzime qiraje për periudhën tetor 2006 – gusht 2007, sipas vlerave të deklaruara nga subjekti në mungesë të një kontrate qiraje. Në këtë periudhë subjekti ka banuar në Tiranë duke e ndarë qiranë me të vëllanë.
- Shpenzimet e udhëtimit të brendshëm (nga vendbanesa në vendin e punës) janë vlerësuar bazuar në deklaratimet e subjektit gjatë përgjigjeve të pyetësorëve. Metodologjia e përdorur në përlllogaritjen e këtyre shpenzimeve është bazuar në shpjegimet e subjektit, si dhe në verifikimet e kryera në lidhje me çmimin e biletave dhe karburantit, konkretisht: për periudhën kohore tetor 2006 - korrik 2007, 1 muaj është konsideruar me 20 ditë dhe shpenzimi i udhëtimit Tiranë-Lushnjë-Tiranë është deklaruar në vlerën 1,000 lekë i ndarë midis 3 kolegëve, pra subjekti ka paguar 333 lekë për udhëtim. Për periudhat kohore: gusht 2007 – shkurt 2009, subjekti nuk ka pasur shpenzime transporti, pasi ka jetuar dhe punuar në Lushnjë, duke qëndruar në banesën e prindërve; shkurt 2009 - shtator 2010, subjekti ka jetuar në Lushnjë dhe ka punuar në Berat, duke ndarë shpenzimet e transportit me kolegë ose duke përdorur transportin publik (furgon). Në të dyja rastet, kostoja e transportit Lushnjë-Berat-Lushnjë ka qenë 200 lekë/udhëtim. Ditët e punës mujore janë konsideruar 20. Gjatë periudhës kohore shtator 2010 - korrik 2015, subjekti ka jetuar në Tiranë dhe ka punuar në Berat, duke ndarë shpenzimet e transportit me katër kolegë të tjerë, duke paguar një çmim rreth 500 lekë/udhëtim. Meqenëse subjekti disa ditë qëndronte te prindërit në Lushnjë dhe nuk kthehej në Tiranë, ditët e udhëtimit për muaj janë konsideruar 12.

⁴⁹Vërtetim nr. *** prot., datë 13.10.2016, nga Shkolla e Magjistraturës; vërtetim datë 10.10.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë; vërtetim nr. *** prot., datë 20.10.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat; vërtetim nr. *** prot., datë 13.1.2017, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

⁵⁰ Vërtetim: nr. ***, datë 25.10.2016, nga Bashkia Tiranë; nr. *** prot., datë 13.10.2016 nga Shkolla e Magjistraturës; vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë; vërtetim nr. *** prot., datë 14.10.2016, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë; vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* nga ISSH-ja, Drejtoria Rajonale Lushnjë; vërtetim për pagën *neto* nr. *** prot., datë 18.10.2016, nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë; vërtetim nr. *** prot., datë 10.1.2017, nga ISSH-ja; vërtetim nr. *** prot., datë 12.10.2016, nga Albanian University.

- Shpenzime shkollimi për vajzën sikurse evidentuar nga dokumentet shkresore dhe shpjegimet e subjektit⁵¹.

Pasuritë

- Përfshihen të gjitha pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme në pronësi dhe bashkëpronësi të subjektit dhe bashkëshortes.

- Likuiditetet trajtohen si pjesë e pasurive, në një zë të veçantë. Gjendjet e llogarive bankare⁵² në fund të çdo viti ose date të analizuar dhe gjendjet *cash* sikurse janë deklaruar nga subjekti në DPV-të edhe sqarimet e dhëna në përgjigje të pyetësorëve gjatë procesit të rivlerësimit.

- Secila nga pasuritë është analizuar në kohën e krijimit të saj.

Ndryshimi i likuiditeteve, pakësimi ose shtesa nga viti në vit, është pasuria e krijuar nga subjekti për një vit të caktuar ushtrimor.

- Vlera e çdo pasurie është marrë nga kontratat e porosive, shitblerjeve, deklaratat noteriale, si dhe çdo provë tjetër e administruar nga Komisioni, ballafaquar me deklaratën *Vetting* dhe DPV-të.

- Shuma në fund përbën totalin e pasurisë së akumuluar nga subjekti nga fillimi i detyrës deri në fund të periudhës së vlerësimit.

Detyrimet

- Kredia e marrë nga subjekti dhe bashkëshortja tek “Alpha Bank” në bazë të kontratave të nënshkruara me bankën.

- Shumat e marra hua nga subjekti, nga prindërit e tij dhe të bashkëshortes.

Marrja e huave dhe detyrimi i mbetur ndaj shoqërisë ndërtuese janë pasqyruar me plus në këtë rubrikë, ndërsa pagesat e principalit të kredisë dhe shlyerjet e huave janë pasqyruar me minus.

Pasuria *neto* është diferenca e pasurisë me detyrimet.

Rezultati financiar

- Është përlllogaritur për çdo vit, për çdo datë/periudhë të krijimit të pasurisë/ve, si dhe në total.

- Mundësia për kursime rezulton si shumatore e të ardhurave – (shpenzime + pasuri *neto*).

- Mundësia financiare analizohet për çdo pasuri të krijuar në momentin e pagesës për pasurinë.

- Mundësia financiare analizohet për çdo vit kalendarik.

B. KONTROLLI I FIGURËS

DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për efekt të procesit të rivlerësimit, DSIK-ja ka dërguar raportin nr. *** prot., datë 2.11.2017, mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, Arens I. Çela, i deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 2.4.2019, të KDZh-së, nga ku rezulton se:

⁵¹ Shkresë nr. *** prot., datë 22.10.18, nga BKT-ja, shkresë nr. *** prot., datë 9.7.2019, nga fondacioni turk, deklaratat periodike të viteve 2013 – 2016; pyetësor shtesë 1/2, pyetësor nr. 3.

⁵² Shkresat nr. ***, datë 16.10.2018, nga “Tirana Bank”; nr. *** prot., datë 22.10.2018, nga “Banka Kombëtare Tregtare” sh.a.; nr. ***, datë 9.10.2018, nga “Raiffeisen Bank” sh.a.; nr. ***, datë 12.10.2018 dhe nr. *** prot., datë 20.11.2020, nga “Alpha Bank”.

i) formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016;

ii) ka vetëdeklaruar në pjesën 5 të dhëna për sigurinë të deklaratës së kontrollit të figurës, për pyetjen e përcaktuar në germën “b”, se ka dijeni për një familjar të vetin, konkretisht: “shtetasin M. R. Ç. (xhaxha), i cili është shpallur fajtor nga Gjykata e Krimeve të Rënda për veprat penale të parashikuara në nenet 333, 79/c, 334/2, 278/2 të Kodit Penal, konfirmuar edhe nga institucionet verifikuese;

iii) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës;

iv) në lidhjet e tij familjare nuk rezulton të ketë pasur kontakte të papërshtatshme në papajtueshmëri me detyrën;

v) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për implikimin e tij apo për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

Në konkluzion të këtij raporti, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Arens I. Çela.

Pavarësisht përfundimeve të DSIK-së, gjatë hetimit administrativ nga Komisioni u kryen disa veprime hetimore në lidhje me figurën e subjektit të rivlerësimit, si vijojnë:

1. U kërkua rishikimi i raportit të DSIK-së, përgjigjja për të cilën është administruar nga Komisioni me shkresë konfidenciale, pa ndryshuar konstatimin fillestar për këtë subjekt.

2. Në lidhje me personat që subjekti ka udhëtuar jashtë shtetit, referuar të dhënave të hyrjedaljeve të sistemit *TIMS*, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka informuar mbi pronarët e automjeteve dhe qëllimin e udhëtimit. Nga verifikimet e kryera në lidhje me pronarët e këtyre automjeteve nuk rezultuan të dhëna për përfshirje të tyre në veprimtari të krimit të organizuar⁵³ apo në të dhëna për konflikte të mundshme interesi⁵⁴.

3. Në lidhje me shtetasin K. (K.) A., djali i xhaxhait të bashkëshortes së subjektit, gjatë hetimit administrativ, referuar informacionit të vënë në dispozicion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda⁵⁵, rezultoi se me vendimin nr. ***, datë 25.11.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, ky shtetas është deklaruar fajtor për veprën penale “trafikim i narkotikëve”, kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë dhe është dënuar me 10 vjet burgim, por pas aplikimit të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, është dënuar me 6 vjet burgim. Në këto kushte, në kuptim të pikës 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit “*Person i përfshirë në krimin e organizuar është çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009.*”, shtetasi K. A., konsiderohet person i përfshirë në krimin e organizuar.

Sa i takon shkallës së afërsisë me këtë person, në interpretim të vendimit nr. ***, datë 28.3.2013, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, shtetasi K. A. është krushqi në shkallë të katërt me subjektin e rivlerësimit dhe, si e tillë, subjekti nuk ka pasur detyrimin e deklaramit të këtij

⁵³ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 11.7.2019, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, dhe dokumentacionin shoqërues në dosjen e Komisionit.

⁵⁴ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 10.9.2020, nga SPAK-u; shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 14.9.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat; shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 16.9.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në dosjen e Komisionit.

⁵⁵ Shihni dosjen hetimore dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 24.9.2019, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në dosjen e Komisionit.

shtetasi në deklaratën për kontrollin e figurës, sipas shtojcës nr. 3 të ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon detyrimin për deklarimin e krushqisë deri në shkallë të dytë.

4. Nga të dhënat e organeve ligjzbatuese, qoftë nëpërmjet korrespondencës shkresore qoftë dhe nga verifikimi pranë tyre të informacioneve konfidenciale, ka pasur të dhëna për kontakte të subjektit me shtetasin A. Ç.. Gjatë hetimit administrativ janë kryer disa veprime hetimore me qëllim evidentimin e përfshirjes së këtij shtetasi në veprimtari të krimit të organizuar dhe në përfundim nuk rezultuan të dhëna⁵⁶. Gjithashtu, nga përgjigjet zyrtare konfidenciale të vëna në dispozicion nga institucionet kompetente të Drejtorisë së Policisë së Shtetit, nuk ka pasur informacione në lidhje me këtë shtetas.

5. Gjatë hetimit administrativ i janë kërkuar të dhëna institucionit të Presidentit, nëse ka pasur ndonjë informacion dërguar këtij institucioni nga ish-drejtuesi i SHISH-it në lidhje me subjektin e rivlerësimit, z. Arens Çela. Ky institucion, në përgjigjen e tij, ka rekomanduar që Komisioni t'i drejtohet SHISH-it duke qenë se në arkivat e tij nuk rezulton një informacion i tillë⁵⁷. Pas kërkesës së Komisionit, SHISH-i ka informuar se nuk ka një informacion të tillë.

6. Në datën 8.1.2021, për subjektin e rivlerësimit, z. Arens Çela, u administrua një denoncim i protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 8.1.2021, në të cilin ngriheshin pretendime për kontakte të subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar, si dhe për përfshirje në veprimtari korruptive. Pas njohjes me këtë denoncim dhe pretendimeve të ngritura në të, trupi gjykues, me vendimin e datës 8.1.2021, pavarësisht se me një pjesë të tyre ishte njohur gjatë procesit të rivlerësimit, reçeli hetimin administrativ duke vendosur kryerjen e disa hetimeve shtesë për subjektin e rivlerësimit, z. Arens Çela, si vijojnë:

- Në lidhje me pretendimin se prokurori Arens Çela ka kontakte të ngushta familjare dhe mban frekuentim të rregullt e të vazhdueshëm me z. M. Ç., i dënuar si anëtar i bandës së Lushnjës, iu kërkuar informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve nëse ky shtetas ka përfunduar ose jo vuajtjen e dënimit, me qëllim evidentimin e kontakteve në rast se ai e kishte përfunduar vuajtjen e dënimit. Në përgjigjen e tij, ky institucion⁵⁸ ka informuar se shtetasi M. R. Ç., i datëlindjes 18.10.1965, aktualisht është duke kryer dënimin në IEVP Penale Lushnjë, i dënuar me vendimin nr. ***, datë 22.9.2006, të Gjykatës së Krimeve të Rënda Tiranë me 25 vjet burgim. Nga dënimi i dhënë ka vuajtur gjithsej 22 vjet, 9 muaj e 14 ditë dhe i mbeten për të vuajtur edhe 2 vjet, 2 muaj e 16 ditë (llogaritja është bërë më 14.1.2021). Ndërkohë, ashtu sikurse është evidentuar më sipër, subjekti i rivlerësimit ka vetëdeklaruar në pjesën 5, “të dhëna për sigurinë”, të deklaratës së kontrollit të figurës, në lidhje me shtetasin M. R. Ç. (xhaxhai). Në përfundim të procesit nuk u evidentuan kontakte të subjektit me shtetasin M. Ç., i cili është duke vuajtur dënimin me heqje lirie.

- Në lidhje me pretendimin se prokurori Arens Çela ka kontakte të papërshtatshme me shtetasin K. A., si kushëri i parë i bashkëshortes A. A., person i hetuar dhe dënuar për përfshirje në krimin e organizuar, gjatë hetimit administrativ nuk u evidentuan të dhëna nga organet ligjzbatuese për kontakte të subjektit me shtetasin K. A. dhe as të dhëna nga çdo burim tjetër në lidhje me këtë fakt.

- Për sa i takon pretendimeve mbi përfshirje në veprimtari afëra korruptive duke mbyllur çështje penale ndaj disa personave të proceduar në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, denoncuesi nuk ka paraqitur asnjë provë për të vërtetuar pretendimet e tij. Por, pavarësisht kësaj, pas riçeljes së

⁵⁶ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 25.10.2019, nga Prokuroria e Përgjithshme dhe bashkëngjitur saj shkresën nr. *** prot., datë 22.10.2019, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe nr. *** prot., datë 23.9.2019, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në dosjen e Komisionit.

⁵⁷ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 8.9.2020, nga Institucioni i Presidentit të Republikës, në dosjen e Komisionit.

⁵⁸ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 27.1.2021, nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, në dosjen e Komisionit.

hetimit administrativ, Komisioni administroi nga SPAK-u⁵⁹ dosjet e dy procedimeve penale, konkretisht: (i) procedimi penal nr. ***, në ngarkim të shtetasit A. M., për nenet 245 dhe 260 të Kodit Penal, për të cilin pas përfundimit të hetimeve është vendosur pushimi i këtij procedimi datë 11.9.2019; (ii) procedimi penal me nr. ***, në emër të shtetasit Q. V., për nenet 245 dhe 260 të Kodit Penal, për të cilin pas përfundimit të hetimeve është vendosur pushimi i këtij procedimi, datë 11.9.2019.

Nga analiza e materialeve të këtyre dosjeve, trajtuar hollësisht në pjesën e vlerësimit profesional, nga Komisioni nuk u evidentuan të dhëna që hedhin dritë mbi pretendimet e denoncuesit që kishin lidhje me figurën e subjektit të rivlerësimit.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit në lidhje me kontrollin e figurës, nuk u evidentuan fakte dhe rrethana që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit apo kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, të cilat do të ndryshonin konstatimin fillestar të grupit të punës pranë DSIK-së, duke çmuar se subjekti i rivlerësimit, z. Arens Çela, është i përshtatshëm për vijimin e ushtrimit të detyrës, për shkak se ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016 është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit Arens Çela, bazuar në:

A. Raportin nr. *** prot., datë 25.7.2019, për aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Prokuroria e Përgjithshme, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 30.7.2019, në përmbajtjen e të cilit rezulton që subjekti është vlerësuar pozitivisht për aftësitë profesionale, si vijon:

1. Për aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Nga analiza e tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të shortuara, rezulton se prokurori Arens Çela, sa i përket periudhës së rivlerësimit, shfaq aftësi në drejtim të zbatimit të ligjit.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit Arens Çela shfaq aftësi në arsyetim ligjor. Konstatohet se prej tij bëhet analizë mbi rrethanat e faktit dhe provave të mbledhura, duke shprehur qëndrimin e tij logjik mbi zgjidhjen ligjore.

2. Për aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Sipas të dhënave të deklaruara nga subjekti në formularin e vetëdeklarimit rezulton se për periudhën e punës si prokuror, subjekti ka trajtuar 111 çështje. Nga analiza e kohëzgjatjes së trajtimit të çështjeve, konstatohet se subjekti Arens Çela ka treguar aftësi të mira në organizimin efektiv të kohës së punës, e lidhur kjo me kohën e përfundimit të çështjeve të analizuara dhe numrit total të çështjeve të përfunduara, për të gjithë periudhën e vlerësimit duke pasur në konsideratë edhe faktin se subjekti, gjatë gjithë periudhës së rivlerësimit, ka kryer detyrën e drejtuesit.

⁵⁹ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 21.1.2021, nga SPAK-u në dosjen e Komisionit, me të cilën përcillen dosjet e dy procedimeve penale.

b) Aftësia për të kryer procedurat hetimore/gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit Arens Çela kryen veprime procedurale hetimore dhe veprimet rezultojnë të jenë produktive. Veprimet dhe procedurat në kuadër të procedimeve penale dhe materialeve kallëzuese u referohen dispozitave ligjore përkatëse, duke mbledhur provat e aktet e nevojshme dhe konkluduar në një vendimmarrje. Lidhur me njoftimet e vendimmarrjeve konstatohet se është respektuar detyrimi për të kryer njoftimet përkatëse subjekteve.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Prokurori ka treguar aftësi të mira në drejtim të përfundimit të hetimeve, rregullsisë së akteve dhe mbajtjes së tyre sipas një rregulli të mirëpërcaktuar në dosjet përkatëse. Dosjet e vëzhguara janë të rregullta, të plota dhe aktet procedurale të përpiluara, janë të strukturuar dhe në respektim të normave të drejtshkrimit.

3. Për etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga aktet e përzgjedhura nga subjekti, si dhe nga dosjet e hedhura në short ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Nuk janë gjetur të dhëna që të tregojnë se nga subjekti të jenë kryer veprime apo mbajtur qëndrime të tilla, jo në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Arens Çela dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e rëna në short nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit, të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie apo gjuhe diskriminuese të subjektit të rivlerësimit, prokurorit Arens Çela.

4. Për aftësitë personale dhe angazhimin profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Nga tri dokumentet ligjore të vetëpërzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe nga pesë dosjet e rëna në short, vihet re se komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në dokumentet ligjore të dorëzuara nga subjekti konstatohen të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit, prokurorit Arens Çela, për të bashkëpunuar me kolegët pasi në këtë procedim penal ka qenë i ngarkuar për hetimin e tij me grup prokurorësh.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Në lidhje me vlerësimin e gatishmërisë për t'u angazhuar, subjekti Arens Çela rezulton gjatë kohës së rivlerësimit dhe më parë ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh me temë në fushën penale, të organizuar pranë dhe jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, si dhe është angazhuar si moderator në Shkollën e Magjistraturës në një rast.

B. Informacioni i marrë nga burime të ligjshme, ku si të tilla janë konsideruar:

1. Informacioni i marrë nga tri vendimet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë çështjet e shortuara sipas nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, nga analiza e të cilave rezultuan të njëjtat gjetje të konstatuara edhe nga Grupi i Punës së Prokurorisë së Përgjithshme në raportin e tij.

2. Informacioni i marrë nga 11 denoncime nga publiku⁶⁰ paraqitur sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, pas verifikimit të të cilave dhe pas kryerjes së disa veprimeve hetimore nga Komisioni, për 10 prej tyre, nuk u konstatuan problematika në veprimet procedurale të subjektit të rivlerësimit, ndërsa për një denoncim, atë që i përket shtetasit A. Xh., Komisioni ka thelluar hetimin administrativ, si vijon:

Në denoncimin e tij, denoncuesi A. Xh. ngre pretendime lidhur me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit Arens Çela, që sipas tij, ka pushuar hetimin e një çështjeje të filluar bazuar në një kallëzim të bërë prej tij për dhunim banese nga disa punonjës policie, pa marrë parasysh provat e vëna në dispozicion prej tij dhe pa kryer hetime të plota. Me qëllim verifikimit e pretendimeve të denoncuesit, Komisioni administroi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat dosjen penale të procedimit penal nr. 326/2010⁶¹, nga aktet e së cilës rezultoi se:

- në datën 6.5.2010 shtetasi G. T. (punonjës policie) ka bërë kallëzim ndaj shtetasit A. Xh. (denoncues), me pretendimin se e kishte fyer për shkak dhe gjatë ushtrimit të detyrës;

- në datën 7.5.2010 shtetasi A. Xh. kishte bërë një kallëzim penal ndaj shtetasit G. T. me detyrë oficer i policisë gjyqësore dhe 3 policëve të tjerë, me pretendimin se e kishin rrahur dhe ofenduar pa të drejtë;

- me vendimin për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor të datës 7.5.2010, oficeri K. S. vendosi kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor të shtetasit A. Xh.. Nga aktdëshmia mjeko-ligjore “Mbi ekzaminimin e shtetasit A. Xh.”, në datën 7.5.2010, eksperti mjeko-ligjor M. M. ka arritur në konkluzionin se tek i dëmtuari A. Xh. “...konstatohen dëmtime (hematoma...) të shkaktuara me mjete të forta jo të mprehta. Këto dëmtime hyjnë në dëmtimet që shkaktajnë humbjen e aftësisë për punë deri në 9 ditë”;

- me urdhrin për regjistrimin e procedimit penal, datë 20.6.2010, prokurori Arens Çela, urdhëroi regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “kryerja e veprimeve arbitrare”, parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal, mbi kallëzimin e bërë nga shtetasi A. Xh.;

- me urdhrin për regjistrimin e procedimit penal, datë 26.5.2010, prokurori Arens Çela urdhëroi regjistrimin e procedimit penal për veprat penale “kundërshtim të punonjësve të policisë” dhe “fyrje për shkak të detyrës” mbi kallëzimin e shtetasit G. T.;

- me vendimin për bashkimin e procedimeve, datë 20.6.2010, prokurori Arens Çela vendosi bashkimin e procedimeve penale nr. *** dhe nr. *** të vitit 2010, mbi kallëzimet e bëra nga shtetasit G. T. dhe A. Xh. kundër njëri-tjetrit, në një procedim të vetëm, atë me nr. ***;

⁶⁰ Shihni denoncimin nga shtetasi A. M., protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 14.9.2018; denoncim nga shtetasi A. J., protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 16.1.2018; denoncim nga shtetasi A. Sh., protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 26.12.2017; denoncim nga shtetasi D. B. protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 24.7.2018; denoncim nga shtetasi M. K. protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 30.5.2019; denoncim dërguar me e-mail nga shtetasi P. Dh., protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 15.4.2019 dhe ankesë nga shtetasi P. Dh., protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 16.4.2019; denoncim nga shtetasja D. P., protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 8.1.2018; denoncim nga shtetasi T. D., protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 26.7.2019; denoncim nga shtetasi Rr. Sh., protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 31.8.2020; denoncim nga shtetasi A. T., protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 16.8.2019, në dosjen e Komisionit.

⁶¹ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 18.7.2019, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, në dosjen e Komisionit.

- me vendimin e datës 17.11.2010, prokurori Arens Çela vendosi pushimin e pjesshëm të hetimit për procedimin penal nr. ***, vetëm për sa i përket hetimit në ngarkim të shtetasit G. T. dhe vazhdimin e hetimeve në ngarkim të shtetasit A. Xh.;

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin e datës 7.6.2011, vendosi prishjen e vendimit të datës 17.11.2010, “Për pushimin e pjesshëm të hetimit për procedimin penal nr. ***, viti 2010, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat” dhe vazhdimin e hetimeve për kallëzimin e kryer më 7.5.2010, nga shtetasi A. Xh., duke lënë si detyrë kryerjen e disa veprimeve hetimore si vijojnë: (i) të pyetet nëna e ankuesit A. Xh., shtetasja M. Xh.; (ii) të identifikohen dhe të pyeten punonjësit e Avokatit të Popullit, të cilët kanë qenë në Komisaratin e Policisë Kuçovë, më 6.5.2010; (iii) të identifikohet dhe të pyetet punonjësi i policisë gjatë shoqërimit dhe ndalimit të shtetasit A. Xh. (i cili e ka ruajtur atë, i ka dhënë një shishe me ujë dhe i ka dhënë këpucët e dërguara nga i ati); (iv) të kryhet veprimi hetimor “paraqitje për njohje” për 4 punonjësit e policisë që janë akuzuar për ushtrim dhune fizike në mënyrë të vazhdueshme gjatë shoqërimit të shtetasit A. Xh.;

- Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 26.6.2013, vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat;

- me urdhrin e datës 6.9.2013, subjekti Arens Çela vendosi të rifillojë hetimin për procedimin penal nr. ***, të vitit 2010;

- me vendimin për pushimin e procedimit penal të datës 10.6.2014, subjekti i rivlerësimit Arens Çela, në mbështetje të gremës “dh”, të nenit 328/1, të Kodit të Procedurës Penale ka vendosur “Pushimin e procedimit penal nr. *** për veprën penale të parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal “Kryerjes së veprimeve arbitrare” .

Nga shqyrtimi i akteve të administruara si më sipër, u konstatua se gjatë veprimeve të dyta hetimore, prokurori Arens Çela ka përmbushur dy nga veprimet e lëna detyrë nga gjykata. Konkretisht: (i) është pyetur nëna e shtetasit A. Xh., znj. M. Xh.; (ii) është identifikuar punonjësi i Avokatit të Popullit dhe është marrë deklarami i tij. Ndërkohë nuk ka përmbushur dy detyrat e tjera të lëna nga gjykata. Konkretisht: (i) nuk është kryer veprimi hetimor “paraqitje për njohje” për 4 punonjësit e policisë, të cilët denoncuesi i akuzon se kanë ushtruar dhunë të vazhdueshme gjatë shoqërimit në komisaratin e policisë; (ii) nuk është pyetur polici i kërkuar nga denoncuesi.

Veç sa më sipër, në vendimin e pushimit të procedimit penal nr. ***, nuk përmendet konkluzioni i aktdëshmisë mjeko-ligjore, datë 7.5.2010, sipas të cilit: “... te i dëmtuari konstatohen dëmtime (hematoma...) të shkaktuara me mjete të forta jo të mprehta. Këto dëmtime hyjnë në dëmtimet që shkaktojnë humbjen e aftësisë për punë deri në 9 ditë ...”. Ndërkohë që në përmbajtjen e vendimit të pushimit, subjekti, në kundërshtim me çka përcakton dëshmia mjeko-ligjore, është shprehur : “... nga dëshmitë e personave të pyetur gjatë këtij hetimi nuk është bërë e mundur të zbardhet fakti i pretenduar nga kallëzuesi A. Xh., që ndaj të tij të jetë ushtruar dhunë nga punonjësit e policisë gjatë shoqërimit për në ambientet e Komisarariatit të Policisë Kuçovë, përveç forcës së përdorur për të bërë të mundur shoqërimin e tij në ambientet e policisë pasi ai i ishte shmangur këtij fakti” .

Në përfundim të hetimit administrativ, me njoftimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkuan sqarime, së pari, lidhur me moskryerjen e të gjitha veprimeve hetimore të lëna si detyrë nga gjykata; së dyti, mosmarrjen në konsideratë të konkluzionit të aktdëshmisë mjeko-ligjore, duke arsyetuar ndryshe nga sa është përcaktuar në këtë akt.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

Në parashtrimet e datës 5.1.2020, subjekti ka sqaruar si vijon:

Në lidhje me veprimin procedural të njohjes, sipas tij, është e vërtetë që gjykata e ka urdhëruar kryerjen e këtij veprimi hetimor, por kjo sipas subjektit, duhej bërë në fund të veprimeve hetimore, vetëm pasi të vërtetohej fakti penal i kryerjes së veprës penale. Duke qenë se nuk u provua ky fakt, subjekti argumenton se kryerja e veprimit procedural të njohjes për të bërë të mundur individualizimin e autorëve të mundshëm, është vlerësuar si i panevojshëm. Po kështu, subjekti ka sqaruar se veprimi i njohjes nuk mund të kryhet sa herë ka një kallëzim penal, pasi do të ishte e vështirë që t'u kërkoje punonjësve publikë të rreshtoheshin për t'u bërë objekt i njohjes sa herë që ndaj Komisarariatit të Policisë ka një pretendim të natyrës penale.

Pavarësisht këtyre pretendimeve, Komisioni çmoi se subjekti nuk ka dhënë sqarime e argumente bindëse në lidhje me mospërmbushjen tërësisht të detyrave të lëna nga gjykata, urdhërimet e së cilës për çështje të kësaj natyre janë të detyrueshme për prokurorin. Gjithashtu, subjekti nuk ka dhënë sqarime mbi veprimin tjetër hetimor të lënë si detyrë nga gjykata atë të identifikimit dhe pyetjes së punonjësit të policisë gjatë shoqërimit dhe ndalimit të shtetasit A. Xh.. Sa i takon akt-dëshmisë mjeko-ligjore, subjekti ka sqaruar se ky akt është marrë dhe vlerësuar prej tij sipas bindjes së brendshme, duke arsyetuar se masa e dhunës së ushtruar është konstatuar si e nevojshme, e domosdoshme dhe proporcionale në raport me kryerjen nga policia të detyrave të saj funksionale. Por, realisht, në vendimin e pushimit të datës 10.6.2014, mungon të jetë kryer një arsyetim nga subjekti në lidhje me dëmtimet e shtetasit A. Xh. sipas konkluzioneve të aktit të dëshmisë mjeko-ligjore, i cili nuk rezulton të jetë përmendur fare në vendim, duke iu referuar vetëm dëshmimeve të personave të pyetur e duke anashkaluar në këtë mënyrë akt-dëshminë mjeko-ligjore.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni nuk i vlerësoi mangësitë procedurale të evidentuara më sipër, të tilla që cenojnë aftësitë profesionale të subjektit, ndërsa në proporcion me të gjitha faktet dhe rrethanat e evidentuara gjatë procesit të rivlerësimit, nuk i konsideroi ato si shkak për penalizimin e tij, duke mbajtur në konsideratë edhe opinionin e Komisionit të Venecias⁶² dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese⁶³, të cilët kanë vendosur qartë kufirin ndarës për një vlerësim negativ të aftësive profesionale, i cili bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara që tregojnë mungesë të aftësive profesionale. Për rrjedhojë, vlerësohet se problematika e këtij rasti nuk është e mjaftueshme për ta klasifikuar subjektin e rivlerësimit me “mangësi profesionale” sipas gërmës “b”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, por vlerësoi që ta transferojë çështjen që i përket procedimit penal nr. ***, pranë organit kompetent për inspektim të shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore sipas pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

3. Informacioni i marrë nga të dhëna të sistemit *TIMS*, si vijojnë:

3.1. Në lidhje me automjetet me targa *** dhe ***, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 subjekti i ka deklaruar përkatësisht në pronësi të shtetasve G. M. K. dhe F. K., mjete me të cilat ka udhëtuar si pasagjer.

Gjatë hetimit administrativ, nga verifikimi në sistemin *TIMS*, rezultoi se shtetasi F. K. dhe subjekti i rivlerësimit kanë pasur tri hyrje-dalje jashtë shtetit, me 1-2 ditë qëndrimi, gjatë viteve 2014, 2015 dhe 2016, me automjetin me targa ***, në pronësi të shtetasit G. K. dhe me automjetin me targa ***, i cili referuar sistemit të AMF-së, rezulton në pronësi të shoqërisë “****”. Referuar raportit të ngjarjes në sistemin *TIMS*, në lidhje me shtetasin F. K., rezultoi se

⁶² Shihni opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias.

⁶³ Shihni vendimin nr. 2, datë 18.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese.

ndaj këtij shtetasi ka pasur një procedim penal të vitit 2013, sipas të cilit, ky shtetas është akuzuar për veprën penale “falsifikim i dokumenteve”. Me qëllim heqjen e çdo dyshimi në lidhje me një favorizim të mundshëm të këtij shtetasi nga subjekti i rivlerësimit në trajtimin e kësaj çështjeje, i cili në vitin 2013 ka qenë drejtues i Prokurorisë Berat, nga Komisioni u kryen verifikimet si vijojnë:

- Subjekti i rivlerësimit u pyet në lidhje me shtetasin F. M. K. dhe marrëdhëniet me të, i cili konfirmoi njohjen dhe miqësinë me të që në vitin 2014, duke deklaruar se nuk është në dijeni të ndonjë problemi ligjor të tij dhe se nuk ka ushtruar asnjë ndikim në lidhje me të⁶⁴.

- U administrua nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat dosja e procedimit penal nr. ***⁶⁵, nga aktet e së cilës u konstatua se ky procedim (bashkim i tre procedimeve) ishte regjistruar në ngarkim të shtetasit nën hetim F. K. për veprën penale të parashikuar nga neni 200 i Kodit Penal, “Pushtimi i tokës”, mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasit H. Gj. dhe me vendimin e datës 5.7.2013, nga prokurori i çështjes E. B., është vendosur pushimi i këtij procedimi penal.

- Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat iu kërkua të vërë në dispozicion kopjen e materialit të referuar nga Drejtoria e Policisë Berat për veprën penale “falsifikim të dokumenteve”, e cila informoi se me shkresën e datës 20.3.2013 nga DVPB-ja⁶⁶ është përcjellë materiali hetimor në ngarkim të shtetasit F. K. për veprën penale “shkatërrim të pronës”, parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal dhe po kështu referimi i veprës penale te prokurori është bërë për veprën penale “shkatërrim i pronës”. Siç vërehet, Prokurorisë Berat nuk i është referuar vepra penale “falsifikim i dokumenteve” në ngarkim të shtetasit F. K., por vepra penale “shkatërrim i pronës”.

- Me qëllim verifikimin e veprës penale të referuar, Drejtorisë Vendore të Policisë Berat iu kërkua informacion, e cila informoi se⁶⁷: “... nga ana e shërbimeve të Seksionit për Krimin Ekonomik Financiar, në Drejtorinë Vendore të Policisë Berat, në datën 15.3.2013 është raportuar referimi i materialit hetimor Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat, në ngarkim të shtetasit F. K., i dyshuar për veprën penale ‘falsifikim i dokumenteve’... Për rastin janë kryer veprimet e para hetimore dhe procedurale dhe aktet procedurale të kryera i janë dërguar organit procedues Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat me shkresën me nr. ***, datë 20.3.2013 ...”. Sipas kësaj shkrese të vënë, gjithashtu, në dispozicion të Komisionit, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat i është përcjellë materiali hetimor në ngarkim të shtetasit F. K., për veprën penale “shkatërrim i pronës” parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal, dhe jo për veprën penale “falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.

- U këqyrën në vend regjistrat e korrespondencës pranë Drejtorisë së Policisë Berat dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, nga ku rezultoi se:

i) Nga këqyrja e regjistrit të korrespondencave pranë Drejtorisë së Policisë Berat rezultoi se për shtetasin F. K. janë regjistruar dy shkresa: (1) nr. ***, datë 20.3.2013 me përshkrimin “dërgojmë materiale hetimore për shtetasin F. K., Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Berat”; dhe (2) nr. ***, datë 19.3.2013⁶⁸, me përshkrimin “dërgojmë materiale për shtetasin F. K., Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Berat”, shkresë e cila nuk gjendej ne arkivin e këtij institucioni,

⁶⁴ Shihni përgjigjet e pyetësorit të datës 19.11.2020, në dosjen e Komisionit.

⁶⁵ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 11.9.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, në dosjen e Komisionit.

⁶⁶ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 24.9.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, në dosjen e Komisionit.

⁶⁷ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 7.10.2020, nga Drejtoria Vendore e Policisë Berat, në dosjen e Komisionit.

⁶⁸ Shihni dy fletë regjistrat, fotokopje me vulë e nënshkrim të Drejtorisë së Policisë Berat, në dosjen e Komisionit.

por që siç sqarohet në korrespondencën e mëtejshme nga ky institucion⁶⁹ mendohet se është shënuar gabimisht nga sekretaria e DVP-së Berat gjatë dinamikës së punës”.

ii) Nga këqyrja e regjistrimit të korrespondencave pranë Prokurorisë Berat, rezulton se për shtetasin F. K. është regjistruar vetëm shkresa nr. ***, datë 20.3.2013, e cila referon veprën penale “shkatërrim të pronës” në ngarkim të tij, ndërkohë që nuk u gjetën të dhëna në lidhje me shkresën nr. ***, datë 19.3.2020.

Sa më sipër, rezulton se Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat, i është përcjellë materiali kallëzues për shtetasin F. K. me shkresën nr. ***, datë 20.3.2013, vetëm për veprën penale “shkatërrim të pronës”, për të cilën është regjistruar procedimi penal nr. ***, viti 2013.

Sa i takon rolit të subjektit të rivlerësimit në trajtimin e kësaj çështjeje në cilësinë e Drejtuesit të Prokurorisë, u verifikuan aktet e dosjes së procedimit penal, nga ku rezultoi se z. Arens Çela ka kryer veprimet hetimore si vijojnë: (i) ka vendosur bashkimin e tri procedimeve penale të nisura mbi bazën e kallëzimit të bërë nga shtetasi H. Gj., një nga të cilët është regjistruar në ngarkim të shtetasit F. K.; (ii) ka drejtuar kërkesa për marrje informacioni në institucione të ndryshme për nevoja të hetimit; (iii) ka kontrolluar dosjen hetimore dhe ka arritur në vlerësimin se hetimet e kryera kanë qenë të plota duke konfirmuar vendimin e pushimit të prokurorit të çështjes; (iv) i ka përcjellë shtetasve F. K. dhe H. Gj. vendimin e pushimit të prokurorit të çështjes me datë 24.7.2013. Nga veprimet e kryera prej subjektit të rivlerësimit, në rolin e Drejtuesit të Prokurorisë nuk u evidentuan elementë me natyrë ndikuese apo favorizuese.

Veç sa më sipër, në lidhje me shtetasit F. K. e G. K. nuk u konstatuan të dhëna për konflikte të mundshme interesi me subjektin e rivlerësimit⁷⁰ apo për përfshirje të tyre në veprimtari të krimin të organizuar⁷¹.

Në përfundim të hetimit administrativ nuk u vërtetuan fakte e rrethana që vërtetojnë favorizimin e shtetasit F. K. nga subjekti i rivlerësimit.

3.2. Në lidhje me automjetin me targa ***, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se ky automjet është në pronësi të kunatit të tij (vëllai i bashkëshortes) D. A., fakt i konfirmuar edhe nga verifikimet e kryera gjatë hetimit administrativ⁷².

Referuar informacioneve të marra në media ka rezultuar se emri i këtij shtetasi ishte përmendur në çështjen e njohur si çështja e rrëzimit të avionit me lëndë narkotike në plazhin e Divjakës. Për këtë arsye, Komisioni ka kryer disa verifikime, në përfundim të të cilave, rezultoi se shtetasi D. A. është kërkuar të pyetet si dëshmitar në gjykimin e çështjes penale nr. ***, viti 2014, nga prokurorët D. M., E. I. dhe P. K.⁷³ dhe se është pyetur në cilësinë e deklaruesit nga oficeri i Policisë Gjyqësore I. Ho.⁷⁴ Nga verifikimi i akteve të dosjes penale nuk rezultoi që subjekti të ketë shqyrtuar çështje në ngarkim të shtetasit D. A. dhe as ta ketë pyetur atë si person që ka dijëni për rrethanat e çështjes. Gjithashtu, pas verifikimeve pranë agjencive ligjzbatuese, sipas

⁶⁹ Shihni shkresën zyrtare nr. *** prot., datë 26.11.2020, dërguar në rrugë elektronike më 26.11.2020, nga Drejtoria e Policisë Berat, në dosjen e Komisionit.

⁷⁰ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 14.9.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, në dosjen e Komisionit; shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 18.9.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë; shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 24.9.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat; shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 26.11.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në dosjen e Komisionit.

⁷¹ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 10.9.2020, nga SPAK-u në dosjen e Komisionit.

⁷² Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 14.9.2020, nga DPSHTRr-ja në dosjen e Komisionit.

⁷³ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 22.2.2019, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe shkresën nr. *** prot., datë 16.9.2019, në dosjen e Komisionit.

⁷⁴ Shihni dosjen hetimore dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 24.9.2019, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në dosjen e Komisionit. Shihni fashikullin e prokurorit, vol. III, në dosjen e Komisionit.

informacioneve konfidenciale nuk rezultuan të dhëna për shtetasin D. A., ashtu sikurse nuk rezultuan procedime penale në ngarkim të tij⁷⁵.

3.3. Nga të dhënat e sistemit *TIMS* rezultoi se subjekti ka udhëtuar me shtetasin A. Ç., vëllai i tij, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Në ngarkim të këtij shtetasi, rezultoi të jetë regjistruar kallëzimi penal me nr. ***, viti 2017, për korrupsion, për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit për materialin kallëzues, datë 23.5.2017, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, nga prokurorja M. K.. Me qëllim evidentimin e një favorizimi të mundshëm të shtetasit A. Ç. për shkak të pozicionit të vëllait të tij, Arens Çela, nga Komisioni u administrua dosja përkatëse, vënë në dispozicion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda⁷⁶, pas verifikimit dhe shqyrtimit të akteve të së cilës nuk rezultuan të dhëna që të ngrinin dyshime për favorizim shtetasit A. Ç. gjatë trajtimit të çështjes dhe, aq më pak, për ndikim të vëllait të tij, subjektit të rivlerësimit Arens Çela në këtë çështje.

Informacion i marrë nga denoncime të administruara⁷⁷, pas mbylljes së hetimit administrativ

4.1. Në datën 8.1.2021, për subjektin e rivlerësimit, z. Arens Çela, u administrua një denoncim i ri, i protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 8.1.2021, në të cilin ngriheshin disa pretendime si vijojnë:

Së pari, pretendohet se subjekti i rivlerësimit ka kryer veprime hetimore dhe administrative në çështjen penale të regjistruar në ngarkim të shtetasit A. Ll., në kushte të rënda të konfliktit të interesit për shkak të raporteve familjare dhe gjinore. Në lidhje me këtë denoncim, pas riçeljes së hetimit administrativ u kryen verifikimet e mëposhtme:

i) Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjen e tij të datës 11.1.2021, ka deklaruar se: *“Në lidhje me shtetasin A. Ll., për herë të parë personalisht, jam prezantuar ditën që jam emëruar drejtuesi Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat, data 4.4.2013. Nuk e kam njohur më përpara përveç nga pamjet e dhëna në media. Në lidhje me marrëdhëniet që kam pasur me këtë shtetas, Ju sqaroj se kam pasur marrëdhënie korrekte të mbështetura mbi raportet e detyrës, pasi ai ka qenë Prokurori i Përgjithshëm. Gjatë gjithë kësaj kohe marrëdhënia ka qenë vetëm e lidhur me detyrën, dhe kurrë nuk kam krijuar raporte personale. Kjo verifikohet lehte edhe nga sistemi TIMS, kur ndryshe nga shumë drejtues të tjerë të prokurorisë në atë periudhë, nuk kam qenë pjesë e asnjë delegacioni në përbërje të të cilit të ketë qenë dhe z. A. Ll.”.*

ii) DPGJC-së iu kërkua informacion mbi trungun familjar të subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit A. Ll. për të gjitha vitet e regjistrimit, nga ku rezultoi⁷⁸ se shtetasja N. Ç. (gjyshja e subjektit të rivlerësimit Arens Çela) dhe shtetasja F. L. (gjyshja e shtetasit A. Ll.) janë të dyja nga fshati Sh., Gramsh. Pra, nuk u evidentuan lidhje familjare të subjektit me shtetasin A. Ll..

⁷⁵ Shihni dokumentet bashkëngjitur shkresës kthim përgjigje nr. *** prot., datë 25.10.2019, nga Prokuroria e Përgjithshme; shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 11.7.2019 dhe nr. *** prot., datë 16.9.2019, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë;

⁷⁶ Shihni dosjen bashkëngjitur shkresës kthim përgjigje nr. *** prot., datë 11.7.2019, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, në dosjen e Komisionit.

⁷⁷ Shihni denoncimin nga shtetasi A. V., dërguar në rrugë elektronike në datën 1.3.2021; shihni denoncimin nga shtetasi A. V., dërguar në rrugë elektronike në datën 1.3.2021; shihni denoncimin nga shtetasi A. M., dërguar në rrugë elektronike në datën 2.3.2021; shihni denoncimin nga shtetasi B. M. dërguar në rrugë elektronike në datë 2.3.2021, në dosjen e Komisionit

⁷⁸ Shihni shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 27.1.2021, nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile; shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 29.1.2021, nga Zyra e Gjendjes Civile Lushnjë *** dhe *** dhe dokumentet bashkëngjitur; shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 29.1.2021, nga Zyra e Arkivit të Gjendjes Civile, nënprefekti Gramsh dhe dokumentet bashkëngjitur në dosjen e Komisionit.

Gjithashtu, në parashtrimet e tij të datës 24.2.2021, subjekti ka deklaruar se nuk ka kryer asnjë veprim të karakterit procedural apo administrativ, në procedimin penal në fjalë.

Së dyti, në denoncim ngriheshin pretendime për përfshirje të subjektit të rivlerësimit në afera korruptive, duke mbyllur çështje penale ndaj personave të proceduar në Prokurorinë e Krimeve të Rënda. Pas riçeljes së hetimit administrativ, pavarësisht se denoncuesi nuk kishte paraqitur prova për të mbështetur pretendimet e tij për përfshirje të subjektit në korrupsion, me qëllim verifikimin e veprimeve hetimore të kryera nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni administroi nga SPAK⁷⁹ dosjet e dy procedimeve penale, konkretisht, dosjet që i përkasin: (i) procedimit penal nr. 278/2017, në ngarkim të shtetasit A. M., për nenet 245 dhe 260 të Kodit Penal, për të cilin pas përfundimit të hetimeve është vendosur pushimi i këtij procedimi në datën 11.9.2019; (ii) procedimit penal nr. ***, në emër të shtetasit Q. V., për nenet 245 dhe 260 të Kodit Penal, për të cilin pas përfundimit të hetimeve është vendosur pushimi i këtij procedimi në datën 11.9.2019.

4.1.1. Në lidhje me procedimin penal nr. *, në ngarkim të shtetasit A. M., nga aktet e dosjes penale u konstatua se:**

- me urdhrin për regjistrimin e procedimit penal të datës 11.9.2017, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, prokurori H. L., ka regjistruar procedimin penal për krimin e shtrëngimit me anën e kanosjes për dhënien e pasurisë, në dëm të zj. F. V. (K.), parashikuar nga neni 109/b/1 i Kodit Penal, në ngarkim të personit në hetim A. M.;

- me urdhrin për kryerjen e hetimeve paraprake të datës 13.9.2017, prokurori H. L. ka urdhëruar kryerjen e veprimeve hetimore: (i) sekuestrimin e telefonave celularë të së dëmtuarës, të dyshuarit dhe shtetasës A. D.; (ii) kryerjen e ekspertimit teknik të tyre për të siguruar të dhëna për hetime të mëtejshme, brenda datës 30.9.2017;

- me vendimet për zgjatjen e afatit të hetimeve të datave 11.12.2017, 9.3.2018 dhe 12.7.2018, prokurori H. L. ka zgjatur me tre muaj afatin e hetimeve paraprake, deri në datën 11.9.2018;

- me vendimin për zëvendësimin e prokurorit të datës 12.7.2018, për shkak se prokurori H. L. në datën 3.7.2017 ka paraqitur dorëheqjen nga detyra e prokurorit pranë Prokurorisë për Krime të Rënda, është urdhëruar zëvendësimi i tij me prokurorin O. Ç., i cili do të vazhdojë hetimin e çështjes penale nr. ***, të vitit 2017;

- me vendimin për zgjatjen e afatit të hetimeve të datës 11.9.2018, prokurori O. Ç. ka zgjatur afatin e hetimeve ndaj personit nën hetim deri në datën 11.12.2018;

- me vendimin për zëvendësimin e prokurorit të datës 28.9.2018 për shkak të transferimit të prokurorit O. Ç., është vendosur zëvendësimi i prokurorit O. Ç., me prokurorin Arens Çela, i cili do të vazhdojë hetimin e çështjes penale nr. ***, të vitit 2017;

- me vendimin për zgjatjen e afatit të hetimeve të datës 11.12.2018, prokurori Arens Çela ka vendosur zgjatjen e afatit të hetimit të këtij procedimi deri në datën 11.3.2019, duke parashtruar se: *“Nga ana e prokurorisë, janë kryer një sërë veprimesh procedurale si këqyrja dhe marrja e dokumenteve, praktikave dhe akteve të tjera të rëndësishme për hetimin. Po kështu, del e nevojshme të administrohet përpunimi i të dhënave të aktit të ekspertimit të telefonit celular dhe të kryhen veprime të mëtejshme në varësi të tyre”*;

- sipas procesverbalit për këqyrjen e provave materiale të datës 31.1.2019 është këqyruar DVD me të dhënat e telefonave celularë nga oficeri i policisë gjyqësore E. Ç.;

⁷⁹ Shihni shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 21.1.2021, nga SPAK në dosjen e Komisionit, me të cilën përcillen dosjet e dy procedimeve penale.

- me vendimin për zgjatjen e afatit të hetimeve të datës 11.3.2019, prokurori Arens Çela ka vendosur zgjatjen e afatit të hetimit deri në datën 11.5.2019, duke arsyetuar se: *“Nga ana e prokurorisë, janë kryer një sërë veprimesh procedurale si këqyrja dhe marrja e dokumenteve, praktikave dhe akteve të tjera të rëndësishme për hetimin. Po kështu, del e nevojshme që pas administrimit dhe përpunimit të të dhënave të aktit të ekspertimit të telefonit celular të kryhen veprime të mëtejshme në varësi të tyre”*;

- me kërkesën për pushimin e procedimit penal të datës 28.0.2019, prokurori Arens Çela ka kërkuar pushimin e procedimit penal nr. ***, regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 109/b⁸⁰ i Kodit Penal, duke arsyetuar se nga hetimi i këtij procedimi penal nuk rezultoi e provuar se kemi të bëjmë me elementët e veprës penale *“shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë”*, të parashikuar nga neni 109/b i Kodit Penal. Megjithëse provohet se midis kallëzueses dhe personit nën hetim ka pasur një komunikim, i cili ka vazhduar dhe me dorëzimin e një shume të hollash në interes të personit nën hetim, nuk provohet elementi i anës objektive i domosdoshëm për këtë veprë penale, pra, shtrëngimi ose kanosja;

- gjykata me vendimin nr. *** akti, datë 28.5.2019, i ktheu aktet prokurorit për plotësimin e hetimeve, për të pyetur në cilësinë e deklaruueses (dëshmitares) shtetasen që ka paraqitur kallëzimin për veprën penale/viktimën F. K. (V.), si dhe kryerjen e veprimeve të tjera hetimore që do të vlerësoheshin nga prokurori në varësi të nevojave që do të lindnin pas pyetjes së saj;

- në datën 2.7.2019, prokurori Arens Çela riparaqiti në gjykatë kërkesën për pushimin e çështjes ndaj shtetasit A. M.. Në lidhje me detyrat e caktuara nga gjykata, prokurori në kërkesë sqaroi se ka qenë e pamundur pyetja e shtetasës F. K. për shkak se ishte larguar jashtë shtetit që prej datës 8.11.2018 dhe nuk ishte kthyer më, siç rezultonte edhe nga procesverbali i datës 1.7.2019 për këqyrjen e sistemit *TIMS*.

- Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda me vendimin nr. *** akti, datë 11.9.2019, të gjyqtarit A. M. ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit për pushimin e çështjes penale nr. ***, të vitit 2017, në ngarkim të personit ndaj të cilit zhvillohen hetime A. M., pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale;

- nuk rezulton të jete bërë ankim kundër këtij vendimi.

Bazuar në të gjitha aktet e administruara si më sipër, rezultoi se hetimet për çështjen në ngarkim të shtetasit A. M., nga data e regjistrimit të saj me emër personi nën hetim, më 11.9.2017, deri në datën e kërkesës së pushimit të prokurorit Arens Çela më 28.3.2019, kanë zgjatur për një periudhë prej një viti e gjysmë. Në lidhje me kohëzgjatjen e hetimit të çështjes, duke mbajtur në konsideratë dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, konkretisht, nenet 323⁸¹ dhe 324⁸² të tij, afati i përfundimit të hetimeve është tre muaj, ndërkohë që zgjatja e afatit sipas këtyre dispozitave është e kushtëzuar vetëm në rastet e hetimeve komplekse ose të pamundësisë objektive për t'i përfunduar ato brenda afatit të zgjatur.

Nga përmbajtja e dy vendimeve për zgjatjen e afatit të hetimeve të prokurorit Arens Çela, konkretisht vendimet e datave 11.12.2018 dhe 11.3.2019, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka zgjatur dy herë me nga tre muaj afatin e hetimeve, duke e lidhur atë me nevojën e kryerjes së

⁸⁰ Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për të kryer ose mos kryer një veprim të caktuar, për të fituar padrejtësisht pasuri ose çdo lloj përfitimi tjetër, për vete ose për të tretë, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet.

⁸¹ Afati i përfundimit të hetimeve është tre muaj nga data në të cilën emri i personit që i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njohimit të veprave penale dhe gjashtë muaj për veprat penale të parashikuara nga geramat “a” dhe “b” të nenit 75/a të këtij kodi.

⁸² “1. Prokurori mund ta zgjasë afatin e hetimeve për një kohë deri në tre muaj... 2. Zgjatje të mëtejshme, secila për një kohë jo më shumë se tre muaj, mund të bëhen nga prokurori në rastet e hetimeve komplekse ose të pamundësisë objektive për t'i përfunduar ato brenda afatit të zgjatur ...”.

hetimeve të mëtejshme, pa përcaktuar konkretisht se cilat janë veprimet hetimore konkrete që do të kryhen.

Në përfundim të verifikimeve shtesë, me njoftimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të japë sqarime: (i) mbi veprimet hetimore konkrete të kryera prej tij në lidhje me këtë procedim penal, duke vërtetuar me dokumente nga dosja penale këto veprime; (ii) mbi zgjatjen e afatit të hetimeve në dy raste, duke argumentuar zgjatjen në raport me përcaktimet e nenit 324 të Kodit të Procedurës Penale; (iii) mbi mungesat e akteve në dosjen e procedimit penal si: kërkesë për pushimin e çështjes së datës 2.7.2019; vendimi nr. *** akti, datë 28.5.2019, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, duke vënë në dispozicion këto akte shkresore, si dhe çdo dokument tjetër në funksion të vërtetimit të pretendimeve të tij.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

Së pari, në parashtrimet e tij të datës 24.2.2021, në lidhje me veprimet hetimore konkrete të kryera, subjekti ka sqaruar se pas marrjes së çështjes prej tij në datën 28.9.2018, kishte pasur një vendim për zgjatjen e afatit të hetimeve deri në datën 11.12.2018, nga prokurori i mëparshëm. Duke qenë se deri në këtë datë ende nuk ishte dorëzuar këqyrja dhe analizimi i të dhënave të përfituara nga akti i ekspertimit telefonik, po në këtë datë, ka vendosur zgjatjen e hetimeve deri më 11.3.2019 dhe brenda këtij afati më 31.1.2019, është përpiluar procesverbali për këqyrjen e provave materiale dhe është këqyruar DVD-ja me të dhënat e telefonave celularë.

Më tej, lidhur me pyetjen e shtetas F. V., lënë detyrë nga gjykata, subjekti pretendon se ka bërë të gjitha përpjekjet për ta gjetur dhe pyetur këtë shtetase, por kjo nuk është mundur, pasi prej kohësh ndodhej jashtë vendit, vërtetuar me disa dokumente shkresore. Për t'i provuar gjykatës këtë fakt, bashkëngjitur kërkesës së datës 2.7.2019, subjekti deklaroi se i ka paraqitur disa akte procedurale⁸³, bazuar në të cilat gjykata e gjeti të bazuar vendimmarrjen e tij. Për të vërtetuar këto pretendime, subjekti ka paraqitur si prova dokumentacionin si vijon:

- vendimin nr. ***, datë 28. 5.2019, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda;
- kërkesën për pushimin e procedimit penal të datës 1.7.2019;
- procesverbalin për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve nga sistemi *TIMS* nga OPGj B. F., në lidhje me shtetasen F. K.;
- raportin e shërbimit, datës 13.6.2019, të OPGj-së A. M., në lidhje me kontaktimin në terren dhe kontrollin e sistemit *TIMS* të shtetas F. V..

Nga sqarimet e subjektit të rivlerësimit dhe dokumentet e paraqitura prej tij, në lidhje me veprimet hetimore konkrete të kryera konstatohet se: (i) pas caktimit të çështjes nga subjekti është administruar procesverbali për këqyrjen e provave materiale dhe është këqyruar DVD-ja me të dhënat e telefonave celularë nga oficeri i policisë gjyqësore; (ii) ka bërë përpjekje për gjetjen dhe pyetjen e kallëzueses, nëpërmjet këqyrjes dhe marrjes së dokumenteve nga sistemi *TIMS*, si dhe verifikimit në terren, duke i vërtetuar këto veprime me akte procedurale; (iii) ka parashtruar në kërkesën për pushimin e procedimit penal të gjitha veprimet hetimore të kryera nga prokurorët e mëparshëm të çështjes; (iv) në lidhje me moskryerjen e veprimit hetimor të pyetjes së kallëzueses, subjekti ka argumentuar se në bindjen e tij, kallëzimi i shtetas F. V., është konsideruar si deklarimi saj, si shtetase që ka dijeni për rrethanat e veprës penale, në ato raste që prokurori paraqet kërkesën për gjykim në gjykatë; (v) në vendimin nr. ***, datë

⁸³ Procesverbal i këqyrjes dhe marrjes së dokumenteve; këqyrje sistemi *TIMS*, datë 1.7.2019, i OPGj-së B. F.; raport shërbimi i datës 13.6.2019, i OPGj-së A. M., në lidhje me kontaktimin në terren dhe kontrollin e sistemit *TIMS* të shtetas F. V.; Më tej, ka sqaruar se mbi bazën e këtyre akteve procedurale, gjykata e ka gjetur të drejtë vendimmarrjen e prokurorit për pushimin e procedimit penal nr. ***.

28.5.2019, të Gjykatës së Krimeve të Rënda ishte lënë si detyrë, përveç pyetjes si deklaruese të shtetases F. V., edhe kryerja e veprimeve të tjera hetimore që do të vlerësoheshin nga prokurori në varësi të nevojave që do të lindnin pas pyetjes së kësaj shtetase, por duke qenë se prokurori provoi përpara gjykatës mungesën e saj, nuk janë kryer veprime të mëtejshme hetimore; (vi) me vendimin nr. ***, datë 11.9.2019, të Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit për pushimin e çështjes penale.

Nga të gjitha sa më sipër, nga Komisioni u konstatua se pavarësisht se pjesa më e madhe e veprimeve hetimore ishin kryer nga prokurorët e mëparshëm, disa prej tyre u përfunduan në periudhën që çështja iu caktua subjektit të rivlerësimit. Ndërkohë, vërehet që subjekti ka zbatuar detyrat e lëna nga gjykata në vendimin e saj, lidhur me veprimet hetimore.

Së dyti, në parashtrimet e tij të datës 24.2.2021, në lidhje me zgjatjen e afatit të hetimeve, subjekti ka parashtruar si vijon:

- Për sa i takon zgjatjes së afatit me vendimin e datës 11.12.2018, subjekti ka sqaruar se kjo zgjatje është bërë pasi akoma oficeri i policisë gjyqësore, nuk kishte dorëzuar këqyrjen dhe analizimin e të dhënave të përfuara nga aktekspertimi i telefonave celular të sekuestruar. Procesverbali për këqyrjen e provave materiale, është përpiluar prej tij në datën 31.1.2019, kur është këqyru DVD-ja me të dhënat e telefonave celularë nga oficeri i policisë gjyqësore, z. E. Ç.. Komisioni vlerësoi se subjekti argumentoi dhe provoi bindshëm se zgjatja ka ndodhur për shkaqe të arsyeshme dhe legjitime, pasi deri në atë fazë nuk ishte administruar një provë e rëndësishme e hetimit, siç ishte këqyrja e DVD-së me të dhënat e telefonave celularë.

- Për sa i takon zgjatjes së afatit të hetimeve me vendimin e datës 11.3.2019, subjekti ka sqaruar se kjo zgjatje është bërë pasi pavarësisht se pas datës 31.1.2019 janë administruar aktet e përfuara nga këqyrja, ato kanë pasur nevojë për një analizim shumë të hollësishëm për të interpretuar çdo komunikim dhe për të përfutur elementin që mungonte te figura e kësaj vepe penale. Po kështu, sipas tij, kjo kohë ka shërbyer edhe për të përpiluar aktet dhe përgatitur fashikullin për kërkesën për pushim, ndërkohë që afati i përcaktuar në zgjatje nuk është konsumuar, pasi kërkesa për pushimin e procedimit është depozituar në gjykatë, brenda marsit të vitit 2019. Pretendimet e subjektit vlerësohen jo tërësisht bindëse në raport me përcaktimet e nenit 324 të Kodit të Procedurës Penale, cili kushtëzon zgjatjet e mëtejshme në rastet e hetimeve komplekse ose pamundësisë objektive për t'i përfunduar ato brenda afatit të zgjatur. Megjithatë, në përfundim të vlerësimit të kësaj çështjeje, Komisioni çmoi se nuk ndodhemi përpara një gabimi thelbësor, serioz dhe të përsëritur, në mënyrë të tillë që shtyrja e afateve të hetimit të bëhet një model pune për subjektin e rivlerësimit dhe, për pasojë, problematika e evidentuar e kësaj natyre, e cila i përket një rasti të vetëm, nuk mund të bëhet shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

Së treti, në lidhje me mungesat e akteve në dosjen e procedimit penal, subjekti ka paraqitur: (i) kërkesën për pushimin e çështjes së datës 1.7.2019; dhe (ii) vendimin nr. **** akti, datë 28.5.2019, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ndërkohë që nuk ka dhënë sqarime për mungesën e tyre.

Së katërti, në lidhje me pretendimin e denoncuesit se çështja është pushuar nga prokurori Arens Çela, pas verifikimeve të kryera, përkundër sa pretendohet prej denoncuesit, me ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale me ligjin nr. 35/2017, vendimin për pushimin e çështjes e merr gjykata dhe jo më prokurori. Në rastin konkret, nga analiza e akteve të dosjes penale, konstatohet se çështja është kërkuar të pushohet nga prokurori Arens Çela dhe kërkesa e tij është pranuar nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda me vendimin nr. ***, datë 11.9.2019.

Gjithashtu, përkundër sa pretendohet prej denoncuesit se çështja është pushuar prej prokurorit Arens Cela, pavarësisht se kishte rezultuar e provuar se viktimat e veprës F. K. ka dhënë shuma

parash ndaj të proceduarit, nga përmbajtja e kërkesës për pushimin e çështjes të prokurorit Arens Çela, konstatohet se është parashtruar: *“Megjithëse provohet se midis kallëzueses dhe personit nën hetim ka patur një komunikim i cili ka vazhduar dhe me dorëzimin e një shume të hollash në interes të personit nën hetim, nuk provohet elementi i anës objektive i domosdoshëm për këtë veprë penale, pra shtrëngimi ose kanosja”*. Pra, siç vërehet nga prokurori është evidentuar fakti i dorëzimit të shumës në interes të personit nën hetim prej të dëmtuarës Florida Kostreni, por gjatë hetimit nuk është provuar elementi i anës objektive të veprës penale që është shtrëngimi ose kanosja. Ndërkohë që vlerësimi mbi mungesën ose jo të anës objektive të veprës penale i përket bindjes së brendshme të prokurorit dhe del jashtë tagrit të organit të rivlerësimit, i cili nuk mund të zëvendësojë interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet sipas nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

4.1.2 Në lidhje me procedimin penal nr. *, në emër të shtetasit Q. V., nga aktet e dosjes së këtij procedimi penal u konstatua se:**

- me urdhrin për regjistrimin e procedimit penal të datës 7.8.2017, prokurori Arens Çela, ka regjistruar procedimin penal nr. ***, për veprën penale *“korrupsion aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”* dhe *“korrupsion pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendor”*, si dhe ka regjistruar emrat e shtetasve B. N. dhe Q. V.;
- me autorizimin e datës 7.8.2017, prokurori ka autorizuar regjistrimin e fshehtë fotografik, filmik ose me video të shtetasve B. N. dhe Q. V. në vende publike për një afat 7-ditor;
- me kërkesën e datës 29.8.2017, prokurori ka kërkuar zgjatjen e përgjimit të komunikimeve ambientale të shtetasve B. N. dhe Q. V., miratuar me vendimin nr. ***, datë 30.8.2017, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda;
- me urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore të datës 5.9.2017, prokurori Arens Çela, ka urdhëruar kryerjen e veprimeve hetimore si vijojnë: të kryhej këqyrja e materialeve të përfituara nga vëzhgimi në vende publike i personave nën hetim, si dhe të personave të tjerë me të cilët dyshohet se mban kontakte apo transmeton komunikime, në zbatim të autorizimit përkatës të prokurorit; të identifikohen personat që rezultojnë që mund të jenë favorizuar nga personat nën hetim, gjatë procedurave të konkurrimit; të administrohet dokumentacioni pranë DPSHTRr-së, në lidhje me praktikat e personave të dyshuar që mund të kenë përfituar pa të drejtë në konkurrimin për marrjen e dëshmisë së drejtimit të mjetit; të kryhen verifikime të mëtejshme duke ruajtur sekretin hetimor, me qëllim dokumentimin e plotë të veprës penale; të kryhet çdo veprim tjetër hetimor që do të jetë i nevojshëm për rrethanat e hetimit, në varësi të nevojave të hetimit, pasi të jetë analizuar paraprakisht me prokurorin; dhe këto veprime të kryhen brenda datës 5.11.2017;
- me kërkesën e datës 6.9.2017, prokurori Arens Çela ka kërkuar vendosjen në përgjim të komunikimeve telefonike të numrave celularë në përdorim të shtetasve B. N. dhe Q. V., pranuar me vendimin nr. ***, datë 7.9.2017, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda;
- me shkresat e datave 12.9.2017 dhe 21.9.2017, janë kërkuar nga kompanitë celulare “***” sh.a. dhe “***” sh.a. të dhëna mbi praktikat e regjistrimit dhe komunikimet e numrave celularë;
- me vendimin e datës 4.10.2017, prokurori Arens Çela ka vendosur këqyrjen dhe marrjen në selinë e DRSHTRr-së Tiranë, të praktikave të testimi teorik për pajisje me lejdrejtimi, që kanë rëndësi për hetimin;
- me vendimin për zgjatjen e afatit të hetimit të datës 7.11.2017, prokurori Arens Çela ka vendosur zgjatjen e afatit të hetimit deri në datën 7.2.2017, pasi sipas tij del e nevojshme identifikimi dhe pyetja e personave që kanë aplikuar, si dhe personave të tjerë që mund të kenë dijeni për faktet;

- në datën 4.1.2018, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin, janë kërkuar të dhëna për shtetasin M. H.;

- në datat 8.1.2018 dhe 9.1.2018, janë pyetur shtetasit Q. V. dhe B. N., ndaj të cilëve zhvillohen hetimet;

- me vendimin për zgjatjen e afatit të hetimit të datës 7.2.2018, prokurori Arens Çela ka vendosur zgjatjen e afatit të hetimit deri në datën 7.2.2018. Sipas tij, del e nevojshme identifikimi dhe pyetja e personave që kanë aplikuar, si dhe personave të tjerë që mund të kenë dijeni për faktet. Për shkaqe objektive nuk është bërë e mundur gjetja dhe pyetja e shtetasit M. H., pasi nuk është gjendur nga ana e shërbimeve të policisë gjyqësore. Po kështu, ka dalë e nevojshme pyetja e disa shtetasve të tjerë punonjës të Drejtorisë së Shërbimit të Transportit Rrugor;

- në datën 27.2.2018, janë pyetur në cilësinë e personave që kanë dijeni për veprën shtetasit Xh. D. dhe N. M.;

- me kërkesën e datës 17.4.2018, prokurori Arens Çela ka kërkuar pushimin e procedimit penal nr. ***, regjistruar për veprën penale të parashikuar nga nenet 245 dhe 260 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasve B. N. dhe Q. V., me arsyetimin se nga hetimi i këtij procedimi penal nuk rezultoi asnjë provë e cila të çonte në përfundimin se kemi të bëjmë me veprën penale “korrupsion aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë” dhe “korrupsion pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë”, si dhe asgjësimin e procesverbaleve të përgjimit të realizuara për llogari të këtij procedimi penal;

- Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 10.5.2018, ka vlerësuar se kërkesa e prokurorit është e bazuar dhe ka vendosur pranimin e kërkesës për pushimin e çështjes, si dhe asgjësimin e procesverbaleve të përgjimit të realizuara për llogari të këtij procedimi.

Në përfundim të hetimit administrativ shtesë, pavarësisht se nga Komisioni nuk u konstatuan problematika dhe mangësi në veprimet hetimore të kryera, me njoftimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkuar të japë sqarime në lidhje me pretendimet e denoncuesit, për moskryerje të veprimeve të plota hetimore lidhur me këtë çështje.

Në parashtrimet e tij të datës 24.2.2021, pas njohjes me pretendimet e denoncuesit, subjekti ka deklaruar se nuk konstaton asnjë mangësi në kryerjen e veprimeve procedurale dhe, për më tepër, vendimmarrja e tij është mbështetur edhe nga gjykata.

4.2. Në datat 2 dhe 3 mars të vitit 2021, për subjektin e rivlerësimit Arens Çela, para dhe pas zhvillimit të seancës dëgjimore, u administruan katër denoncime nga publiku të dërguara elektronikisht në Komision. Pas administrimit të tyre, trupi gjykues vendosi të kryejë hetime të mëtejshme mbi pretendimet e një prej denoncimeve, të cilat lidheshin me çështjen tashmë të njohur gjerësisht dhe me ndjeshmëri të lartë publike, që i përket të ndjerit M. M..

Në këtë denoncim, në lidhje me subjektin e rivlerësimit Arens Çela, pretendohet se: “ ... ky prokuror ka ndjekur çështjen e të ndjerit M. M.. Familjarët e tij kanë bërë dhjetëra denoncime ndaj këtij prokurori të korruptuar dhe me një sjellje të rëndë jo etike dhe jo profesionale. Ky prokuror ka marrë disa qindra mijëra euro për të lehtësuar pozitën e vrasësve të M. M.. Ai ka cenuar besimin e publikut dhe nuk e meriton të jetë më prokuror... ”.

Pas riceljes së hetimit administrativ, nga verifikimet e kryera, në lidhje me pretendimin për veprime korruptive dhe sjellje të rënda etike dhe jo profesionale, si dhe pretendimin se ndaj prokurorit Arens Çela ka pasur dhjetëra denoncime nga familjarët e të ndjerit M. M., u konstatua se denoncuesi nuk ka paraqitur prova për të mbështetur këto pretendime.

Ndërkohë, për sa i takon çështjesh penale të të ndjerit M. M., nga Komisioni u kërkuan të dhëna në lidhje me: (i) çështjen penale për vrasjen e këtij shtetasi; si dhe (ii) çdo çështje penale të trajtuar nga prokurori Arens Çela, që ka lidhje me këtë vrasje. Në përgjigje të kësaj kërkesë SPAK⁸⁴ vuri në dispozicion të Komisionit, tre fashikujt e vendimit të mosfillimit të procedimit të prokurorit Arens Çela, mbi bazën e kallëzimit penal nr. ***, ndaj shtetasve S. P., B. Q., A. L. dhe K. Zh., pjesë e të cilëve është dhe dosja penale nr. ***, e vitit 2017, që i përket të pandehurve D. B., E. B., K. A. dhe M. A..

Nga verifikimi dhe shqyrtimi i akteve të vëna në dispozicion nga SPAK, u konstatua si vijon:

- nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të ketë qenë prokuror i çështjes penale që i përket procedimit penal nr. ***, në ngarkim të shtetasit D. B., i akuzuar për veprën penale “vrasje me paramendim”, si dhe as të ketë kryer veprime hetimore në lidhje me këtë çështje.

- Në datën 28.5.2018, është regjistruar në Prokurorinë e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, kallëzimi penal i kallëzuesit P. M., kundër shtetasve A. L., etj., për veprën penale të “*korupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë*”, çështje e cila i ka kaluar për hetim subjektit të rivlerësimit Arens Çela, i cili me urdhrin e datës 31.5.2018 ka urdhëruar kryerjen e veprimeve verifikuese.

- Nga përmbajtja e materialit kallëzues, vërehet që edhe pse kallëzimi është për veprën penale “*korupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë*”, nga kallëzuesi janë ngritur disa pretendime të tjera që kanë lidhje me shkelje të ligjit nga ana e të kallëzuarve gjatë ushtrimit të detyrës dhe më konkretisht në vijim.

a. Në lidhje me prokurorin e çështjes A. L., kallëzuesi pretendon se: (i) ka lënë të lire tre nga katër të pandehurit; (ii) gjatë 8 muajve nuk e ka thirrur atë (kallëzuesin) për ta dëgjuar në lidhje me ngjarjen makabre dhe nuk i ka kthyer përgjigje memove të dërguara; (iii) në këmbim të shumave të parave liroi 3 kriminelë me akuzën “moskallëzim i krimit” duke ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale; (iv) është shprehur me arrogancë “*kam gabuar*” dhe “*ju shkoni ku të doni*”; (v) në mënyrë të fshehtë takohej me baballarët e kriminelëve dhe avokatin e tyre I. M.; si dhe (vi) zvarritje të qëllimshme të procesit për 8 muaj.

b. Në lidhje me gjyqtarët B. Q. dhe S. P., kallëzuesi ka pretenduar se: (i) kanë marrë ryshfet në bashkëpunim me prokurorin dhe në këmbim kanë liruar 3 nga personat nën hetim për vrasjen e djalit; (ii) kanë shkelur afatet kohore, si dhe nenin 58 të Kodit të Procedurës Penale duke mos lajmëruar palën e dëmtuar.

c. Në lidhje me oficerin e Policisë Gjyqësore K. Zh., kallëzuesi ka pretenduar se kundrejt ryshfetit dhe në bashkëpunim me tre të parët ka ndryshuar procesverbalet që në polici. Po kështu, ka pretenduar se ka dyshime në lidhje me kohën e marrjes së deklarimeve në burgun e Fushë-Krujës në datën 31.10.2017, pasi është e pamundur që në një kohë aq të shkurtër të merret një deklaram prej disa faqesh.

ç. Sipas kallëzimit, ai shoqërohet me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm duke përfshirë videon dhe faktet kundër njerëzve të veshur me pushtet që abuzojnë dukshëm dhe në mënyrë korruptive.

- Me urdhrin për kryerjen e veprimeve verifikuese të datës 31.5.2018, prokurori Arens Çela, për nevoja të verifikimit të këtij materiali, ka vlerësuar kryerjen e veprimeve verifikuese si vijojnë: (i) të pyetet kallëzuesi hollësisht për faktet objekt kallëzimi, si dhe nëse disponon prova apo të dhëna që provojnë pretendimet për veprën penale të parashikuar nga neni 319/ç të Kodit Penal; (ii) të administrohen akte të nevojshme nga fashikulli hetimor i procedimit penal objekt

⁸⁴ Shihni shkresë kthim përgjigje nr. *** prot, datë 4.3.2021, nga SPAK, në dosjen e Komisionit.

kallëzimi; (iii) të kryhen veprime të tjera që dalin të nevojshme nga verifikimi; si dhe (iv) veprimet të kryhen brenda datës 12.6.2018, nga OPGj-ja F. M..

-Mbi bazën e urdhrin të sipërpërmendur, janë kryer veprimet hetimore si vijojnë:

a. Në datën 6.6.2018, është pyetur kallëzuesi P. M., i cili në një procesverbal prej tri faqesh, është shprehur në mënyrë të hollësishme në lidhje me pretendimet e tij në kallëzimin penal, duke deklaruar midis të tjerash se: “... *dua të deklaroj se personat e përmendur në deklarin tim janë që të gjithë njohës shumë të mirë të ligjit dhe është e pamundur që veprimet e tyre në kundërshtim me ligjin të jenë pakujdesi apo mos dije. Në këto kushte më lind e drejta të kem dyshime të bazuara në vendimet e papërgjegjshme të këtyre gjyqtarëve, që duke marrë vendime në kundërshtim total dhe të hapur me ligjet e shtetit kanë liruar personat përgjegjës të vrasjes së djalit tim të pafajshëm. Ndaj kërkoj që personat përgjegjës të hetohen për shkeljet e tyre dhe të vihen përpara përgjegjësisë ligjore ...”.*

b. Po në datën 6.8.2018, janë administruar provat e depozituara nga shtetasi P. M..

c. Në datën 12.6.2018, është administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dosja e procedimit penal nr. ***, në ngarkim të shtetasit D. B., i akuzuar për veprën penale “vrasje me paramendim”.

ç. Në datën 12.6.2018, OPGj-ja F. M., sugjeron mosfillimin e procedimit penal.

d. Me vendimin “Për mosfillimin e procedimit penal” të datës 13.6.2018, prokurori Arens Çela vendosi: “... *të mosfillojë procedimin penal për materialin referues nr. ***, të vitit 2018; dhe njoftimin e personave të interesuar, për të cilin nuk është bërë ankim”.*

Në lidhje me vlerësimin e pretendimeve të kallëzuesit, në vendimin e mosfillimit, nga prokurorit Arens Çela, është vlerësuar se nuk përmbajnë elementët e domosdoshëm për fillimin e procedimit penal, duke arsyetuar se: “... *pretendimet e kallëzuesit në këtë rast lidhen me përgjegjësinë e mundshme disiplinore të prokurorit. Pretendimet në lidhje me mënyrën e marrjes së provave, pranimit të kërkesave procedurale të paraqitura me memo nga avokatja e trashëgimtarit ligjor të viktimës, në çdo rast bëhen objekt i kontrollit gjyqësor në gjykatën kompetente. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, nuk ka juridiksion dhe kompetencë që të verifikojë dhe kontrollojë vendimmarrjen konkrete të prokurorit për një çështje penale konkrete, me qëllim për të përcaktuar nëse vendimmarrja ka qenë ose jo e drejtë dhe e bazuar në prova dhe në ligj. Këtë kompetencë sipas ligjit e ka gjykata, e cila kontrollon vendimmarrjen e prokurorit, dhe vlerëson nëse vendimmarrja është e drejtë dhe sipas rastit merr vendimet e nevojshme*

... në lidhje me pretendimin se nga ana e prokurorit, OPGj-së dhe gjyqtarëve të përmendur në kallëzim janë kryer veprime korruptive të cilat kanë çuar në vendimmarrje e cila ka qenë sipas kallëzuesit e pambështetur në prova dhe fakte, rezulton se këto pretendime kallëzuesi nuk i mbështet në ndonjë provë apo e dhënë tjetër e DPD. Këto bazohen në vlerësime personale dhe hipotetike nisur nga fakti që vendimmarrja e tyre cilësohet e gabuar nga ana ligjore.

Në mungesë të indiceve të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën, në mungesë të ndonjë burimi prove të vlefshme, që minimalisht të krijojë të dhëna të dobishme që tregojnë se janë konsumuar elementët e veprës penale, organi procedues çmon se nuk janë kushtet për të regjistruar procedimin penal, pasi sipas Kodit të Procedurës Penale, kërkohet ekzistenca e të dhënave të mjaftueshme se janë konsumuar elementët e veprave penale që pretendon në kallëzimin penal. Si përfundim, ndjekja penale nuk mund të fillojë pasi faktet e përmendura në kallëzim nuk përmbajnë elementët e veprës penale të ‘korrupsioni i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë’.

Nga analiza e të gjitha akteve në dosjen e vënë në dispozicion dhe fakteve të rezultuara gjatë hetimit administrativ shtesë nga Komisioni u konstatua se:

4.2.1. Hetimet në lidhje me çështjen penale që i përket këtij kallëzimi kanë filluar në datën 28.5.2018, datë kur është regjistruar kallëzimi penal dhe me vendimin e datës 13.6.2018, subjekti ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, për materialin referues nr. ***, të vitit 2018, sipas nenit 290/1 germa “ç”, në limit të afatit 15-ditor nga data e regjistrimit të kallëzimit më 28.5.2018, sipas pikës 1, të nenit 291, të Kodit të Procedurës Penale. Pavarësisht se hetimet kanë përfunduar brenda afatit ligjor, nisur nga të gjitha rrethanat e çështjes, kompleksiteti dhe ndikimi që kjo çështje ka pasur në publik, faktit që të akuzuar kanë qenë katër shtetas të kallëzuar – pjesë përbërëse e organeve të sistemit të drejtësisë, si dhe referuar vetë detyrave që subjekti kishte caktuar në urdhrin për fillimin e hetimeve, duket se hetimet janë kryer në një kohë shumë të shkurtër nga subjekti i rivlerësimit.

4.2.2. Me urdhrin për kryerjen e veprimeve verifikuese të datës 31.5.2018, prokurori Arens Çela, për nevoja të verifikimit të materialit kallëzues, ka vlerësuar kryerjen e disa veprimeve nga verifikimi i të cilave, rezulton se:

i) Për sa i takon urdhërimit për pyetjen e kallëzuesit, është kryer pyetja e kallëzuesit P. M. në datën 6.6.2018.

ii) Për sa i takon urdhërimit të *administrohen akte të nevojshme nga fashikulli hetimor i procedimit penal objekt kallëzimi*, në datën 12.6.2018, rezulton se është administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kopja e procedimit penal nr. ***, në ngarkim të shtetasit D. B., i akuzuar për veprën penale “vrasje me paramendim”. Ndërkohë, po në datën 12.6.2018, me opinion të OPGj-së F. M., drejtuar prokurorit Arens Çela, sugjerohet mosfillimi procedimit penal dhe, në vijim, me vendimin “për mosfillimin e procedimit penal” të datës 13.6.2018, prokurori Arens Çela vendosi të mosfillojë procedimin penal për materialin referues nr. ***, të vitit 2018. Siç vërehet, administrimi i dosjes penale voluminoze të procedimit penal brenda të njëjtës ditë që OPGj-ja ka përfunduar hetimet dhe një ditë më parë se subjekti të ketë marrë vendimin e mosfillimit, duket të jetë një veprim formal dhe jo në funksion të kryerjes së hetimeve, për më tepër, në kushtet kur nuk është kryer asnjë veprim hetimor në lidhje me fakte të evidentuara nga verifikimi i dosjes, ashtu sikurse ishte përcaktuar në urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore nga subjekti i rivlerësimit.

iii) Për sa i takon urdhërimit të *kryhen veprime të tjera që dalin të nevojshme nga verifikimi*, nuk rezulton që prokurori Arens Çela, të ketë kryer veprime të tjera që kanë qenë të nevojshme dhe as të ketë verifikuar aktet e dosjes voluminoze të administruar në ditën që nga OPGj-ja u sugjerua mbyllja e hetimeve. Ndërkohë që nga materiali kallëzues dhe provat e vëna në dispozicion prej kallëzuesit, duket se ka qenë e domosdoshme kryerja e disa veprimeve hetimore për shkak se përveç akuzës për korrupsion, shtetasi P. M. ka ngritur pretendime edhe për veprime në kundërshtim me ligjin nga personat që ka kallëzuar, duke i konkretizuar këto pretendime me akuza konkrete (përmendur specifikash në pikën 1 më sipër). Nga ana tjetër, subjekti, në vendimin e tij, arsyeton se *organi procedues çmon se nuk janë kushtet për të regjistruar procedimin penal, pasi sipas Kodit të Procedurës Penale, kërkohet ekzistenca e të dhënave të mjaftueshme se janë konsumuar elementët e veprave penale që pretendon në kallëzimin penal*, ndërkohë që nuk është kryer asnjë hetim në lidhje me elemente të veprave penale të tjera të mundshme nga ana e të akuzuarve.

Sipas nenit 304 të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon se prokurori *kryen hetime edhe për verifikimin e fakteve ose rrethanave në favor të personit ndaj të cilit zhvillohen hetime*, hetime që prokurori Arens Çela nuk rezulton t’i ketë kryer, duke arsyetuar se pretendimet e kallëzuesit në këtë rast lidhen me përgjegjësinë e mundshme disiplinore të prokurorit dhe se në çdo rast këto pretendime bëhen objekt i kontrollit gjyqësor në gjykatën kompetente dhe se

prokuroria nuk ka juridiksion dhe kompetencë që të verifikojë dhe të kontrollojë vendimmarrjen konkrete të prokurorit, pasi këtë kompetencë sipas ligjit e ka gjykata. Në rastin konkret, pretendimet e kallëzuesit nuk kanë pasur lidhje vetëm me vendimmarrjen e të kallëzuarve, por edhe me veprime/mosveprime që bien ndesh me ligjin, pretendime të cilat së bashku me dokumentet shkresore të vëna në dispozicion, duket se subjekti i rivlerësimit nuk i ka marrë në konsideratë gjatë hetimit, pasi nuk rezulton të ketë kryer asnjë veprim verifikues në lidhje me to dhe konkretisht si vijon.

a. Subjekti i rivlerësimit duket se nuk ka kryer veprime hetimore në lidhje me pretendimet për prokurorin e çështjes A. L., sipas të cilit gjatë 8 muajve nuk e ka thirrur kallëzuesin për ta dëgjuar në lidhje me ngjarjen makabre, nuk i ka kthyer përgjigje memove të dërguara, si dhe e akuzon për zvarritje të qëllimshme të procesit. Po kështu, nuk është kryer asnjë hetim në lidhje me pretendimin se ky prokuror në mënyrë të fshehtë takohej me baballarët e kriminelëve dhe avokatin I. M., për kërkime informacioni pranë organeve ligjzbatuese apo verifikime të tjera që do të hidhnin dritë mbi pretendimet e kallëzuesit.

b. Subjekti i rivlerësimit duket se nuk ka kryer veprime hetimore në lidhje me pretendimet për gjyqtarët B. Q. dhe S. P., që sipas kallëzuesit kanë shkelur afatet kohore, si dhe nenin 58 të Kodit të Procedurës Penale, duke mos lajmëruar palën e dëmtuar.

c. Subjekti i rivlerësimit duket se nuk ka kryer veprime hetimore në lidhje me ekzistencën e një videoje me e fakte kundër njerëzve të veshur me pushtet që abuzojnë dukshëm dhe në mënyrë korruptive.

ç. Subjekti i rivlerësimit duket se nuk ka kryer veprime hetimore në lidhje me pretendimet për oficerin e Policisë Gjyqësore K. Zh., i cili sipas kallëzuesit ka ndryshuar procesverbalet që në polici. Nga aktet në dosje u evidentua se dy procesverbalet e marrjes së deklaramit nga oficeri i Policisë Gjyqësore K. Zh. në datën 31.10.2017, të shtetasve D. B. dhe E. B., janë mbajtur me shkrim dore me dy shkrime të ndryshme. Subjekti i rivlerësimit në rolin e prokurorit nuk e ka evidentuar këtë fakt dhe nuk rezulton të ketë kryer ndonjë veprim hetimor në lidhje me të.

d. Subjekti i rivlerësimit duket se nuk ka kryer veprime hetimore në lidhje me pretendime për veprime korruptive të të kallëzuarve, për të cilat mund të kërkonte nëse ka informacione në lidhje me këto fakte nga organet ligjzbatuese, duke u mjaftuar vetëm me mungesën e provave të paraqitura nga kallëzuesi.

Vetëm pas kryerjes së veprimeve të plota hetimore, sidomos në kushtet kur çështja në fjalë ka qenë tepër e ndjeshme për opinionin publik dhe në kuadër të një vlerësimi objektiv dhe tërësor të provave, subjekti i rivlerësimit mund të merrte vendimin e mosfillimit për sa i takon çështjes penale që i përket kallëzimit penal të shtetasit P. M., për akuzën e korrupsionit pasiv, si dhe mund të kishte regjistruar procedimin penal dhe pushimin e hetimeve për pretendime të tjera të kallëzuesit.

e. Në datën 13.6.2018, subjekti i rivlerësimit ka marrë vendimin për mosfillimin e çështjes penale, vendim i cili nuk është ankimuar prej kallëzuesit P. M.. Pavarësisht këtij fakti, mosankimi i një vendimi, nuk i ndalon organet e rivlerësimit të verifikojnë kryerjen e procedurave ligjore nga subjektet e rivlerësimit.

Në përfundim të hetimit administrativ, me njoftimin e rezultateve shtesë të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të japë sqarime mbi konstatimin e Komisionit, pasi duket se referuar tërësisë së materialit kallëzues dhe detyrave që ka caktuar në urdhrin për fillimin e hetimeve, subjekti nuk ka kryer veprime hetimore të plota, të cilat do t'i jepnin mundësinë për të marrë një vendim sa më të drejtë dhe të bazuar.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

Në parashtrimet e tij të datës 11.3.2021, subjekti ka sqaruar si vijon:

- Në lidhje me konstatimin se “hetimet janë kryer në një kohë shumë të shkurtër”, subjekti ka sqaruar se prej tij nuk janë kryer hetime në lidhje me këtë material kallëzues, por është urdhëruar kryerja e veprimeve verifikuese, të cilat në bazë të ligjit procedural duhet të kryhen brenda afatit maksimal prej 15 ditësh. Sipas tij, mosfillimi, si vendim procedural mund të merret në çdo kohë, brenda segmentit kohor, nga data e regjistrimit të kallëzimit penal deri në ditën e 15-të. Pra, mosfillimi mund të vendoset edhe në të njëjtën ditë, që është regjistruar kallëzimi, kur është rasti, që konstatohet haptazi, që nuk bazohet në prova dhe fakte. Më tej, ka sqaruar se në rastin konkret ka shfrytëzuar afatin maksimal që ligji i lejonte si prokuror për të kryer verifikime, ndër të cilat edhe pyetja e hollësishme e kallëzuesve (bashkëshortëve M.), për të identifikuar çdo burim prove, nga mund të rridhnin të dhënat për korrupsion të funksionarëve të drejtësisë, që pretendoheshin në kallëzim, si dhe ka deklaruar se angazhimi i tij ka qenë i plotë me veprime verifikuese shteruese në lidhje me këtë kallëzim penal.

- Në lidhje me konstatimin se “administrimi i dosjes penale voluminoze të procedimit penal brenda të njëjtës ditë që OPGj-ja ka përfunduar hetimet dhe një dite më parë se subjekti të ketë marrë vendimin e mosfillimit, duket të jetë një veprim formal dhe jo në funksion të kryerjes së hetimeve”, subjekti ka sqaruar se në rastin konkret marrja e fashikullit të hetimit, nuk është bërë për të analizuar elementet e veprës penale “vrasje”, objekt hetimi dhe në asnjë rast për të dubluar punën e një organi tjetër sovran në detyrën e tij procedurale, por aktet merren për të vlerësuar kallëzimin në tërësinë e tij, si dhe për të kryer verifikime, në lidhje me subjektin e veprës penale.

- Në lidhje me konstatimin për kryerjen e veprimeve të tjera që dalin të nevojshme nga verifikimi, subjekti ka sqaruar se nuk rezulton të ketë dalë e nevojshme kryerja e veprimeve të tjera hetimore, pasi nga deklarimi i shtetasit P. M., nuk është referuar marrja e ndonjë prove dhe as është dhënë ndonjë burim apo nuk është referuar asnjë mundësi si burim për gjetjen e provave. Po kështu, sipas subjektit, bashkëlidhur kallëzimit nuk ka pasur asnjë material filmik, i cili të ketë pasur të dhëna në lidhje me faktin, pasi nëse do të ishte një material i tillë do të ishte vlerësuar. Në përfundim të gjithë verifikimeve, subjekti ka sqaruar se kallëzuesit janë ndërgjegjësuar për situatën juridike të kallëzimit të tyre, si dhe kanë qenë dakord që materiali të mosfillohej, duke pranuar që nuk mund të bënin ankim ndaj një vendimmarrje të tillë, pa pasur asnjë të dhënë mbi eventualitetin e ndodhjes së veprës penale të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal.

- Në lidhje me konstatimin se pretendimet e kallëzuesit nuk kanë pasur lidhje vetëm me vendimmarrjen e të kallëzuarve, por edhe me veprime/mosveprime që bien ndesh me ligjin, pretendime të cilat së bashku me dokumente shkresore të vëna në dispozicion, duket se subjekti i rivlerësimit nuk i ka marrë në konsideratë gjatë hetimit, pasi nuk rezulton të ketë kryer asnjë veprim verifikues në lidhje me to, subjekti ka sqaruar se këto kanë qenë pretendime në thelb të karakterit procedural që janë objekt i shqyrtimit gjyqësor nga gjykata që shqyrton çështjen në themel. Sipas tij, Kodi Penal përcakton të drejtën e palëve për t'u ankuar gjyqësish në gjykatën e hetimeve paraprake për të gjithë veprimtarinë e prokurorit, si gjatë hetimit, ashtu edhe në përfundim gjatë kërkesave paraprake, kur gjykohet një kërkesë për pushim ose gjykim. Më tej, subjekti ka sqaruar se objekti i verifikimeve të tij si prokuror i ngarkuar pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda, në këtë rast dhe raste të ngjashme, kufizohet te elementët e veprës penale të korrupsionit, vepër e cila kërkon kundërshtpërblimin e njëres prej subjekteve të përfshirë në një procedurë të caktuar, pra, funksionari publik të ketë vepruar duke kërkuar apo pranuar shpërblim. Ky element duhet të dali minimalisht me *indicie* logjike dhe jo me hamendësime, pasi në rast të kundërt, ndaj çdo funksionari publik të cilit i atribuohet një kallëzim i tillë, mund

të regjistruar një procedim penal dhe, për rrjedhojë, të cenoheshin të drejtat e tij ligjore nga procesi penal.

Në mbyllje të sqarimeve të tij duke i konsideruar këto pretendime si të pabazuara, qesharake, spekulative, tendencioze, aspak profesionale dhe dashakeqëse, subjekti i kërkon Komisionit të injorohet tërësisht përmbajtjen e tyre. Sipas tij, përmbajtja e-mail anonim është e tillë, që nuk mund të cenohet të drejtën e tij për një proces të drejtë ligjor, që përfshin dhe kohëzgjatjen e procesit brenda një kohe të arsyeshme.

Vlerësimi i Komisionit

Sqarimet e subjektit të rivlerësimit se prej tij është urdhëruar kryerja e veprimeve verifikuese, të cilat në bazë të ligjit procedural duhet të kryhen brenda afatit maksimal prej 15 ditësh, nga Komisioni vlerësohen bindëse, pasi referuar Kodit të Procedurës Penale, parashikohet: *“Kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e procedimit brenda 15 ditëve nga regjistrimi i kallëzimit. Vendimi u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim ose ankim, viktimës ose trashëgimtarëve të saj, të cilët kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit”*.

Gjithashtu, janë gjetur bindëse nga Komisioni edhe sqarimet e subjektit se në rastin konkret marrja e fashikullit të hetimit, nuk është bërë për të analizuar elementet e veprës penale “vrasje”, por për të vlerësuar kallëzimin në tërësinë e tij, si dhe për të kryer verifikime, në lidhje me veprën penale objekt kallëzimi. Po kështu, subjekti ka shpjeguar bindshëm se nga verifikimi i kryer, nuk doli e nevojshme kryerja e veprimeve të tjera hetimore, pasi nga deklarimi i shtetasit P. M., nuk është referuar marrja e ndonjë prove dhe as është dhënë ndonjë burim, si dhe nuk është referuar asnjë mundësi si burim për gjetjen e provave dhe, po kështu, bashkëlidhur kallëzimit, ashtu siç edhe nga hetimi administrativ i Komisionit rezultoi, nuk kishte pasur asnjë material filmik, i cili të ketë pasur të dhëna në lidhje me faktin.

Nga ana tjetër, për sa i takon konstatimit se subjekti nuk kishte kryer veprime verifikuese në lidhje me pretendimet e tjera të kallëzuesit, Komisioni vlerëson qëndrimin e mbajtur nga subjekti i rivlerësimit, i cili në vendimin e tij, nuk i ka anashkaluar pretendimet e tjera të kallëzuesit, duke arsyetuar se ato lidhen me përgjegjësinë e mundshme disiplinore të prokurorit dhe se në çdo rast, këto pretendime bëhen objekt i kontrollit gjyqësor në gjykatën kompetente.

Gjatë procesit të vendimmarrjes, bazuar në argumentet që subjekti paraqiti dhe të gjitha rrethanat e çështjes, Komisioni çmoi se vlerësimi i prokurorit në lidhje me vendimmarrjen për mosfillimin e procedimit penal, është një çështje që i përket themelit të çështjes dhe bindjes se brendshme të tij bazuar në prova. Në këto kushte, duke mbajtur në konsideratë pikën 4, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit: *“...vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të prokurorit pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet...”*, por edhe vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit⁸⁵, në të cilin orientohet që gjykimi apo vlerësimi mbi zgjidhjen e një çështjeje nuk mund të jetë një alternativë vlerësimi e përdorur prej organeve të rivlerësimit, për sa kohë që ky vendim lidhet me vlerësimin e çmimit e provave dhe mbështetet mbi bindjen e brendshme të

⁸⁵ Shihni vendim nr. 28, datë 23.10.2020, të KPA-së për subjektin Fuat Vjerdha, sipas të cilit: *“Kolegji çmon se gjykimi apo vlerësimi mbi zgjidhjen e një çështjeje gjyqësore nuk mund të jetë një alternativë vlerësimi e përdorur prej organeve të rivlerësimit, për sa kohë që ky lidhet me vlerësimin e çmimit e provave dhe mbështetet mbi bindjen e brendshme të magjistratit. Në rastin konkret, pikërisht vlerësimi i aftësive profesionale të magjistratit, duke gjykuar e vlerësuar logjikën apo bindjen e tij të brendshme të formuar si pjesë e vendimmarrjes në trupën gjyqësore përkatëse, duke arsyetuar mbi provat e të gjitha rrethanat e çështjes së gjykuar, del jashtë misionit dhe kompetencës ligjore të organeve të rivlerësimit, prandaj edhe Kolegji vlerëson se konkluzioni se subjekti ka dhënë një zgjidhje të gabuar, duke deklaruar pafajësinë e njërit prej të gjykuarve, është një konkluzion në tejkalim të kompetencës kushtetuese të organeve të rivlerësimit dhe, si i tillë, nuk mund të përdoret për të kryer vlerësimin e tij.”*

magjistratit, nga Komisioni vlerësohet se në rastin konkret nuk jemi përpara problematikave me natyrë procedurale, çka do të përbente shkak për cenimin e aftësive profesionale të subjektit. Për sa i takon veprimeve të tjera që subjekti mund të kryente lidhur me elemente të veprave të tjera të mundshme penale jashtë objektit të kallëzimit, Komisioni nuk mund të vlerësojë se cilat janë këto veprime. Për këtë arsye, çmtoi ta transferojë çështjen që i përket kallëzimit penal nr. 113/2018, pranë organit kompetent për inspektim të shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore sipas pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

5. Informacion i publikuar në media në faqen <https://www.reporter.al/kalvari-i-nje-gruaje-te-dhunuar-ne-kerkim-te-drejtjesise>, që i përkiste shtetas M. B., 51 vjeç, nënë e dy fëmijëve, e cila i mbijetoi me vështirësi goditjeve me levë në kokë të ish- bashkëshortit.

Sipas këtij informacioni, çështja e saj në sistemin e drejtësisë zgjati dy vjet, ku ndër të tjera ngrihen pretendime edhe për subjektin e rivlerësimit, z. Arens Çela, i cili gjatë shqyrtimit të çështjes në gjykatën e krimeve të rënda kishte kërkuar shpalljen fajtor të ish- bashkëshortit për veprën penale të dhunës në familje duke kërkuar dënimin e tij me 5 vjet burgim, ndërkohë që ajo pretendonte që bashkëshorti kishte kryer veprën penale “vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare” e mbetur në tentativë. Në përfundim të procesit Gjykata e Krimeve të Rënda e dënoi ish-bashkëshortin për veprën penale të “vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare” e mbetur në tentativë.

Gjatë hetimit administrativ, me qëllim verifikimin e këtij informacioni, Komisioni administroi nga Gjykata e Apelit Tiranë⁸⁶, dosjen e procedimit penal me të pandehur A. D., nga verifikimi i akteve të së cilës u konstatua se:

- në datën 18.7.2017, Prokuroria e Rrethit Krujë (prokurori F. B.), mbi bazën e materialit të referuar nga Komisariati i Policisë Krujë, ka regjistruar procedimin penal nr. ***, për veprën penale “dhunë në familje”, parashikuar nga neni 130/a/4 i Kodit Penal, në ngarkim të të pandehurit A. D., ku prokurori kërkonte caktimin e masës së sigurimit personal “arrest me burg”, për personin nën hetim A. D.;

- me vendimin nr. ***, datë 21.7.2017, Gjykata e Rrethit Gjirokastrë Krujë, vendosi ndaj personit nën hetim A. D., masën e sigurisë në mungesë “arrest në burg”⁸⁷;

- në datën 9.11.2017, Prokuroria e Rrethit Krujë (prokurori F. B.), vendosi bashkimin e procedimit penal nr. ***, me procedimin penal nr. ***, i regjistruar në datën 9.5.2017, duke qenë se bëhej fjalë për të njëjtat palë dhe të njëjtin objekt;

- në datën 22.11.2017, Prokuroria e Rrethit Krujë (prokurori F. B.) vendosi të shpallë moskompetencën lëndore të Prokurorisë së Rrethit Krujë, për hetimin e procedimit penal nr. ***, në ngarkim të personit nën hetim A. D., duke ia përcjellë procedimin penal nr. ***, Prokurorisë së Krimeve të Rënda, duke argumentuar se nga hetimet rezultoi e provuar se qëllimi i personit nën hetim A. D. nuk ka qenë plagosja por vrasja e viktimës M. D., duke konsumuar elementët e veprës penale “vrasje për shkak të cilësive familjare” e mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 79/c dhe 22 të Kodit Penal, vepër kjo që është në kompetencën e Prokurorisë për Krimeve të Rënda;

⁸⁶ Shihmi dosjet penale bashkëngjitur shkresës kthim përgjigje nr. *** prot., datë 2.9.2020, nga Gjykata e Apelit, në dosjen e Komisionit.

⁸⁷ Këta dy shtetas kishin bërë edhe më parë (maj 2015) kallëzime penale ndaj njëri-tjetrit për veprat penale të dhunës në familje dhe shtetasi A. D. ishte dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjirokastrë Krujë edhe në vitin 2016 për veprën penale të dhunës në familje me 4 muaj burgim dhe shtetasi M. B. ishte e pajisur edhe me urdhër mbrojtje.

- me vendimin nr. ***, datë 6.2.2018, Prokurori i Përgjithshëm vendosi të caktojë Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë si prokurori kompetente për vazhdimin e ushtrimit të ndjekjes penale të procedimit penal nr. ***.

- në datën 18.7.2018, Prokuroria e Rrethit Krujë (prokurori B. M. i cili kishte zëvendësuar prokurorin F. B.) i kërkoi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dërgimin në gjyq të çështjes nr. ***, të vitit 2017, me të pandehur A. D., i akuzuar për veprën penale “dhunë në familje”, parashikuar nga neni 130/a/4 i Kodit Penal;

- me vendimin nr. ***, datë 20.9.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë vendosi dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. ***, në ngarkim të të pandehurit A. D. për veprën penale “dhunë në familje”, parashikuar nga neni 130/a/4 i Kodit Penal;

- si konkluzion në përfundim të shqyrtimit gjyqësor Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë (prokurori B. M.), ka kërkuar deklarinin fajtor të të pandehurit A. D. dhe dënimin e tij për veprën penale “vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare” e mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 79/c-22 i Kodit Penal me 20 vjet burgim;

- me vendimin nr. ***, datë 26.2.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë ka vendosur shpalljen e moskompetencës lëndore dhe dërgimin e çështjes pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda;

- në diskutimet e tij përfundimtare përpara Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, prokurori Arenç Çela, ka kërkuar deklarinin fajtor të të pandehurit A. D., për veprën penale “dhunë në familje”, të parashikuar nga neni 130/a/4 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 5 vjet burgim;

- me vendimin nr. ***, datë 12.12.2019, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ka vendosur deklarinin fajtor të të pandehurit A. D. për veprën penale “vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare” e mbetur në tentativë, si dhe dënimin e tij me 22 vjet burgim. Në vendimin e saj gjykata vlerëson se: “...i pandehuri A. D. ka konsumuar të gjithë elementët e figurës së veprës penale ‘vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare’ mbetur në tentativë, të parashikuar nga neni 79/c,22 të Kodit Penal dhe jo ‘dhuna në familje’ të parashikuar nga neni 130/a/4 të Kodit Penal, siç prokurori kërkoi në diskutimin e tij përfundimtar”.

- ndaj këtij vendimi në datën 24.12.2019, ka paraqitur ankim i akuzuari A. D. dhe çështja i ka kaluar Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, e cila me vendimin nr. ***, datë 30.1.2020, vendosi moskompetencën lëndore dhe kalimin e çështjes Gjykatës së Apelit Tiranë, ku çështja e regjistruar në shkurt të vitit 2020, është në proces gjykimi.

Pas verifikimit të akteve të dosjes penale, për sa pretendohet nga znj. M. B., në lidhje me ndryshimin e kualifikimit ligjor të veprës penale nga prokurori Arenç Çela, u konstatua se qëndron, pasi prokurori në diskutimet e tij përfundimtare përpara Gjykatës së Krimeve të Rënda, ka kërkuar deklarinin fajtor të të pandehurit A. D. për veprën penale “dhunë në familje” të parashikuar nga neni 130/a/4 i Kodit Penal, si dhe dënimin e tij me 5 vjet heqje lirie, në ndryshim nga sa ishte kërkuar nga prokurori i Prokurorisë së Rrethit Krujës, deklarinin fajtor të të pandehurit A. D. dhe dënimin e tij për veprën penale “vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare” të mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 79/c-22 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 20 vjet burgim.

Në lidhje me bazën ligjore të këtij veprimi, referuar nenit 372 të Kodit të Procedurës Penale, vërehet se është në tagrin e prokurorit të procedojë me ndryshimin e akuzës dhe ngritjen e akuzës përkatëse, në rast se gjatë shqyrtimit gjyqësor fakti del ndryshe nga sa është përshkruar në kërkesën për gjykim.

Referuar dispozitave të Kodit Penal, që parashikojnë këto dy vepra penale, konstatohet se ato parashikojë masa dënimi shumë të ndryshme me njëra-tjetrën, konkretisht: vepra penale “dhunë në familje” parashikuar nga neni 130/a/4⁸⁸ të Kodit Penal ka një masë dënimi nga 1-5 vjet burgim; vepra penale “vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare” e mbetur në tentativë, e parashikuar nga neni 79/c⁸⁹ dhe neni 22, dënimi ka një masë dënimi jo më pak se 20 vjet ose më burgim të përjetshëm.

Në diskutimet e tij përfundimtare në lidhje me ndryshimin e akuzës prokurori Arens Çela ka argumentuar se: *“Përcaktimi i sendit me të cilin është ushtruar dhunë nuk është bërë e mundur të përcaktohet nga hetimi, pasi një send i tillë nuk është sekuestruar dhe, po kështu, dëshmitarët Sh. A. dhe P. E., nuk kanë qenë në gjendje ta përcaktonin. Si e tillë nuk mund të përcaktohet nëse ky send ka qenë i përshtatshëm për të sjellë pasojën e kërkuar nga neni 79/c e 22 i Kodit Penal. Nga dinamika e veprimeve të të pandehurit nuk rezulton që të jemi përpara veprës penale të “vrasje për shkak të rrethanave familjare” e mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 79/c dhe 22 i Kodit Penal. Kjo pasi shkalla e dëmtimeve të marra nga e dëmtuara ka qenë e lehtë dhe i pandehuri i ka pasur të gjitha mundësitë për ta kryer veprën penale nëse do të dëshironte ardhjen e pasojës së parashikuar nga neni 79/c i Kodit Penal”.*

Ndërkohë, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda në vendimin e saj përfundimtar i jep faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori duke analizuar elementët e veprës penale si: anën objektive (dëmtimet e shkaktuara znj. M. B. nga i pandehuri A. D.); anën subjektive (i pandehuri ka pasur si qëllim vrasjen e viktimës, parapërgatitja, gjetja e mjetit, koha dhe vendi i zgjedhur); shkaqet e mosardhjes së pasojës së dëshiruar, rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, rrezikshmërinë e autorit, rrethanat rënduese të tilla si pasja e një dënimi të mëparshëm, apo kryerja e veprës penale pas dhënies së urdhrave gjyqësore të mbrojtjes nga dhuna në familje.

Duke mbajtur në konsideratë arsyetimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, e cila ka dhënë një tjetër kualifikim të veprës penale, të ndryshëm nga ai i kërkuar nga prokurori, nga Komisioni u vlerësua që në diskutimet përfundimtare përpara kësaj gjykate, prokurori mund të kishte bërë një analizë më të plotë të elementëve të veprës penale, si rrezikshmëria shoqërore e veprës penale, rrezikshmëria e autorit, rrethanat rënduese të tilla si pasja e një dënimi të mëparshëm, apo kryerja e veprës penale pas dhënies së urdhrave gjyqësore të mbrojtjes nga dhuna në familje.

Në përfundim të hetimit administrativ, me njoftimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkuar të japë sqarime në lidhje me këtë konstatim.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

Në parashtrimet e tij të datës 5.0.2021, subjekti ka deklaruar se ndryshimi i kualifikimit ligjor është bazuar në provat dhe faktet e administruara, si dhe në bindjen e tij të brendshme si prokuror i seancës. Subjekti shprehet se e gjen të drejtë konstatimin e trupit gjykues se mund të ishte arsyetuar më shumë në drejtim të elementëve të tilla si rrezikshmëria shoqërore e veprës penale, rrezikshmëria e autorit, rrethanat rënduese, si dhe rrethana e pasjes së një dënimi të mëparshëm apo kryerja e veprës penale, pas dhënies së urdhrave gjyqësore të mbrojtjes nga dhuna në familje, por sipas tij, këto elementë u morën parasysh në dhënien e konkluzioneve përfundimtare, ku ka kërkuar dënimin maksimal që parashikon dispozita përkatëse. Ndërsa

⁸⁸ Plagosja e kryer me dashje, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë, dënohet me burgim gjer në pesë vjet.

⁸⁹ “Vrasja me dashje e personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm”.

rrethana e përsëritjes e veprës penale, sipas tij, është rrethanë cilësuese e akuzës ndaj shtetasit A. D., pasi fakti u kualifikua, si “dhunë në familje”, parashikuar nga neni 130/a/4 i Kodit Penal.

Siç vërehet, subjekti bie dakord me konstatimin e Komisionit se mund të ishte arsyetuar më shumë në drejtim të elementëve të veprës penale, duke mbajtur në këtë mënyrë një qëndrim reflektues.

Në përfundim, referuar të gjitha rrethanave të çështjes, Komisioni çmon se kualifikimi i veprës penale, arsyetimi dhe analizimi i elementëve të saj, janë tagër e prokurorit bazuar në provat dhe bindjen e tij të brendshme. Në këto kushte, duke mbajtur në konsideratë pikën 4, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit: “... vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të prokurorit pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet ...”, por edhe vendimin e Kolegjit⁹⁰, Komisioni çmon se një vlerësim i tillë nuk është i një natyre procedurale, por lidhet me themelin e çështjes dhe, si e tillë, është jashtë tagrit të vlerësimit të Komisionit. Por, në konsideratë të rrethanave të çështjes, vendosi ta transferojë çështjen që i përket procedimit penal nr. ***, pranë organit kompetent, për inspektim të shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore sipas pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

6. Nga informacionet e marra pranë organeve ligjzbatuese, u konstatuan të dhëna në lidhje me subjektin e rivlerësimit për dy çështje penale. Me qëllim verifikimin e këtyre informacioneve, Komisioni administroi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë⁹¹ dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat⁹² dy dosje penale, nga verifikimi i akteve të të cilave, rezultoi se:

6.1 Nga dosja e procedimit penal nr. *** në ngarkim të shtetasit I. G.. rezultoi se ky procedim penal është regjistruar në datën 26.3.2008 nga prokurori F. B. dhe se në këtë çështje subjekti i rivlerësimit Arenc Çela ka zëvendësuar në datën 4.4.2008 prokurorin e caktuar fillimisht dhe ka kryer hetime për një periudhë 10-mujore, nga data 4.4.2008 – 10.2.2009, datë kur u zëvendësua nga një tjetër prokuror, pasi largua në Prokurorinë e Rrethit Beratit. Çështja është pushuar në datën 2.8.2020 nga prokurori A. D.. Pra, çështja nuk është përfunduar prej subjektit të rivlerësimit Arenc Çela. Po kështu, nga aktet në dosje, nuk janë evidentuar shkelje ligjore apo procedurale nga ana e subjektit, gjatë periudhës që ka kryer hetime.

6.2. Nga dosja e procedimit penal nr. ***, në lidhje me shoqërinë “****” sh.p.k. Berat, me administrator A. H., rezultoi se ky procedim penal është regjistruar në datën 20.9.2011 nga prokurori K. B. dhe është pushuar prej tij më 5.5.2012, pasi nuk rezultoi e provuar që në rastin konkret të ishin konsumuar elementët e ndonjë vepre penale. Ndërkohë që nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të ketë kryer hetime në lidhje me këtë çështje. Gjithashtu, drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Berat, në këtë periudhë ka qënë Xh. S. dhe jo subjekti Arenc Çela, i cili është caktuar me detyrë drejtues i kësaj prokurorie në datën 3.4.2013.

⁹⁰ Shihni vendim nr. 28, datë 23.10.2020, të KPA-së për subjektin Fuat Vjerdha, sipas së cilit: “Kolegji çmon se gjykimi apo vlerësimi mbi zgjidhjen e një çështjeje gjyqësore nuk mund të jetë një alternativë vlerësimi e përdorur prej organeve të rivlerësimit, për sa kohë që ky lidhet me vlerësimin e çmimin e provave dhe mbështetet mbi bindjen e brendshme të magjistratit. Në rastin konkret, pikërisht vlerësimi i aftësive profesionale të magjistratit, duke gjykuar e vlerësuar logjikën apo bindjen e tij të brendshme të formuar e shpalosur si pjesë e vendimmarrjes në trupën gjyqësore përkatëse, duke arsyetuar mbi provat e të gjitha rrethanat e çështjes së gjykuar, del jashtë misionit dhe kompetencës ligjore të organeve të rivlerësimit, prandaj edhe Kolegji vlerëson se konkluzioni se subjekti ka dhënë një zgjidhje të gabuar, duke deklaruar pafajësinë e njërit prej të gjykuarve, është një konkluzion në tejkalim të kompetencës kushtetuese të organeve të rivlerësimit dhe, si i tillë, nuk mund të përdoret për të kryer vlerësimin e tij”.

⁹¹ Shihni dosjen bashkëlidhur shkresës nr. *** prot., datë 30.9.2019, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në dosjen e Komisionit.

⁹² Shihni shkresën kthim përgjigje nr. ***, datë 25.9.2019, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, në dosjen e Komisionit.

7. Informacioni i marrë nga të dhënat arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme, lidhur me ankesa, masa disiplinore dhe vlerësime, për subjektin e rivlerësimit Arens Çela, nuk rezultuan *indicie* për hetime të mëtejshme nga Komisioni.

C. Rivlerësimi profesional sipas kriterëve të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Për të kryer rivlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i është referuar:

1) Nenit E të Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon rastet e prezumuara për marrjen e masave ndëshkuese për subjektet e rivlerësimit. Sipas kësaj dispozite ligjore, në procesin e vlerësimit tërësor të të gjithë komponentëve të vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, Komisioni konstatoi se nuk ndodhemi përpara ndonjë prej parashikimeve ligjore të kësaj dispozite, pasi nuk u vërtetua që subjekti: (i) ka njohuri, aftësi, gjykim ose sjellje të cekëta ose ka një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij, pika 3; (ii) ka një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij dhe mangësia e vërejtur nuk mund të korrigjohet përmes programit njëvjeçar të edukimit, pika 4; (iii) kryen veprime për të penguar ose vështirësuar vlerësimin e tij ose rezultoi se ka njohuri, aftësi, gjykim, qëndrime ose një model pune aq të dobët sa që rrezikon ose cenon të drejtat e qytetarëve, pika 5.

Bazuar në të gjitha sa janë evidentuar gjatë procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Arens Çela, Komisioni krijoi bindjen se problematikat e evidentuara dhe të trajtuara hollësisht në këtë vendim nuk sjellin papërshtatshmëri në drejtim të aftësive profesionale të subjektit, në kuptim të nenit 61/4 të ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, në bindjen e trupit gjykues këto problematika janë të pamjaftueshme për të arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut sipas pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, kjo edhe në konsideratë të faktit se qëndrimi i mbajtur në vijimësi nga subjekti, ka qenë tërësisht bashkëpunues dhe reflektues në lidhje me çdo pyetje që i është drejtuar apo konstatim të Komisionit. Për më tepër, në zbatim të pikës 1, të nenit 42 dhe të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 77 të ligjit nr. 96/2016, vlerësimi përfundimtar lidhur me secilin prej kriterëve të vlerësimit të aftësive profesionale të magjistratit, duhet të jetë produkt i vlerësimit tërësor të burimeve të përcaktuara në ligj. Konkretisht, e vetmja çështje që subjekti u gjend në veprime të gabuara të natyrës procedurale ka qenë procedimi penal nr. ***, i cili u shqyrtua mbi bazën e denoncimit të shtetasit A. Xh.. Për sa i takon dy çështjeve të tjera, kallëzimit penal nr. ***, për çështjen e të ndjerit M. M. dhe procedimin penal nr. ***, për veprën penale “dhunë në familje” në ngarkim të të pandehurit A. D. edhe pse Komisioni evidentoi që veprimet e subjektit i përkisnin vlerësimit në themel të çështjeve dhe vendimmarrjes së subjektit, i dërgoi këto çështje për verifikim disiplinor së bashku me procedimi penal nr. ***, filluar mbi bazë të kallëzimit të shtetasit A. Xh..

2) Kriterëve të parashikuara në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, referuar te cilave, Komisioni vlerësoi se:

- subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira profesionale, sipas nenit 73 të ligjit nr. 96/2016;
- subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira organizative, sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016;
- subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional, sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016;
- subjekti i rivlerësimit ka treguar etikë të lartë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale, parashikuar nga neni 75 i ligjit nr. 96/2016.

Për sa më sipër, sipas germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur

nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

III. SEANCA DËGJIMORE

Në datat 2.3.2021 dhe 19.3.2021, sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, u zhvillua seanca dëgjimore për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Arens Çela, në përfundim të së cilës, kërkoi konfirmimin në detyrë. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues i Komisionit, pasi dëgjoji relatoren e çështjes, komisionere Firdes Shuli, e cila rekomandoi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit dhe administroi dokumentet shkresore, përfundoi procedurën e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Arens Çela, si dhe shpalli vendimin në datën 23.3.2021, sipas pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

IV. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016, si dhe gjatë dy seancave dëgjimore. Në të gjitha komunikimet, subjekti ka qenë në çdo rast i gatshëm, duke u treguar tërësisht bashkëpunues, pasi i është përgjigjur me korrektesë dhe brenda afateve të caktuara të gjitha pyetjeve, duke dhënë shpjegime në mënyrë shteruese për informacionin e kërkuar dhe duke paraqitur në çdo rast dokumente shkresore për të vërtetuar për sa i është kërkuar nga Komisioni, qëndrim i cili është mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes, sipas parashikimit të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion PËRFUNDIMTAR

Bazuar në parimet e barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, si dhe në parimin e proporcionalitetit, sipas pikës 5, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni krijoi bindjen se:

1. Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit, z. Arens Çela, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë sipas nenit 59/a të ligjit.
2. Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit, z. Arens Çela, ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës sipas nenit 59/b të ligjit.
3. Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, z. Arens Çela, ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 59/c të ligjit.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u mblodh në dhomë këshillimi në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar sipas parashikimit të pikës 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në germën “a”, pikën 1, të nenit 58, dhe pikën 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Arens Çela.
 2. Transferimin e çështjeve që i përkasin: procedimit penal nr. ***, të regjistruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat; procedimit penal nr. ***, të regjistruar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Krujë; si dhe kallëzimit penal me nr. ***, të trajtuar nga prokuroria panë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, pranë institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për inspektim të shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore ose shkaqe për t'u marrë parasysh gjatë vlerësimit periodik, sipas pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.
 3. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
 4. Ky vendim, me përjashtim të pikës 2, mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
 5. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
- Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 23.3.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Pamela QIRKO
Kryesuese

Firdes SHULI
Relatore

Xhensila PINE
Anëtare/kundër

Sekretare gjyqësore
Orianda Liçi

